- Nëse flitet një fjalë e re, logjikisht ajo do të duhej të dëgjohej më parë. Në anën tjetër leximi i një fjale të re është më i lehtë kur ajo më parë është dëgjuar ose folur. Edhe të shkruarit do të duhej të ishte më i lehtë, kur ajo fjalë është dëgjuar, folur apo lexuar më parë.

- Grafemat e gjermanishtës dhe të shqipës nuk përrupthen në çdo rast. Pasi që nxënës/sit janë mësuar me alfabetin e gjuhës shqipe, mund të paraqitet “përgjithësimi” ose interferenca, nëse fillohet herët me shkrimin në gjuhën gjermane. E mu kjo mund të shmanget nëse mësimi fillon me të dëgjuarit dhe pastaj lëvizë mbi stacionet e të folurit dhe të lexuarit në drejtim të të shkruarit.

6. Puna aktive dhe konkrete

Një dallim në mes të mësimit të gjuhës gjermane në Gjermani- pa marrë parasysh a bëhet fjalë për gjermanishten si gjuhë amtare ose për gjermanishten si gjuhë e dytë ose e huaj- dhe në Kosovë është ndër tjera se mjedisi-kosovar mund të japë pak ose aspak informacione për RFGJ-në dhe përveç orës së mësimit pothuajse nuk ekziston ndonjë mundësi për t’u zbatuar ajo që është mësuar. Kështu që bie mundësia që ajo që është mësuar në shkollë të thellohet jashtë orëve të mësimit si përmes ekskursioneve, zhvillimit të intervistave etj. Në këtë kontekst nuk duhet mbiçmuar apo nënçmuar televisionin.

Prodhimi (krijimi) i pllakatave, mozaqeve dhe posterëve, prodhimi i punëdoreve të vogla janë gjithashtu të rëndësishme.

Një arsye tjetër për aktivitete të këtilla, janë njohuritë nga psikologjia e të mësuarit: sipas saj rezultati (arritja) është më i madh, sa më shumë që të mbështeten veprimet gjuhësore nga veprimet konkrete.

7. Kohë e mjaftueshme për ushtrime dhe zbatim

Për nxënien dhe zotërimin e sigurtë të një gjuhë nevojiten në përgjithësi tri gjëra: kohë, kohë dhe prapë kohë.

Ne e dimë se ekzistojnë 3 tipa të ndryshëm të nxënësve:

Tipat akustik (ata e nxënë- mësojnë gjuhën më shpejt përmes dëgjimit- veshit);

Tipat vizuel- (pamor) (ata e nxënë gjuhën në radhë të parë përmes syrit);

Tipat motorik (ata nxënë gjuhën më se shpejt përmes të shkruarit).

Për këtë arsye është e rëndësishme, që ushtrimi të zgjedhet gjithashtu edhe përmes këtij këndvështrimi; që gjuha të mësohet njëkohësisht përmes kanaleve të shumta, pasi që te shumica e atyre që mësojnë gjuhën bëhet fjalë për tipa të ashtuquajtur të përzier.

8. Llojlojshmëria në fazat e ushtrimeve

Secili mësues dhe mësuese e di saktësisht se në orën e gjuhës, të ushtruarit monoton të strukturës së fjalisë ka më shumë ndikim negativ sesa që e arrinë atë është synuar.

Nxënësit dhe nxënset do ta humbin interesimin për mësim dhe nuk do të marrin pjesë aktivisht në të. Në anën tjetër ne e dimë se motivimi i synuar dhe dhënia e detyrave interesante mund ta ngrisin dëshirën për mësim dhe gatishmërinë për punë (rezultate).

Ndërrimi i formave të punës (puna e veçantë, puna në çifte ose në grupe) është shumë më frytëdhënëse, por edhe lojrat në mësim, këngët dhe poezitë si dhe tregimet duhet të bëhen pjesë përbërëse të mësimin.

9. Korrigjimi i shprehjeve të nxënësve

Pothuajse asnjë çështje nuk diskutohet aq shpesh dhe në mënyrë kundërthënëse në rrethin e mësimdhënësve se sa mënyra e korrigjimit.

Derisa korrigjimin disa e vështrojnë si pengesë të rrjedhjes gjuhësore, të tjerët mbështeten në atë se gabimet duhet korrigjohen menjëherë që të mos përvidhen..

Ndoshta mund të bëhet një kompromis i arsytshëm gjatë korrigjimit dhe ai do të dukej kështu:

- Në fazën e kontaktit të parë me temën e re, si për shembull përmes një fotografie, mësueset dhe mësuesit presin një të shprehur të lirë të nxënësve të tyre.

Po të bëjnë korrigjimin masiv gjatë kësaj faze të mësimin, nxënësit ndoshta do të tërhiqeshin menjëherë dhe në fund do të heshtin plotësisht.

Në këtë fazë është e drejtë që korrigjimet ndër të tjera të parashtrihen në atë mënyrë, për shembull, një fjalë e thënë gabimisht të përsëritet nga mësuesi edhe një herë, por natyrisht në mënyrë të drejtë.

- Situata në fazën e zbatimit dhe të ushtrimit është tjetër. Këtu bëhet fjalë për trainimin e vokabularit dhe të strukturave dhe këtu korrigjimi natyrisht është i pakushtëzueshëm.

S'ka diskutim se, nxënësit/sit nuk bënë t'i turpërojmë para klasës, por të tregojmë takt pedagogjik.

10. Diferencimi

Ndodhë shpeshë që rezultatet e ndryshme gjuhësore të nxënësve në mësim të paraqesin pjesërisht vështirësi të mëdha.

Derisa një nxënës ta ketë kryer tanimë detyrën e tij, të mërzhitet në mësim apo të pengojë të tjerët duke kryer detyrat, tjetri nuk është ende gati edhe pse ka mjaft kohë në dispozicion.

Për mësueset dhe mësuesit ekzistojnë këtu dy mundësi: të bëjnë kinse nuk ka dallime në rezultate, por atëherë do të duhej që të merrej parasysh edhe ajo që herët apo vonë do të paraqiten vështirësitë nga ngarkesat (kërkesat tona) e vogla gjegjësisht të mëdha.

Mundësia tjetër mbështetet në praktikimin e masave të diferencimit të brendshëm e kjo pa dyshim për nxënësen/sin do të thotë të punojë.

Dallohen forma të ndryshme të diferencimit, të cilat nuk do të diskutohen këtu sepse ato tanimë janë të njohura.

Vetëm dy forma duhet të shikohen më për së afërmi:

Diferencimi kuantitativ dhe kualitativ

-Diferencimi kuantitativ do të thotë, se detyrat dallohen në kuantitetin e tyre, pra në sasinë e tyre. Kjo s' do të thotë asgjë tjetër, veçse nxënësit "e shpejtë" marrin detyra plotësuese. Masa zbatohet lehtë, sepse mësueset dhe mësuesit duhet vetëm që të mendojnë detyra shtesë, të cilat pastaj në se është nevoja ia japin disa nxënësve. Ky lloj i diferencimit megjithatë i ka edhe të metat e tij, sepse me an të detyrave shtesë prej nxënësve kërkohet edhe më shumë e në këtë mënyrë bëhen gjithnjë e më të mirë. Me fjalë tjera: dallimi në mes të të mirëve dhe më pak të mirëve bëhet gjithnjë më i madh. Gjithashtu shtrohet pyetja, mos ndoshta nxënësit më të vjetër i shohin këto detyra shtesë si një lloj dënimi për atë që kanë punuar më shpejtë.

-Diferencimi kualitativ shtron më shumë kërkesa. Me këtë rast jipen detyra me shkallë të ndryshme vështirësie, pa e lënë ansh temën e përbashkët. Të nisemi prej asaj, që brenda një klase kemi të bëjmë me tri grupe të ndryshme të rezultateve A, B, dhe C, ku me grupin A nënkuptojmë grupin me arritje më të larta, me grupin B grupin me arritje të mesme dhe me grupin C grupin me arritje më të dobëta. Skema e rrjedhës së një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

Sprachbegegnung - Kontakti i parë me temën e re (Evokimi)		
e përbashkët për të gjithë nxënësit		
Spracherarbeitung - Përpunimi i temës (Realizimi)		
e përbashkët për të gjithë nxënësit		
Sprachübung - Ushtrimet rreth temës (Reflektimi)		
diferencimi i grupeve sipas shkallës së arritshmërisë, p.sh.		
Grupi A Përpunimi i tërë tekstit. Detyra kreative shtesë	Grupi B Përpunimi i tërë tekstit me ndihmesë, p.sh. Artikelhilfe	Grupi C Përpunimi i një pjese të tekstit me ndihmesë, p.sh. Artikelhilfe.

Shpesh dëgjohet edhe një argument që flet kundër kësaj forme të diferencimit e që është:

Tek kjo mënyrë e zhvillimit të mësimin nuk mësojnë të gjithë nxënësit të njëjtën gjë, sepse profili i kërkesave është i ndryshëm, në këtë rast treshkallësh.

- Një analizë e këtij argumenti tregon megjithatë shumë shpejtë, se kjo nuk mund të vlejë gjithmonë, sepse: nxënësit nuk e arrijnë parimisht kurrë njësoj shpejtë dhe mirë objektivin e orës mësimore.

- Ajo çka arrihet me anë të këtij procesi, është shmangia nga kërkesa e tepërt apo e paktë, sepse aftësitë e nxënësve për të nxënë janë të ndryshme pavarësisht nga ajo se a praktikohen masat e diferencimit apo jo.

11. Ndarja e një ore mësimore

Rrjedha e një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

Artikulationsstufen	Methodische Absichten
1. Sprachbegegnung	Begegnung mit der neuen Sprachsituation, z.B. durch Bild, Tonaufnahme, Filmausschnitt, Lehrer- oder Schülervortrag.
2. Spracherarbeitung	Bereitstellen und Erarbeiten von neuem Wortschatz oder neuen Strukturen.
3. Sprachübung	Übungsbeispiele, möglichst in Form von realen Sprechhandlungen. Aufgreifen und Wiederholen von bekanntem Wortschatz mit neuen Strukturen und umgekehrt. Differenzierungsmaßnahmen Sprachlernspiele
4. Sprachanwendung	Übertragen des Gelernten auf neue Situationen: Im Klassenzimmer Im außerschulischen Bereich

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Gjuha, e cila pikësepri shërben si mjet komunikimi nuk mësohet ekskluzivisht në orët e gjuhës por në një formë a në një tjetër tek të gjitha lëndet mësimore përdorura në to aftësitë, pikëpamjet e ndryshme e njohuritë zhvillohen përmes rrugëve gjuhësore.

Për atë që sa gjuha ndihmon tek lëndet e tjera, atë mund të ndihmojnë lëndet tjera për arritjen e objektivave brenda mësimin të gjuhës gjermane. Para së gjithash edhe temat e zgjedhura kanë të bëjnë me shumë fusha të jetës e me këtë edhe me shumë lëndë mësimore, njohuritë e të cilave na ndihmojnë në mësimin e gjuhës gjermane.

Natyrisht se gjuha para së gjithash është e nderlidhur me artet sepse çdo fjalë a nocion i ri mund (duhet) të shpjegohet përmes këngës, vizatimit, fotografisë a lojës (qoftë te fëmijët (niveli II) apo te të rinjët (niveli III)).

Edhe njohuritë nga shkencat, qoftë natyrore apo shoqërore duhet t'i shfrytëzojmë gjatë trajtimit të temave të ndryshme të parapara për klasën e shtatë.

Këto njohuri shfrytëzohen sidomos në fazën e parë të orës (EVOKIMI), ku varësisht nga temat që do të trajtojmë, përdorim njohuritë nga lëndët tjera (nxënësit i parapërgadisim për temën).

Të ndërlidhura më shkencat shoqërore e që vetëdijësojnë nxënësit për qështje të shumta jetësore si dhe u ndihmojnë të arrijnë shkathtësitë e duhura jetësore e komunikative, janë temat e shumta në klasën e shtatë (e sidomos me edukatën qytetare). Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe temave të ndjeshme, siç janë tema e barazisë gjinore.

Ndërlidhja eksiston edhe me shkencat natyrore sidomos të potencuara janë ato njohuri që kanë të bëjnë me ambijentin, ruajtjen e tij, shëndetin (ruajtjen e shëndetit të vet e të tjerëve), ushqimin, etj.

Udhëzime për vlerësim

Një ndër çështjet kryesore dhe shumë të rëndësishme në mësimdhënien dhe mësimnxënien e një gjuhe të huaj është vlerësimi. Ai duhet të bëhet në vazhdimësi përmes korrigjimit, pyetjeve, testimit.

Vlerësimi bëhet për secilën shkathtësi gjuhësore, si ato receptive, po ashtu edhe ato produktive. Vlerësimi fillon qysh në fillim të mësimdhënies me qëllim verifikimi të pengesave eventuale që u dalin nxënësve, pastaj në çfarë mase nxënësit i arrijnë objektivat e përcaktuara.

Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç' shkallë kanë zotëruar nxënësit fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t'i përdorë shkathtësitë gjuhësore
- Pengesat e nxënësve: vlerësohet shkalla e zotërimit të njohurive me qëllim të eliminimit të pengesave dhe të ndihmës së nxënësve për eliminimin e vështirësive
- Integrimin e njohurive të fituara: vlerësohen aktivitetet apo projektet e ndryshme që nxënësit realizojnë jashtë programit shkollor dhe integrimin e këtyre njohurive në situata brenda shkollës

Gjatë procesit mësimor rëndësi të veçantë do të kenë mënyrat e ndryshme të vlerësimit si:

- Vlerësimi nga mësimdhënësi; vlerësimi i drejtëpërdrejtë dhe pandërprerë, përcjellja e vazhdueshme e rezultateve të nxënësve si dhe vlerësimi indirekt me anë të testeve
- Vlerësimi nga nxënësi; gjatë punës në grupe ose gjatë përgjigjeve që japin, nxënësit mund ta plotësojnë njëri-tjetrin dhe njëkohësisht vlerësojnë mbi bazën e argumenteve
- Vetëvlerësimi; vlerësimi i vetë nxënësit

1. Mundësitë praktike

Mësuesi i ka të lira disa mundësi për vlerësim. Mësuesi para se të bëjë vlerësimin duhet të mendojë se çfarë forme të vlerësimit do të zbatojë, sepse nuk është secila mënyrë e vlerësimit njësojë e përshtatshme për verifikimin e njohurive të nxënësit.

Në përgjithësi janë tri fusha të mëdha veprimesh (aftësishë), të cilat vlerësohen:

1. Riprodhimi(reprodukimi)- nënkupton riprodhimin nga nxënësi e asaj që është mësuar më parë.

2. Riorganizimi- nënkupton bartjen e të mësuarës në situata të ngjashme(p.sh. nëse nxënësit i mësohet vendi i foljes në fjali të varur, duhet të jetë i aftë të aplikojë foljen në fjali tjera të varura).
3. Transferi- nënkupton bartjen e të së mësuarës në situata plotësisht të reja.

Kryesisht i njohim tri sfera të mëdha tek vlerësimi:

1. mënyra e të vlerësuarit me shkrim: prej nxënësit pritet një përgjigje me shkrim.
2. mënyra e të vlerësuarit oral: prej nxënësit pritet një përgjigje me gojë.
3. mënyra e të vlerësuarit të veprimeve: prej nxënësit pritet një veprim aktiv, p.sh. tek ushtrimet ku kërkohet rradhitja

Në vijim do të paraqiten vetëm mënyrat e të vlerësuarit me shkrim. Ato janë mënyra më objektive dhe zbatohen më së shpeshti në shkollë.

1.1. Përgjigjet seleksionuese

Siç tregon edhe vetë emri, nxënësi gjatë përgjigjes në një pyetjeje ka mundësinë e zgjedhjes, të dallojë ose të zgjedhë, tek përgjigjet e shumta të dhëna, në mes të të saktës dhe të pasaktës. Edhe këtu ka mundësi të ndryshme.

- **Përgjigjet alternative**

Nxënësit i jipen dy mundësi të përgjigjes. Ai duhet të identifikojë një përgjigje si të saktë dhe shenjojë atë.

Shembull: rrethoje përgjigjen e saktë.

Berlin ist die Hauptstadt von BRD.	richtig <input type="radio"/>
	falsch <input type="radio"/>

Fjalja e dhënë është e formuluar qartë.

Duke supozuar, se nxënësi i kupton të gjitha nocionet, fjalia do të rrethohet si e saktë. Përparësia e përgjigjeve alternative është e qartë: Ato formulohen, zbatohen dhe vlerësohen shpejtë dhe lehtë.

Të metat janë të dukshme:

Mundësia, që të qëllohet zgjidhja e drejtë, është saktë 50%, sepse vetëm njëra nga zgjidhjet është e saktë.

- **Përgjigjet me mundësi të shumta të zgjedhjes**

Përkundër përgjigjeve alternative, përgjigjet me mundësi të shumta të zgjedhjes i japin nxënësit më shumë mundësi për zgjedhje, prej të cilave ai duhet të gjejë të saktën.

Shembull: rrethoje përgjigjen saktë.

Das Auto steht	<input type="radio"/> unter der Straße.
	<input type="radio"/> über der Straße.
	<input type="radio"/> in der Straße.
	<input type="radio"/> auf der Straße.

Nxënësi, që të mund ta rrethojë zgjidhjen e saktë, duhet t'i njohë parafjalët e përdorura në shembull. Ai duhet ato t'i dallojë dhe t'i krahasojë. Në krahasim me përgjigjet alternative mundësia që të qëllohet përgjigjia e saktë bie; tek ky shembull është 25%.

Tek përgjigjet me mundësi të shumta të zgjedhjes duhet të kihen parasysh disa pikë: shtruarja e pyetjeve dhe përgjigjet duhet të kenë një lidhje logjike.

Shembull: rrethoje përgjigjen saktë

Die Fliege	<input type="radio"/> fliegt auf den Kopf	des Vaters.
	<input type="radio"/> landet auf dem Kopf	
	<input type="radio"/> schwebt auf den Kopf	
	<input type="radio"/> befindet sich auf dem Kopf	

Në këtë rast nxënësi mund të ketë probleme gjatë të rrethuarit të zgjidhjes së saktë. Ndoshta edhe ndonjë gjermanofolës nuk do të mund të dinte se cila zgjidhje do të ishte më e mira, sepse tek mundësitë e dhëna bëhet fjalë para së gjithash për një çështje stili gjuhësor.

Përgjigjet jo të sakta që janë dhënë afër përgjigjeve të sakta duhet të kenë një lidhje të arsyeshme më pyetjen. Nëse nuk është ashtu, atëherë detyra me mundësi të shumta të zgjedhjes nën këto rrethana do të shëndërrohet në detyrë me përgjigje alternative. Kjo ndodhë atëherë, nëse nxënësit, në shikim të parë, zgjidhjet e pasakta i duken si përgjigje alternative.

Shembull : rrethoje përgjigjen saktë

Das Auto steht	<input type="radio"/> unter dem Wasser.
	<input type="radio"/> über der Mauer.
	<input type="radio"/> in der Blume.
	<input type="radio"/> auf der Straße.

Në këtë rast nxënësi tri zgjidhjet e para do t'i eliminojë menjëherë si të pasakta. Nga përgjigjia me mundësi të shumta të zgjedhjes nuk do të mbetet asgjë. Ndërtimi dhe formulimi nuk guxon t'ia lehtësojë nxënësit zgjidhjen.

Das Auto	<input type="radio"/> stehst unter der Straßen.
	<input type="radio"/> stehen über der Straßen.
	<input type="radio"/> steht auf der Straße.

Në këtë rast nxënësi do të mund të zgjedhë mundësinë e tretë shumë shpejtë si të vetmën të saktë, sepse vetëm tek kjo mundësi kallëzuesi në njëjës përputhet me kundrinën e cila gjithashtu qëndron në njëjës.

1.2. Përgjigjet rregulluese

Karakteristikë e përgjigjeve rregulluese është se nxënësi duhet të rregullojë një sistem të dhënë. Këtu ekzistojnë dy mundësi :

- Klasifikim

- Rradhitje

• **përgjigjet klasifikuese**

Nxënësit i jipen dy grupe fjalësh apo fjalishë. Ata kanë për detyrë që një pjese të grupit të parë t'i shtohet pjesa përkatëse e grupit të dytë.

Shembull : Klasifiko.

1. Peter 2. Armend 3. Giuseppe	a) Griechenland b) Deutschland c) Spanien d) Kosova e) Türkei f) Italien
--------------------------------------	---

Shembull: Çka përshtatet? Klasifiko.

1. die Schule	a) der Lehrer	d) das Geld	g) der Sandkasten
2. der Spielplatz	b) die Arbeit	e) die Maschine	h) der Schüler
3. die Fabrik	c) die Rutsche	f) das Tor	i) der Meister

Përgjigjet klasifikuese kanë përparësinë, sepse mësuesi mundet shumë mirë të vërtetojë, se a e ka kuptuar nxënësi logjikisht një problem.

• **përgjigjet rradhitëse**

Detyrë e nxënësve është që t'i vëjë në rradhë të duhur fjalitë, shkronjat dhe fjalët.

Shembull:

Vëri fjalitë në rradhën e duhur.

1. Es ist acht Uhr.
2. Liridon geht bei Rot über die Kreuzung.
3. Der Wecker klingelt.
4. Liridon kommt zu spät zur Schule.
5. Liridon hat verschlafen.
6. Der Autofahrer bremst scharf.
7. Er springt aus dem Bett.
8. Der Fahrer schimpft Liridon.
9. Er läuft schnell Weiter.

Zgjidhjen e drejtë të kësaj detyre mund ta lehtësojë një rradhë fotografishë.

Shembull: rradhiti shkronjat.

schueRt	
hrreeL	
Seluch	
mbsret	

Edhe tek ky shembull mund të paraqiten fotografi për lehtësimin e gjetjes së zgjidhjes.

Shembull: Rradhiti shkronjat drejtë.

Der	bremst	Autofahrer	Scharf
a	B	c	D

Shembull:

Rradhiti shkronjat drejtë në kutitë e rendit të parë.

Shkruaj shkronjën e fjalës joadekuatë në kuti.

a) Der b) bremst c) Autofahrer d) groß e) scharf

Në këtë shembull shihet problematika. Si të bëhet vlersimi nëse dy nxënës vijnë me këto zgjidhje:

Nxënësi 1: *Der Autofahrer scharf bremst.*

Nxënësi 2: *Der Autofahrer bremst groß.*

Asnjëra nga dy zgjidhjet nuk është e saktë. Përderisa tek nxënësi 1. renditja e fjalëve është gabim nxënësi 2. ka zgjedhur ndajfoljen e gabuar. A nuk merr asnjëri nxënës pikë? Apo, a mund të thuhet se njëra nga të dy zgjidhjet është “më e saktë” kurse tjetra “ më pak e pasaktë”?

Nëse mësuesi dëshiron të testojë renditjen e drejtë të fjalëve në fjali: A mundet atëherë nxënësi 2 ta marrë njerën nga dy pikët e mundshme?

1.3. Përgjigjet e lira

Përgjigjja e lirë karakterizohet përmes asaj, që nxënësi duhet të reagojë në detyrën e dhënë të mësuesit, pa pasur mundësi zgjedhjeje.

- **Përgjigjet plotësuese**

Përgjigjet plotësuese, të ashtuquajtura gjithashtu përgjigje të shkurtëra, praktikohen shpesh në shkollë.

Shembuj:

Viele Dinge sind schneller, schöner usw. als andere. Setze die richtige Form ein.

(langsam)	Ein Fahrrad ist ... als ein Auto.
(schäer)	Fünf Kilo sind ... als ein Kilo.
(teuer)	Fleisch ist ... als Brot.

Trage das Gegenteil in die Lücke ein.

Dieses Buch ist spannend. Es ist nicht ...
Elona ist groß. Sie ist nicht ...
Latra ist ein Mädchen. Sie ist kein ...

Setze die richtige Zeit in die Lücke ein.

Heute Nachmittag ... (gehen) ich auf den Spielplatz.
Morgen ... (spielen) ich Tennis.
Gestern ... (sein) ich im Kino.

- **Përgjigjet e shkurtëra hartuese**

Ky nocion mund të sjellë keqkuptime. Më këtë janë menduar përgjigjet e nxënësve sipas udhëzimit të mësuesit, të cilat paraprakisht nuk mund të vlerësohen qartë si të sakta apo të pasakta.

Shemull:

Formo një fjali prej këtyre dy fjalive.

Elira weint. Eine Wespe hat sie gestochen.

Te ky shembull nuk shfaqen probleme të mëdha gjatë vlerësimit. Më vështirë është te tregimet me fotografi, të cilat gjithashtu numërohen si përgjigje të shkurtëra hartuese. Për të gjithë nxënësit detyra është e njëjtë, sepse të gjithë i kanë në dispozicion fotografitë e njëjta. Megjithatë nuk mund të vlerësohet vetëm numri i informacioneve, sepse kriteret tjera luajnë një rol të rëndësishëm, psh. radhitja, zgjedhja e fjalëve, lidhjet, etj. Këto e vështirësojnë një vlerësim objektiv.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Literatura

SCHRITTE International, A2/1, Kursbuch/Arbeitsbuch, HUEBER Verlag, Ismaning

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Gjuhë frënge (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore dhe
Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Gjuha frënge, si gjuhë e huaj e dytë, vazhdon të mësohet në klasën e 12 të Shkollës së Mesme të Lartë, me të njejtin status, zakonisht me të njejtin mësimdhënës, me të njejtën metodë për mësimi e saj dhe, kryesisht, në të njejtat kushte dhe rrethana të punës me ato në klasën paraprake, por tani me nxënës jofillestarë. Ata tashmë janë më të rritur, me kapacitete të rritura intelektuale, me një përvojë edhe në mësimin e një gjuhe të huaj të dytë dhe kanë përvetësuar një fjalor jofillestar të gjuhës frënge i cili do të zgjerohet dhe pasurohet në mënyrë progresive. Fjalori paraprak i nxënësve në këtë gjuhë të huaj, me kohë, do të pasurohet gradualisht edhe me një qasje ndërdisiplinare të mësimdhënies së kësaj lënde me lëndët e tjera mësimore. Ky synim mbështetet në krijimin e një atmosfere pozitive dhe garuese gjatë orës së mësimi dhe në identifikimin e mënyrave dhe strategjive të të mësuarit. Ajo do t'u shërbejë jo vetëm si mundësi komunikimi në këtë gjuhë të huaj në botë, por edhe si mundësi ndërtimi e karrierës, e punësimit, e studimeve, etj.

Gjuha frënge do të mësohet me 1 orë mësimi në javë edhe në klasën e 12. Nëpërmjet mësimi të gjuhës frënge nxënësit e kësaj klase do të përvetësojnë një fjalor fillestar të kësaj gjuhe të huaj, të domosdoshëm për komunikim; do të avancojnë më tutje shkathtësitë kryesore gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) dhe do të zhvillojnë kapacitetet intelektuale të tyre në këtë fushë. Ky fjalor fillestar i nxënësve në këtë gjuhë të huaj, me kohë, do të pasurohet gradualisht edhe me një qasje ndërdisiplinare të mësimdhënies së kësaj lënde me lëndët e tjera mësimore. Ky synim mbështetet në krijimin e një atmosfere pozitive dhe garuese gjatë orës së mësimi dhe në identifikimin e mënyrave dhe strategjive të të mësuarit.

Qëllimi

Mësimi i gjuhës frënge në klasën e 12 kërkon arritjen e njohurive gjuhësore sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (1/4 e nivelit A2), të përcaktuara në bazë të numrit të orëve mësimore në javë, të cilat janë të matshme nga institucione përkatëse të kësaj fushe, që përfshijnë përvetësimin e një fjalori fillestar të gjuhës frënge nga nxënësit dhe përdorimin elementar të tij për nevoja personale; njohjen dhe dallimin e formave të sistemit gjuhësor (fonetikë, morfologji, sintaksë); përforcimin e mëtejme të shkathtësive gjuhësore receptive (të dëgjuarit dhe të lexuarit) dhe shkathtësive produktive (të folurit dhe të shkruarit); rritjen e kapaciteteve intelektuale të tyre; konsolidimin dhe integrimin e njohurive; formimin e të menduarit kritik dhe krijues; zbulimin e një kulture të re për ta dhe formimin e gjykimit të drejtë për botën; formimin e një personaliteti tolerues, respektues, bashkëpunues dhe human dhe formimin e një qytetari të dobishëm dhe të përgjegjshëm për shoqërinë.

Temat dhe rezultatet e të nxënësit

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënësit të lëndës për temë (RNL)
Tekste letrare dhe joletrare	Relacionet	TË DËGJUARIT <ul style="list-style-type: none"> • Kupton biseda të thjeshta kur flitet për relacionet në mes të njerzve. • Arrin të kuptojë tema të thjeshta rreth mediave.

Pjesët skenike, teatri, dramatizimi, etj	Puna	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon dhe dallon biseda që kanë të bëjnë me CV. • Kupton elementet kryesore te një bisede që ka të bëjë me vendbanim nese flitet rrjedhshëm.
	Mediat	TË FOLURIT <ul style="list-style-type: none"> • Flet për relacionet e tij me të tjerë . • Përshkruan mënyrën e jetesës dhe vendbanimin. • Tregon për gjuhët që flet dhe për shkathtësitë. • Pyet dhe përgjigjet në pyetje që kanë të bëjnë me përdorimin e mediave dhe rrjeteve sociale.
Sistemi i gjuhës	Banimi	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor fjali të memorizuar nga mediat, duke i adaptuar për vete.
		TË LEXUARIT <ul style="list-style-type: none"> • Kupton dhe analizon një reklamë. • Kupton tekste të thjeshta që tregojnë mënyren e jetesës. • Informohet për oferta të ndryshme të punës . • Identifikon informatat kryesor të një CV-je. • Kupton shkurtesat kryesore të përdorura në rrjetet sociale.. TË SHKRUARIT <ul style="list-style-type: none"> • Di të plotësojë një CV me informata bazike të tij. • Përshkruan një lagjen ku banon. • Shkruan një letër duke përshkruar relacionin e tij me të tjeret. • Përdor shkurtesa të rrjeteve sociale.

Udhëzime metodologjike

Procesi i mësimdhënies për fushën Gjuhët dhe Komunikimi duhet të bazohet në nevojat dhe interesat e nxënësve, në funksion të zhvillimit të individualitetit dhe kreativitetit të tyre. Nxënësit e kësaj klase që mësojnë gjuhën frënge duhet të arrijnë kompetencat e tyre nëpërmjet mësimi dhe qasjes së integruar. Suksesi i tyre arrihet përmes rezultateve të fushës kurrikulare. Metodot, format, mjetet, përmbajtjet mësimore si dhe strategjitë e teknikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, janë çelës kryesor për arritjen e këtyre kompetencave. Për arritjen e rezultateve për tema të caktuara ndërkurrikulare si: edukimi qytetar, edukimi për paqe, ndërvarësia, edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, mësimdhënësi duhet të përzgjedhë metodën, formën dhe strategjinë e duhur.

Parimet didaktike-metodike

Të mësosh frëngjishten si gjuhë e huaj do të thotë të përvetësosh njohuri të caktuara dhe të jesh në gjendje t'i përdorësh në situata të jetës reale. Për këtë qëllim duhet ndjekur dy parime kryesore: 1) përqendrimi në komunikim dhe jo si deri më tani përqendrim në gjuhë; 2)

përqendrimi në nxënësin dhe në nxënien e tij. Përvetësimi i shkathtësive gjuhësore zë vend parësor në mësimin e gjuhëve të huaja.

Forma komunikative e mësimdhënies

Mësimdhënia më e mirë e kësaj gjuhe të huaj të gjallë bëhet në formë komunikuese, prandaj komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme. Kjo formë e mësimdhënies ua mundëson nxënësve arritjen e mjeteve gjuhësore që u nevojiten për t'u shprehur në klasë, kurse më vonë edhe në situata të caktuara të jetës së përditshme. Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Pikënisja e një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregull gramatikore, por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo anasjelltas.

Metodat e mësimdhënies

Për mësimin e gjuhës frënge mësimdhënësi duhet të përdorë metoda bashkëkohore sepse vetëm ato nxisin komunikimin e drejtpërdrejtë në këtë gjuhë dhe jo metodën tradicionale (megjithëse ajo mund të mbetet si një metodë ndihmëse në një fazë të parë të mëimit të saj). Natyrisht, ato stimulojnë përdorimin e gjuhës frënge gjatë orës së mëimit, aq sa njohuritë paraprake të nxënësve e mundësojnë të kuptuarit e tyre. Puna në grupe ose në qifte, dialogjet e shkurtra, lojërat në role, tekstet e shkurtra, materialet pamore dhe format e punës që nxisin punën e pavarur, kreativitetin dhe frymën garuese të nxënësve në klasë, po ashtu, janë shumë të rëndësishme. Duhet përdorur metodologji të punës që nxitin aktivitetet prodhuese të nxënësve.

Renditja e veprimeve

Për një mësim të efektshëm të frëngjishtes si gjuhë e huaj e dytë është e nevojshme të respektohet kjo renditje e shkathtësive gjuhësore: të dëgjuarit dhe të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit. Puna aktive dhe konkrete: mësimdhënësit duhet të kenë parasysh kushtet dhe rrethanat e punës (si një mes jofrankofon) që dallohen shumë nga ato të Francës ose të një vendi tjetër frankofon. Ushtrimet duhet të zënë vend meritore, varësisht nga llojet e tyre. Ato mund të bazohen në të dëgjuar, në të shikuar dhe në të shkruar.

Korrigjimi i gabimeve të nxënësve

Mënyrat e korrigjimit të gabimeve të nxënësve diskutohen shpesh dhe në mënyrë kundërtë në rrethin e mësimdhënësve. Disa i shohin gabimet si pengesë në procesin e mësimdhënies, të tjerët i shohin si ndihmesë në përvetësimin e gjuhës së huaj. Ndërsa disa prej tyre mendojnë që ato duhet të korrigjohen menjëherë që të mos përseriten, të tjerët mendojnë që ato nuk duhet të korrigjohen me çdo kusht. Sido që të jetë, nxënësit nuk duhet ndëshkuar, qortuar apo kritikuar për gabimet e bëra.

Mësimdhënia / nxënia e diferencuar

Asnjë klasë nuk ka përbërje homogjene nxënësish sa u përket njohurive të tyre paraprake nga gjuha frënge dhe aftësive psikofizike dhe intelektuale të tyre, prandaj mësimdhënësit duhet të organizojnë orën mësimore mbi këtë bazë. Kjo nënkupton që nxënësit që kanë aftësi për nxënie më të shpejtë të trajtohen ndryshe nga të tjerët në mënyrë që mësimi i gjuhës frënge të jetë në përputhje me mundësitë dhe aftësitë individuale të secilit nxënës.

Teknikat e punës

Një ndër detyrat e mësimdhënies në gjuhën e huaj është edhe aftësimi i nxënësve që të përgatiten dhe të marrin përgjegjësinë për të mësuarit individual. Nxënësit të cilët kanë mundësi për të menduar për proceset e nxënies së gjuhës frënge dhe të organizojnë procesin e të mësuarit të saj

në grup, zakonisht arrijnë sukses më të mirë. Në këtë mënyrë ata, përveç tjerash, mund të përgatiten që të reagojnë në mënyrë të pavarur në situatat jashtëshkollore dhe të vazhdojnë proceset e mësimit të gjuhës.

Përdorimi i mediave

Kompjuteri dhe interneti përbëjnë një mjet shumë të dobishëm dhe të përhershëm që duhet shfrytëzuar si nga arsimtari ashtu edhe nga nxënësit. Emisionet shkollore kushtuar gjuhës ose kulturës frënge të ne, programet e filmit dhe ato të dramës dhe emisionet e ndryshme televizive të jashtme në gjuhën frënge janë një mjet i fuqishëm që do të ndihmojë dhe përshpejtojë përvetësimin e saj nga nxënësit tanë.

Filmi, teatri, muzika, po ashtu, përbëjnë mjete të rëndësishme motivuese për arritjen e rezultateve më të mira në përvetësimin e gjuhës frënge. Fotografitë ndihmojnë sajimin e teksteve kreative dhe përshkruese. Ato tregojnë një ngjarje, fillimin ose mbarimin e së cilës e përshkruan fotografia. Videoprojektori rrit interesimin e nxënësve për mësimin e saj. Kjo arrihet me: prezentimin e fotografive, vizatimeve, tregimeve të ilustruara dhe të teksteve përmes folive dhe projektorit. Materiali auditiv mundëson ballafaqimin me frëngjishten standarde dhe nxit të kuptuarit e nxënësve përmes dëgjimit. Videomateriali u jep nxënësve mundësi të shumta për sajimin e teksteve me shkrim dhe me gojë. Shfaqja e një filmi të punuar mbi bazën e një tregimi ose përralle nxit krahasimin me tregimin ose me përrallën e lexuar ose të dëgjuar më parë.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërlëndore / ndërkurrikulare

Mësimi i një gjuhe të huaj ofron mundësi të shumta për lidhje ndërlëndore dhe ndërprogramore, në të gjitha nivelet. Këto lidhje do të përfshijnë sidomos ato të gjuhëve (gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj të parë dhe gjuhës së huaj të dytë); të shkencave shoqërore (edukatën qytetare, historinë, gjeografinë, etj.); të arteve të llojeve të ndryshme; por edhe të shkencave të natyrës. Në këtë mënyrë, në njërën anë, përmes njohurive nga lëndët e tjera, nxënësit do të ndihmohen në përvetësimin më të suksesshëm të gjuhës frënge, në anën tjetër, përmes njohurive nga gjuha frënge, ata do të zgjerojnë dhe përforcojnë njohuritë e tyre paraprake nga lëndët e tjera. Përmbajtjet e çështjeve ndërkurrikulare dalin nga temat lidhur me paqen, të drejtat e njeriut, zhvillimin e mediave, barazinë gjinore, shkathtësitë për jetë, kujdesin ndaj mjedisit, shëndetin dhe mirëqenien etj. Çështjet ndërkurrikulare mund të realizohen nëpërmjet projekteve të natyrave të ndryshme, debateve për tema të caktuara, diskutimeve, hulumtimeve lidhur me shkeljen e të drejtave të fëmijëve, vizitave të institucioneve shëndetësore, etj. Kjo do të arrihet përmes një çasjeje të integruar të mësimdhënies së gjuhës frënge me çështje, aspekte dhe fusha të ndryshme të lëndëve të ndryshme. Kjo çasje e bën më të lehtë dhe më të shpejtë përvetësimin e njohurive nga kjo gjuhë dhe njëkohësisht ato integrohen mes vete dhe bëhen shumë më të qëndrueshme. Prandaj, gjatë përgatitjes së planit vjetor caktohen temat mësimore që janë në funksion të të gjitha lëndëve mësimore. Për të ndihmuar këtë kërkohet që planet vjetore të kenë formatin e njëjtë në të cilin shënohet korrelacioni i cili do të ndihmojë funksionimin e lidhjes ndërmjet fushave dhe lëndëve.

Udhëzime për vlerësimin

Për fushën Gjuhët dhe Komunikimi vlerësimi bëhet me qëllim të mbledhjes, sistemimit, evidentimit dhe raportimit të të dhënave për arritjet e nxënësve gjatë gjithë procesit të mësimnxënies. Vlerësimi i rezultateve të arritura të nxënësve në mësimin e gjuhës frënge u siguron nxënësve informacione për nivelin e përvetësimit dhe të arritjes së kompetencave. Vlerësimi duhet të përqëndrohet në njohjen e fjalorit të gjuhës frënge, në të kuptuarit e tij në një kontekst të caktuar dhe në përdorimin e tij në komunikimin e përditshëm, duke zbatuar njohuritë e tyre nga fonetika, gramatika dhe përvojën e tyre paraprake në komunikimin në gjuhën angleze. Gjatë të shprehurit gojor dhe shkrimor vlerësohet përvetësimi i drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit. Natyrisht, për vlerësimin e njohurive dhe shkathtësive gjuhësore të nxënësve duhet të mbështetemi në qëllimin e vlerësimit, në informatat cilësore për vlerësim, në vlerësim të balancuar, në shkallën e saktë të arritshmërisë së nxënësve dhe në përdorimin e instrumente adekuate për vlerësim (vrojtimi, pyetësi, të shprehurit me gojë, të shprehurit me shkrim, testi i bazuar në kriteret dhe objektiva dhe testi i arritshmërisë sipas kërkesave).

Llojet e vlerësimeve: ekzistojnë lloje të ndryshme të vlerësimit të njohurive të nxënësve si: vlerësimi diagnostik (identifikimi i aftësive dhe vështirësive të nxënësve në mësim); vlerësimi i jashtëm (vlerësim nëse njohuritë e fituara mjaftojnë që nxënësi të kalojë në klasën e radhës); vlerësimi formativ (vlerësimi për të nxënë); vlerësimi parashikues (parashikim i dështimeve dhe sukseseve potenciale të nxënësve); vlerësimi përfundimtar (përparimi i nxënësve dhe rezultatet e arritura në mësim); vlerësimi selektiv (vetëvlerësimi nga nxënësit i arritjeve dhe problemeve të tyre në mësim); vlerësimi somativ (mundëson vlerësimin e njohurive dhe kompetencave të fituara nga nxënësi në fund të një viti shkollor, klasifikimin e nxënësve dhe konstatimin nëse nxënësi i ka arritur kompetencat për të hyrë në provimin e maturës); vlerësimi formativ (konsiston në vlerësime interaktive që tregojnë të arriturat dhe progresin ose mangësitë e nxënësve gjatë të nxënimit).

Çfarë duhet të vlerësohet? Të kontrollohen njohuritë e fituara; përparimi i nxënësve; shkalla e zhvillimit të nxënies; shkalla e zotërimit të gjuhës frënge; shkalla e integritit të njohurive të fituara; aktivitetet jashtëshkollore.

Mënyrat e vlerësimit: kontrolli i vazhdueshëm; vlerësimi i drejtpërdrejtë (me tabelë); vlerësimi i tërthortë (me test); vlerësimi objektiv (me tabelë); vlerësimi subjektiv (pa tabelë); vlerësimi nga nxënësit (vlerësimi i njëri-tjetrit); vlerësimi në grupe nxënësish brenda klase (me tabelë); vetëvlerësimi i nxënësve (secili nxënës vlerëson vetveten).

Kriteret e vlerësimit: aktivitetet e të shprehurit; të shprehurit gojor; të shprehurit me shkrim; aktivitetet e receptimit (të kuptuarit gojor dhe të kuptuarit me shkrim); aktivitetet e riprodhimit (të shprehur me gojë dhe me shkrim. Notat numerike jepen sipas shkathtësive gjuhësore: të dëgjuarit; të folurit; të lexuarit; të shkruarit (5, 4, 3, 2, 1).

Udhëzime për materialet dhe burimet e tyre

Për arritjen e rezultateve të nxënësve të klasës së 12 në gjuhën frënge, në rend të parë është i rëndësishëm përdorimi i literaturës didaktiko-metodike të kësaj gjuhe të huaj (në gjuhën shqipe

dhe frënge), i materialeve të pasura didaktike nga burime (linqe) të ndryshme përmes internetit për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Për realizimin e rezultateve të fushës dhe për arritjen e suksesshme të rezultateve për lëndë, të gjitha mjetet dhe materialet mësimore duhet t'u përmbahen kërkesave të këtyre rezultateve. Metoda franceze për mësimin bashkëkohor të gjuhës frënge, "Interactions", vëllimi 2), e lejuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë për përdorim në ShML të Republikës së Kosovës, bashkë me pjesët përbërëse të saj, përbën mjetin kryesor të punës dhe burimin kryesor të informatave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, por jo edhe të vetmin mjet dhe burim që mësimdhënësi i gjuhës frënge dhe nxënësit e tij mund dhe duhet të përdorin. Ata kanë në dispozicion mundësi shumta për sigurimin e mjeteve mësimore të pasura, nga burime të ndryshme për marrjen e informacionit, me kusht që ato të përzgjedhen me kujdes, varësisht nga mosha e nxënësve, njësia mësimore, qëllimi i saj dhe të përdoren në mënyrë të përshtatshme për nxënësit.

FUSHA KURRIKULARE: ARTET

Kurrikulat lëndore/programet mësimore
Arti figurativ (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Art figurativ (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda Art figurativ është një nga lëndët e rëndësishme brenda fushës kurrikulare Artet, e cila ka një ndikim dhe rol të veçantë në edukimin dhe zhvillimin shumëdimensional të personalitetit të nxënësve, duke kultivuar të gjitha vlerat intelektuale, sociale, artistike, shpirtërore dhe emocionale tek nxënësit. Andaj përmes lëndës së artit pamor nxënësit do të ngrisin vetëdijen mbi rolin dhe rëndësinë e pazëvendësueshme të artit për individin dhe shoqërinë në përgjithësi.

Edhe në klasën e 12 lënda e artit ka katër koncepte kryesore, përmes të cilave janë organizuar tërësitë dhe përmbajtjet e saj kryesore, të cilat kontribuojnë në arritjen e kompetencave kryesore, duke përgatitur nxënësit për punë dhe jetë, si një individ produktiv në shoqëri, me një vetëdije dhe mendim kritik si qytetar aktiv dhe i përgjegjshëm që kultivon kulturën reaguese edhe përmes artit.

Në klasën e 12 nxënësit i zgjerojnë dhe avancojnë njohuritë dhe shkathtësitë krijuese, dhe përdorin ato për të komunikuar idetë, ndjenjat, qëndrimet për çështje dhe probleme të ndryshme. Në këtë nivel fokusi më i madh i lëndës do të jetë te njohja dhe aplikimi i rrymave dhe medimeve alternative të artit bashkëkohor e postmodern, përmes të cilave nxënësit materializojnë shprehjet e tyre artistike në vepra arti.

Gjithashtu në këtë nivel nxënësit do të rafinojnë shijen e tyre estetike për të analizuar, vlerësuar, shijuar e gjykuar vlerat e veprave artistike.

Qëllimi

Lënda e artit figurativ për klasën e dymbëdhjetë, nëpërmjet përmbajtjeve të përcaktuara sipas tematikave, ka si qëllim avancimin e njohurive shkathtësive ekzistuese.

Në fund të klasës së dymbëdhjetë, nxënësi:

- zotëron njohuri dhe koncepte më të zgjeruara për artin pamor;
- rafinon formimin estetik, artistik, personal, intelektual, social dhe kulturor;
- kupton rolin dhe rëndësinë e artit për individin dhe shoqërinë;
- Zhvillon shkathtësi kreative e artistike në punime artistike;
- Përdor medimet e artit për të komunikuar ndjenjat, idetë dhe mendimet;
- Aplikon organizimin kompozicional të elementeve dhe parimeve të artit në punime artistike;
- përzgjedh dhe përdor materiale, teknika dhe mjete të ndryshme artistike në vepra arti;
- Rafinon shijen estetike për të vlerësuar e gjykuar vepra të artit;
- Kultivon mendimin kritik dhe kulturën reaguese përmes artit;
- Zhvillon aftësinë për të identifikuar veprat e artit nëpërmjet periudhave, përmbajtjeve, temave, stileve, metodave, teknikave dhe materialeve.

Temat dhe rezultatet dhe të nxënës

Nxënësist në klasën e dymbëdhjetë arrijnë rezultatet e të nxënës të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënës të fushës (RNF) Artet, të shkallës së gjashtë të kurrikulës (Shk 6) në Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë:

Koncepti	Tema	Rezultatet e të nxënës të lëndës për temë (RNL)
<p>Krijimtari a dhe performanca artistike</p>	<p>Krijimi i punimeve artistike</p> <p><i>(Vizatimi, Piktura, Grafika, Skulptura, Artet aplikative, Dizajni, Fotografia, Arkitektura, Arti publik video art, instalacion, performancë, land art, body art, art konceptual, minimalizmi etj.)</i></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon dhe praktikon llojet e ndryshme të vizatimit bashkëkohor; • eksperimenton dhe aplikon teknika të ndryshme të vizatimit bashkëkohor; • eksperimenton me teknika bashkëkohore e të kombinuara të pikturës gjatë procesit kreativ; • përdor simbolikën e ngjyrës në punimet artistike; • Aplikon teknikat e grafikës gjatë të shprehurit artistik; • Përdor formën në aranzhime të ndryshme kompozicionale; • Përdor skulpturën tridimensionale në mediumet bashkëkohore; • Aplikon realievin në punimet e ndryshme plastike; • Realizon fotografi me vlera artistike, estetike, konceptuale; • Përpunon imazhe fotografike duke përdorur programe të ndryshme kompjuterike; • përdor llojet e ndryshme të artit publik për të shprehur qëndrimet dhe idetë artistike; • nje rëndësinë e artit aplikativ për jetën e përditshme; • Realizojnë punime të ndryshme të artit aplikativ; • Realizojnë punime të ndryshme në dizajn; • Dizajnon objekte të ndryshme arkitekturore; • Realizon dizajne të enteriereve bashkëkohore; • Realizon në materiale të ndryshme maketa të konstruksioneve të ndryshme arkitektonike. • Njeh mediumet e artit bashkëkohor; • Realizon punime artistike në mediumin e Videoartit; • Realizon performanca të ndryshme artistike; • Dallon dhe krijon vepra të ndryshme artistike në mediumin e instalacionit; • Kupton mediumin e artit të tokës; • Eksperimenton me artin e trupit; • Dallon artin konceptual dhe realizon punime konceptuale.

<p>Gjuha dhe komunikimi artistik</p>	<p>Elementet figurative</p> <p><i>(Vija, forma, ngjyra, tonaliteti, vëllimi, tekstura, hapësira, madhësia, zëri, lëvizja etj)</i></p> <p>Parimet e artit</p> <p><i>(Baraspesha, harmonia, kompozimi, gradacioni, bashkësia, proporcionet, sipërfaqja, ritmi, kontrasti)</i></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon elementin e vijës si element i gjuhës artistike; • përdor lloje të ndryshme të vijave për të pasqyruar ide, ndjenja të ndryshme; • aplikon format dy dhe tri dimensionale; • përdor formën si element i rëndësishme i gjuhës pamore • studion dhe gjen nuanca të veçanta të ngjyrave në vepra arti; • aplikon ngjyrat sipas ndjeshmërisë subjektive në punimet artistike; • përdor tone të ndryshme të dritëhijes në vepra artistike; • krijojnë idenë e vëllimit në vepra dy dhe tri dimensionale; • eksperimentojnë me tekstura të ndryshme në punime artistike; • Shpjegon rolin dhe rëndësinë e tekstarave në art; • Njeh elementet bazë të hapësirës në art; • Njeh vijën e horizontit për të krijuar iluzionin e hapësirës; • Përdor perspektivën lineare me një, dy dhe tre në punimet artistike; • Kompon kompozicione artistike sipas parimeve artistike; • Identifikon dhe aplikon llojet e ndryshme të kompozicionit në punimet e tyre artistike • Aplikon parimin e baraspeshës në punimet artistike; • Njeh rëndësinë e harmonisë dhe harmonizimit të elementeve artistike në një vepër arti; • Dallon llojet e ndryshme të harmonive; • Respekton parimin e proporcionalitetit gjatë pasqyrimit të gjërave reale në punimet artistike; • Njeh rëndësinë e proporcioneve për imitim të sakt në art; • Përdor rregulla dhe kanone të ndryshme të proporcionalitetit; • Realizon sipërfaqe të ndryshme artistike me anë të elementeve të artit; • Dallojnë llojet e ndryshme të sipërfaqeve dhe rëndësinë e tyre në art; • Analizojnë ritmin në punime të ndryshme artistike të artistëve të njohur dhe në punimet e tyre apo të shokëve; • Dallon vlerën e kontrastit të elementeve të ndryshme
---	---	--

		<p>figurative;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aplikon kontraste të forta dhe të buta në punime artistike; • Përdor parimet dhe elementet e artit bashkëkohor.
Relacioni art – shoqëri	Aktivitete kulturore artistike -	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Merr pjesë në ekspozita shkollore dhe jashtëshkollore; • Merr pjesë në projekte të ndryshme artistike brenda dhe jashtë shkollës; • Ndjek aktivitete të ndryshme artistike si ligjërata, prezantime, takime me artistë, kurator, estet, filozof të artit; • Ndjek seminare dhe ngjarje tjera të artit; • Merr pjesë në konkurse të ndryshme artistike etj.
	Ngjarje artistike	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njef dhe viziton ngjarje artistike të njohura brenda dhe jashtë vendit; • Viziton ekspozitat e njohura kombëtare dhe ndërkombëtare (bienale, festivale etj.); • Viziton altele dhe studio të artistëve; • Viziton galeri arti të njohura brenda dhe jashtë vendit; • Viziton muze arti kombëtar dhe ndërkombëtar; • Viziton institucione të ndryshme të artit, qendra kulturore, • Realizon vizita virtuale në internet të institucioneve të artit, muze galeri në faqe të ndryshme etj
	Institucionet e artit	
	Periudhat historike të artit	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kupton zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit; • përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit; • Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike; • Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik; • Identifikon përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike; • Identifikon dhe dallon kryeveprat artistike të artistëve të njohur;
	Drejtimit, rrymat dhe zhanret e artit	
	Vepra arti	<ul style="list-style-type: none"> • Shqyrton rëndësinë e artit përgjatë zhvillimeve të ndryshme historike për shoqërinë; • analizon veprat e artit në kontekstin e tyre historik duke i lidhur me ngjarjet e rëndësishme shoqërore e

	Artistët e njohur	<p>sociale;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon zhvillimet e ndryshme shkencore, teknologjike, sociale që ndikuan në zhvillimin e artit; • Përshkruan dhe vlerëson vepra arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore të trojeve shqiptare; • Identifikon dhe analizon simbolet në vepra të artit për të lexuar kuptimin e tyre; • Identifikon dhe analizon elementet dhe parimet e gjuhës pamore dhe teknikën e përdorur në vepra të artit.
Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik	<p>Vlerësimi i Periudhave dhe drejtimeve të artit</p> <p>Vlerësimi i Veprave artistike</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Reflektinë mendimin dhe gjykimin e tij mbi një vepër arti, përmes formave të ndryshme të të shprehurit si përmes shkrimit (esesë), poezisë etj.; • Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke përshkruar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike; • Kultivon aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike dhe rafinon shijen e tij estetike në art; • Zhvillojnë aftësinë se Si të lexojmë një vepër arti; • Njihen me metodat dhe hapat që ndjekin kritikët për të vlerësuar veprat e artit; • Dallon objektin e studimit të estetikës dhe cilësitë estetike në një vepër arti; • Krijojnë kulturën debatuuese për diskutimin dhe trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit;

Udhëzime metodologjike

Për organizimin sa më të mirë të procesit mësimor, për një mësimdhënie dhe mësimnxënie të suksesshme dhe për realizimin e planprogramit mësimor në lëndën e artit pamor duhet të përdoren metodologji të ndryshme të mësimdhënies. Këto metodologji janë në shërbim të rritjes së cilësisë së sukseseve dhe arritjeve të mësimnxënjes nga ana e nxënësve, duke i ofruar mundësinë që të shfaqin dhe të zhvillojnë potencialin krijues/artistik që zotërojnë brenda vetes.

Metodologjitë duhet të jenë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, koncepteve, shkathtësive dhe në harmoni me rezultatet e të nxënësve të lëndës së artit pamor (RNL), fushës së arteve (RNF) dhe kompetencave kryesore të Kurrikulës Bërthamë (RNK).

Përzgjedhja e metodologjive është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës, dhe ato përgjithësisht në përputhje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Duke marrë për bazë natyrën e lëndës së artit pamor që më tepër është veprimtari praktike, ku nxënësit realizojnë vepra të ndryshme artistike, edhe metodologjitë përzgjidhen në atë mënyrë që nxënësi të motivohen për pjesëmarrje aktive në këto aktivitete si një mundësi që ata përmes përdorimit të mjeteve të larmishme artistike të reflektojnë idetë, qëndrimet dhe mendimet e tyre. Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në artin pamor.

Mësimdhënia në artin pamor synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet në *mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien dhe nxënien e integruar.*

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor merr parasysh:

- Zhvillimin dhe forcimin e njohurive dhe shkathtësive bazë të artit pamor duke u mbështetur në ato paraprake;
- Kompetencat kryesore të të nxënësve në artin pamor;
- Nxitjen e të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- Motivimin e nxënësve, për krijimtari artistike dhe punë të pavarur
- Rëndësinë e veprimtarive praktike në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës
- Rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- Veçoritë e veprimtarive individuale dhe në grup;
- Nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit pamor dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të tij;
- Nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënë në procesin mësimor
- Eksperiencat gjatë vizitave nëpër institucione të artit (galeri, muze)

Secila metodologji duhet të jetë në shërbim të interesave dhe nevojave të nxënësve dhe t'i inkurajojë ata të kenë besim në arritjen e suksesit në fushën e artit.

Për të zhvilluar sukseshëm procesin mësimor mësimdhënësit duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë, të stimulojë dhe inkurajojë nxënësit për pjesëmarrje në veprimtari të ndryshme duke planifikuar shumëllojshmëri aktivitetesh, materialesh, teknikash dhe informacionesh ku nxënësit të kenë mundësi për të eksploruar sa më shumë mbi artin pamor.

Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave pamore/artistike.

Format e punës në lëndën Art figurativ

Në procesin mësimor të realizimit të përmbajtjeve programore të lëndës së artit pamor aplikohen forma të ndryshme të punës:

- individuale
- në çifte
- në grupe
- me tërë klasën

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare janë tema dhe probleme shumë të rëndësishme, të cilat duhet njohur dhe trajtuar në mënyrë të veçantë nga secila lëndë. Ato janë tema me interes të veçantë për shoqërinë, sa janë aktuale janë edhe të vazhdueshme, përmes të cilave nxënësit fitojnë, zhvillojnë dhe përvetësojnë disa aftësi dhe njohuri specifike, në mënyrë që të përgatiten për jetën dhe punën në të ardhmen dhe të përballojnë dhe tejkalojnë me lehtë sfidat e jetës.

Çështjet ndërkurrikulare janë tema me të cilat vazhdimisht është ballafaquar shoqëria njerëzore, të cilat synojnë krijimin dhe kultivimin e disa vlerave shoqërore, humane e njerëzore, të cilat kontribuojnë në formimin e identitetit dhe personalitetit individual dhe të pavarur të nxënësve.

Çështjet ndërkurrikulare janë çështje që domosdo janë të ndërlidhura me rezultatet e fushave ku integrohen dhe kontribuojnë të gjitha fushat kurrikulare në forma të ndryshme duke përfshirë edhe e fushën e arteve me lëndët e saj, e cila i ndihmon nxënësit të njohin, kuptojnë dhe të interpretojnë më mirë botën, ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

Nga mësimdhënësi kërkohet që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e fushës, temat dhe njësitë mësimore dhe të parashih se me cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhen. Në këtë mënyrë sigurohet trajtimi sa më i mirë i këtyre çështjeve duke marrë parasysh edhe mësimdhënien e integruar.

Çështjet ndërkurrikulare që mund të ndërlidhen dhe trajtohen në lëndën e artit figurativ janë:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media,
- Arsimit për zhvillimin të qëndrueshëm

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të të nxënësve. Vlerësimi përfshin tërë veprimtarinë dhe konsiderohet si element i mësimdhënies që ndihmon mësimdhënësit për ndjekjen e zhvillimit gradual në arritshmërinë e rezultateve të të nxënësve në nivel klase dhe shkolle të nxënësit si dhe zotërimin e kompetencave. Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore në arritjen e rezultateve mësimore dhe kompetencave të përcaktuara për këtë nivel, po ashtu, metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies është e lidhur ngushtë me procesin e vlerësimit të nxënësve ngase është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore.

Ky proces vlerësimi shtrihet që nga vlerësimi dhe vetëvlerësimi i punimeve të nxënësve të realizuara me teknika të larmishme artistike, portofoli me punë artistike, prezantimi me gojë dhe me shkrim, testimi, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.

Vlerësimi në artin figurativ, mbështetet në parimin e individualizimit, ngase arritjet janë më shumë individuale, ku çdo nxënës ka predispozita dhe prirje të ndryshme për format e shprehjes artistike.

Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale dhe krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit. Vlerësimi individual i nxënësve bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes krijimit, vëzhgimit, dhe analizës së veprave të artit etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Portofoli i nxënësit si me krijimet, shkrimet, prezantimet dhe testimi janë një mundësi objektive e vlerësimit të nxënësit, pasi i përgjigjet edhe vlerësimit sipas kompetencave të lëndës së artit pamor.

Qëllimet e vlerësimit:

- *Të identifikohet përparimi i nxënësve dhe t'u ofrohen të dhëna të mjaftushme.*
- *Të motivohen nxënësit për punë*
- *Të sigurohen informacione për shkallën e arritshmërisë së kompetencave*
- *Të diagnostikojnë pikat e dobëta dhe të forta tek nxënësit.*
- *Të përmirësohen nxënia dhe mësimdhënia*
- *Të japin detyra sipas aftësive individuale në përputhje me nivelin e nxënësve.*
- *Të përzgjedhin metoda të përshtatshme gjatë mësimdhënies, bazuar në nivelin e klasës.*
- *Të sigurohen informacione për zhvillimin e nxënësve për orientimin e tyre të ardhshëm*

Format dhe instrumentet e ndryshme të vlerësimit

Gjatë procesit të vlerësimit sugjerohet që mësimdhënësit përdorin forma dhe instrumente të ndryshme vlerësimi, duke u ofruar nxënësve jo vetëm kritere të shkruara, por edhe lloje të tjera të vlerësimit, për të kuptuar në mënyrë konkrete arritjet të cilat ata i synojnë. Instrumentet për vlerësim gjithmonë duhet të jenë të përshtatshme, varësisht prej qëllimit të vlerësimit. Forma dhe lloji i vlerësimit dhe veçanërisht mënyra në të cilën rezultatet raportohen, gjithmonë duhet të reflektojnë qëllimin e vlerësimit. Mënyra e ndërtimit të vlerësimit gjithmonë duhet të jetë transparente dhe e drejtë. Vlerësimi gjithmonë duhet të zbatohet me standardet më të larta etike. Vlerësimi i nxënësve duhet të jetë motivues dhe objektiv.

Metodat e vlerësimit

- **Vlerësimi me gojë** - përdorimi i pyetjeve të shkurtra, biseda rreth materialit mësimor apo një detyre konkrete, diskutime të nxënësve me njëri tjetrin etj.
- **Vlerësimi me anë të dëgjimit** - duke diskutuar me nxënës të veçantë, grupe apo me gjithë klasën, duke dëgjuar diskutimet që bëjnë nxënësit me njëri - tjetrin për një koncept, mbi njohuri të arteve pamore, vepër apo detyrë artistike etj.

- **Vlerësimi i detyrave të realizuara** - vëzhgimi hap pas hapi i detyrave të artit, që nga ideimi deri tek organizimi dhe realizimi si p.sh: demonstrimi i arritjeve në punë konkrete (fjala vjen realizimi i punëve dy dhe tredimensionale, interesimi për ndjekjen e jetës artistike në komunitet, pasioni, vlerësimi dhe përkushtimi ndaj kësaj lënde etj).
- **Vlerësimi i projekteve të ndryshme**-bashkëpunimi i nxënësve në një projekt në bazë shkolle apo krahine.
- **Vlerësimi i punëve artistike** - marrja pjesë në veprimtari të ndryshme artistike që organizon shkolla etj., pjesëmarrja në veprimtari kombëtare si: konkurset, ekspozitat në shkallë vendi apo më gjerë.
- **Vlerësimi me shkrim ose testimi** - detyra të veçanta për grupe nxënësish, teste të shkurtra për një koncept, temë apo dhe një grup temash, për një ese si dhe testime për një linjë të caktuar, semestrare dhe vjetore.
- **Vlerësimi përmes portofolit** - portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra tematike (ese), krijime të ndryshme dy dhe tredimensionale të realizuara gjatë vitit shkollor që mund të jenë krijime në pikturë, skulpturë (plastelinë), kompjuter etj., projekte kurrikulare, të gjitha në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.

Instrumentet e procesit të vlerësimit

- Testi (me shumë zgjidhje, saktë- gabim, përputhje, plotësim, përgjigje e shkurtër dhe kërkesa të hapura);
- Testi i strukturuar me gojë;
- Lista e kontrollit;
- Pyetësi;
- Fleta për intervista;
- Anketa;
- Eseja;
- Projekti;
- Dosja/Portofoli.

Udhëzimet për materialet dhe burimet mësimore

Përzgjedhja dhe përdorimi i mjeteve didaktike e mësimore është pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies, dhe ka një rëndësi të veçantë në arritjen dhe realizimin e kompetencave.

Këto mjete janë në shërbim të demonstrimit dhe konkretizimit të temave dhe njësive mësimore të trajtuara në lëndën e artit, dhe ato duhet të jenë shumë efikase, të prekshme dhe praktike për nxënësit.

Teknologjia është një nga mjetet me përdorim të gjerë në ëndën e artit pamor duke ndihmuar nxënësit të hulumtojnë dhe njohin vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit, etj., duke krijuar tipin studiues të nxënësve në lëndën e artit.

Shkolla si institucion arsimor, duhet të siguroj dhe ofrojë kushte dhe mundësitë tekniko-teknologjike adekuate apo alternative në realizimin dhe arritjen e kompetencave të planprogrameve të lëndëve të caktuara, në këtë rast edhe të lëndës së artit.

Në këtë formë nxënësve u krijon mundësinë të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të medimeve teknologjike detyra dhe projekte të ndryshme.

Mësimdhënësi nxit interesimin e nxënësve për veprimtari dhe trajtim të temave të artit duke përdorur një fjalor të pasur të gjuhës artistike pamore me fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore e konceptuale.

Mësimdhënësi nxit zgjërimit e njohurive mbi artin tek nxënësit duke i motivuar që të përdorin burime, materialeve dhe tekste (Libra) të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Materiale tekstuale: *teksti shkollor, fletore e punës, katalogë arti, albume, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale pedagogjike, enciklopedi etj.;*
- Mjete vizuale – *pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, vazo, riprodhime të veprave të artit dhe postera, diagrame, mjete grafike etj.;*
- Mjete auditive-dëgjimore: *radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;*
- Mjete audiovizuale – *pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, DVD, e-mail-i;*
- Mjedisi mësimor (*klasa, ateleja, kabineti, natyra, galeria, muzeu etj.*).

FUSHA KURRIKULARE: MATEMATIKË

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Matematikë (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Matematikë (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Matematikë (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Matematika si lëndë mësimore luan një rol të rëndësishëm në studimin e fenomeneve natyrore dhe atyre teknike, ndërsa të mësuarit e saj është vlerë e domosdoshme për integrimin në shoqëri duke mundësuar zhvillimin e personalitetit të nxënësit, zhvillimin e aftësive të tij për të menduar në mënyrë kritike dhe për të punuar i pavarur e në mënyrë të vazhdueshme. Matematika e klasës së dymbëdhjetë siguron përsosmërinë e shprehive dhe shkathtësive matematikore dhe arrin zhvillimin intelektual dhe formimin e personalitetit të nxënësve për të qenë të suksesshëm në përballje me sfidat e jetës.

Një nga veçoritë më të rëndësishme të matematikës është integrimi i saj me të gjitha fushat dhe çështjet ndërkurrikulare me qëllim zotërimin e kompetencave kryesore. Me anë të matematikës nxënësi mund të interpretojë sasinë duke përdorur numrat dhe algjebren, të interpretojë format, hapësirën dhe njësitë matëse duke përdorur gjeometrinë dhe matjet, dhe të interpretojë fenomene të rastit duke përdorur statistikën e probabilitetin.

Programi i matematikës së klasës së dymbëdhjetë në vete përmban:

- qëllimet e lëndës së matematikës të cilat i shërbejnë:
 - nxënësit për zhvillimin e kompetencave kryesore të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të fushës së matematikës, në mënyrë që ai në të ardhmen të jetë qytetar i suksesshëm;
 - mësimdhënësit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore, si dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
 - prindërit për njohjen e rezultateve të të nxënësve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore për fëmijën e tij;
 - hartuesitë teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësimdhënësin dhe nxënësin.
- rezultatet e të nxënësve të lëndës për tema mësimore, përmbajtja e të cilave krijon kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të fushës dhe kompetencave kryesore;
- udhëzimet metodologjike të mësimdhënies për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes;
- udhëzimet për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare mbi kontributin e matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme;
- udhëzimet për materiale didaktike, burime dhe mjete mësimore.

Qëllimi

Të mësuarit e matematikës në klasën e dymbëdhjetë ka për qëllim zhvillimin intelektual të çdo nxënësi, ushtrimin e rregullave, kultivimin e vlerave si dhe përgatitjen për të siguruar një bazë solide për vazhdimin e shkollimit të lartë.

Programi i matematikës ka për qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik me idetë bazë për strukturat matematikore dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë për llogaritje dhe për zgjidhjen e problemeve në jetën e përditshme.

Programi i matematikës së klasës së dymbëdhjetë, gjatë zbatimit:

- përzgjedh dhe zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;
- bën vrojtime, hulumtime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe përsosmërinë e shprehive matematike;
- avancojnë të menduarit matematik të nxënësve përmes simboleve dhe gjuhës matematike;
- paraqet koncepte të matematikës i ndërlihd ato dhe i zbaton në zgjidhjen e problemeve.

Qëllimi i lëndës së matematikës në klasën dymbëdhjetë është *promovimi izhvillimit të përgjithshëm dhe konsolidim* i cili bëhet përmes:

- të nxënit të integruar në kontekstin e jetës së përditshme
- përvetësimit të koncepteve elementare dhe ndërtimin e koncepteve të reja.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Përvetësimi i përmbajtjes programore nga nxënësi demonstron si njohuri relevante që atij i parashtrahet në raport me moshën. Shkathtësitë që i demonstroi nxënësi përfshijnë aftësitë, zotësitë, teknikat dhe metodat për zbatimin e njohurive për arritjen e rezultateve të të nxënit të planifikuara për klasë.

Përmes lëndës së matematikës, për klasën e dymbëdhjetë, synohet të zhvillohen dhe përvetësohen kryesisht këto koncepte të përgjithshme matematikore:

- Format dhe hapësira;
- Funksionet dhe ndryshoret

Konceptet e përgjithshme zërthehen në tema, për secilën temë paraqiten rezultatet e të nxënit të cilat bazën mbështetëse e sigurojnë nga rezultatet e të nxënit të fushës për shkallë, që prezantojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me ato tema. Programi lëndor i matematikës për nxënësit e klasës së dymbëdhjetë është i theksuar në drejtim të rezultateve të përgjithshme të të nxënit për lëndë dhe rezultatet specifike të të nxënit për tema dhe njësi tematike.

Rezultatet e përgjithshme janë deklarata gjithëpërfshirëse për atë që nxënësit pritet që të mësojnë në lëndën e matematikës, ndërsa rezultatet specifike janë deklarata që identifikojnë njohuri specifike dhe të kuptuarit për nxënësit që janë të nevojshme për të arritur deri në fund të lëndës. Përmes rezultateve nxënësit në mënyrë të logjikshme bëjnë arsyetime dhe analiza, vërtetime, modelime dhe zgjidhin probleme. Po ashtu nxënësi bën lidhje duke reflektuar mbi të menduarit matematik, lidh koncepte matematike brenda matematikës dhe jasht saj.

I. Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria

Rezultatet e përgjithshme e të nxënit për temë

Nxënësi:

- Përdorë me saktësi simbolet, termet, dhe konceptet e pikës dhe drejtëzës gjatë arsyetimeve analitike dhe zgjidhjes së problemeve të ndryshme gjeometrike dhe praktike
- Zhvillon arsyetimin algjebrik dhe shpreh drejtëzën dhe vijat e shkallës së dytë përmes ekuacioneve të tyre
- Zbaton zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve jolineare në përcaktimin e pozitave reciproke të drejtëzës me vijat e shkallës së dytë dhe të pozitës reciproke ndërmjet vijave të shkallës së dytë

III Funkcionet dhe ndryshoret

Rezultatet e përgjithshme e të nxënit për temë

Nxënësi:

- Përkufizon funksionin si lidhje ndërmjet dy bashkësive numerike
- Zhvillon arsyetimin algjebrik dhe gjeometrik në përcaktimin e fushës së përkufizimit, zerove të funksionit, simetrisë, kufizueshmërisë, monotonisë, shenjës së funksionit, vlerave ekstreme dhe vazhdueshmërisë së funksionit
- Zbaton kuptimin dhe vetitë e funksioneve në kuptimet e mësuara në lëndët tjera mësimore
- Përkufizon vargun, vargun aritmetik, gjeometrik dhe limitin e vargut
- Demonstron shkathtësi në zbatimin e vargjeve dhe limitit të vargut në zgjidhjen e problemeve praktike
- Manifeston kuptimin e limitit të funksionit dhe zbaton atë në përcaktimin e asimptotave të funksionit
- Zhvillon kuptimin e vazhdueshmërisë së funksionit dhe bën interpretimin algjebrik dhe gjeometrik
- Përkufizon kuptimin e derivatit, përdor rregullat në njehsimin e derivateve si dhe interpreton gjeometrikisht ato.

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Forma dhe hapësira, matjet dhe gjeometria	Pika	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjen largësinë ndërmjet dy pikave në boshtin numerik dhe në rrafsh; ▪ Ndan një segment në raport të dhënë; ▪ Gjen koordinatat e mesit të një segmenti të dhënë; ▪ Njehson syprinën e sipërfaqes së trekëndëshit nëse dihen koordinatat e kulmeve të tij; ▪ Zgjidh problemeve të ndryshme praktike; ▪ Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë.
	Drejtëza	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përcakton dhe dallon trajtat e ndryshme të ekuacioneve të drejtëzës në rrafsh nëpërmjet të ekuacioneve të tyre dhe bën kalimin nga një trajtë e ekuacionit të drejtëzës në një trajtë tjetër; ▪ Paraqet gjeometrikisht drejtëzën të dhënë në çfarëdo forme; ▪ Përshkruan në mënyrë analitike dhe paraqet gjeometrikisht pozitën e dy drejtëzave në rrafsh; ▪ Gjen këndin midis dy drejtëzave; ▪ Gjen ekuacionin e drejtëzës që kalon nëpër dy pika të dhëna në rrafsh; ▪ Gjen largësinë e pikës nga drejtëza; ▪ Gjen ekuacionin e simetrales midis dy drejtëzave; ▪ Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë.
	Vijate shkallës së dytë	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkufizon vijat e shkallës së dytë dhe i kupton ato si rrjedhim i prerjeve konike (rrethi, elipsi, hiperbola, parabola); ▪ Njeh terma, fakte, parime dhe koncepte bazë për rrethin, elipsen, hiperbolën dhe parabolën dhe shfrytëzon të gatshme ekuacionet e tyre; ▪ Bën interpretimin gjeometrik të vijave të shkallës së dytë si vend gjeometrik i pikave në rrafsh. ▪ Shqyrton pozitën reciproke ndërmjet vijave të shkallës së dytë dhe drejtëzës ▪ Interpreton gjeometrikisht zgjidhjet e sistemeve të barazimeve jolineare me pozitën reciproke të vijave të shkallës së dytë dhe drejtëzës ▪ Zbaton vijat e shkallës së dytë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme; ▪ Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë.
Funksionet dhe ndryshoret	Funksioni	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkufizon funksionin real; ▪ Cakton fushën e përkufizimit të funksionit; ▪ Gjen zerot e një funksioni nëse ato ekzistojnë; ▪ Shqyrton shenjën, paritetin dhe periodicitetin e funksioneve dhe e interpreton atë gjeometrikisht; ▪ Përkufizon monotoninë, vlerat ekstreme, lakueshmërinë, pikat e lakueshmërisë së një funksioni;

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkufizon funksionin e përbërë dhe e kryen kompozimin e funksioneve; ▪ Përkufizon funksionin invers dhe e gjen funksionin invers të një funksioni, nëse ai ekziston; ▪ Bën klasifikimin e funksioneve; ▪ Gjen shembuj te zbatimit te funksioneve ne jetën reale; ▪ Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë.
	<p>Vargjet numerike dhe limiti i vargut</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkufizon vargun numerik, duke përdorë kuptimin e funksionit; ▪ Përkufizon kufizueshmërinë dhe monotoninë e vargjeve numerike dhe e shqyrton atë për vargje të ndryshme; ▪ Përkufizon vargun aritmetik dhe gjeometrik dhe i dallon ato përmes vetive dhe shembujve; ▪ Zbaton vargjet aritmetike dhe gjeometrike në zgjidhjen e problemeve të ndryshme praktike; ▪ Njeh termat, faktet, parimet dhe konceptet baze të limitit të vargut; ▪ Përkufizon limitin e vargut nëpërmjet ε – rrethinës së pikës; ▪ Shqyrton natyrën (konvergjencën, divergjencën) e vargut nëpërmjet përkufizimit të limitit; ▪ Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë.
	<p>Limiti i funksionit dhe vazhdueshmeria e funksionit</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njeh termat, faktet, parimet dhe konceptet bazë të limitit të funksionit; ▪ Përkufizon limitin e funksionit në gjuhën $\varepsilon - \delta$; ▪ Përkufizon limitet e njëanshme të funksionit dhe njeh kuptimin gjeometrik të tyre; ▪ Dallon kuptimin e trajtave të pacaktuara të limiteve të funksioneve; ▪ Gjen limite të funksioneve të ndryshme duke shfrytëzuar përkufizimin e limitit të funksionit dhe vetitë e tij; ▪ Zbaton limitet e funksioneve në zgjidhjen e problemeve të ndryshme; ▪ Përkufizon asimptotat e funksioneve, njeh kuptimin gjeometrik të tyre dhe i gjen ato duke i përdorur limitet e funksioneve; ▪ Përkufizon pikat e këputjes së funksionit, i gjen ato dhe i klasifikon ▪ Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë.

	Derivati i funksionit	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkufizon dhe e kupton përkufizimin e derivatit të funksionit; ▪ Gjen derivatin e disa funksioneve elementare duke zbatuar drejtpërdrejtë përkufizimin e derivatit të funksionit; ▪ Njeh rregullat e derivimit - formulat për derivatin e shumës, ndryshimit, prodhimit dhe herësit të funksioneve; ▪ Gjen derivatin e disa funksioneve elementare duke zbatuar rregullat e derivimit; ▪ Gjen derivatin e shumës, ndryshimit, prodhimit dhe herësit të funksioneve të ndryshme duke zbatuar rregullat e derivimit; ▪ Njeh formulën për derivatin e funksionit të anasjelltë dhe e zbaton atë në gjetjen e derivatit të disa funksioneve themelore elementare dhe disa funksioneve tjera të ndryshme; ▪ Njeh formulën për derivatin e funksionit të përbërë dhe e zbaton atë në gjetjen e derivatit të funksioneve të ndryshme; ▪ Përkufizon derivatet e rendit të dytë për funksione të ndryshme; ▪ Zbaton derivatin e funksionit në shqyrtimin dhe paraqitjen grafike të funksionit; ▪ Zbaton derivatin e funksionit në zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga lëndët tjera dhe jeta reale; ▪ Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë.
--	------------------------------	---

Udhëzime metodologjike

Metodologjitë e mësimdhënies së matematikës në klasën e dymbëdhjetë bazohen në parimet e mësimdhënies të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë III e cila ofron një mësimdhënie që zhvillon kompetencat e të nxënit. Temat që paraqiten në programin e klasës së dymbëdhjetë nuk mund të zhvillohen të shkëputura dhe të ndara, por ato janë të lidhura me fusha të tjera kurrikulare dhe të ilustruara në kontekste nga jeta. Rezultatet e të nxënit për secilën temë shërbejnë edhe për kërkesat dhe nocionet që ndihmojnë përvetësimin e temave të tjera brenda dhe jashtë fushës.

Mësimdhënësi duhet të përqendrohet në këto aspekte:

- lidhja e rezultateve të të nxënit të kompetencave kryesore me rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës dhe rezultatve të temave;
- mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca;
- mësimdhënia me në qendër nxënësin;
- mësimdhënia dhe të nxënit e integruar;
- zhvillimi i temave ndërkurrikulare;

- zhvillimi i veprimtarive me arsimim të qëndrueshëm.

Mësimdhënësi duhet ta ndërtojë punën e vet mbi: përcaktimin e temës për të zhvilluar; listimin e metodave, teknikave dhe strategjive të cilat bazohen në ndërveprim; mundësimin në qasje në të gjitha mjetet më të domosdoshme që u nevojiten nxënësve, motivimin, nxitjen e përhershëm të nxënësve; informimin dhe mbajtjen në lidhje të vazhdueshme me prindërit për progresin e fëmijve të tyre.

Nxënësit duhet të stërvitet për punë të pavarur, punë në çifte, grupe të vogla dhe të mëdha, ngase kjo i jep mundësi për të treguar guxim në zbulimin dhe eksplorimin e së panjohurës, të respektojë rregullat, vlerat, qëndrimet personale dhe të tjerëve, për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe punës ekipore. Përmes qasjes së të nxënësve me kompetenca mësimdhënësi mundëson dhe lehtëson hulumtimin dhe identifikimin e përvojave të nxënësve, të njohurive dhe pikëpamjeve të tyre, të cilat mundësojnë zhvillimin e tyre duke marrë parasysh dallimet ndërmjet nxënësve në klasë. Përdorimi i *metodologjive efikase në mësimdhënien e matematikës* është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e rezultateve të të nxënësve për kompetenca nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Matematika ka një shumëllojshmëri të aplikimeve në jetën e përditshme dhe është e lidhur ngusht me shumë komponente të arsimit, e që njëkohsisht kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: ngrohja globale, burime të përhershme e të pashtershme, njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, bashkëjetesa paqësore, planifikimi i buxhetit, etj., nxënësi duhet të zgjidhë probleme të natyrave të ndryshme, duhet të përdorë arsyetimin matematik dhe elemente të gjuhës matematikore. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave matematikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësit e klasës së dymbëdhjetë mësojnë të realizojë zgjidhjen e një problemi apo situatë problemore dhe të bëhen të aftësi të kontribuojnë në rritjen e tij personale duke i ndihmuar ata të gjejnë vendin e tyre në shoqëri. Kështu, ata mësojnë të marrin pjesë në jetën shoqërore në klasë dhe në shkollë, zhvillojnë një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin. Nxënësit përdorin aparatit matematik, në mënyrë që të asyetojnë dhe argumentojnë vendimet e marrura, të zhvillojnë marrëdhënie aktive në mjedisin e tij duke ushtruar një qëndrim kritik ndaj arsimit të qëndrueshëm dhe çështjeve ndërkurrikulare.

Programi dhe interpretimi i tij në vete përmban një *lidhje të matematikës me fushat e tjera* përmes shembujve dhe problemeve, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si tërësi për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi si proces është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënit, andaj përmes vlerësimit konstatohet shkalla e arritshmërisë së të nxënit, vlerëshmëria e programit dhe metodologjia e mësimdhënies. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive matematikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e nxënësve. Gjatë vlerësimit mësimdhënësi, duhet të ketë parasyshë rezultatet e të nxënit për tema mësimore të klasës, duke i pasur në fokus rezultatet e shkallës. Vlerësimi i arritjes së nxënësve të klasës së dymbëdhjetë nga matematika realizohet nëpërmjet: evidencës së vlerësimit të vazhdueshëm, vëzhgimit në klasë, vlerësimit përmes testeve përmbledhëse periodike, ndërsa raportimi i të arriturave të nxënësve bëhet përmes përshkrimeve me koente konstruktive të vendosura në librin e mësimdhënësit dhe vendosjen e notave numerike (1-5) në librin e klasës.

Procedura e vlerësimit rekomandohet të bëhet në harmoni me dokumentet zyrtare për vlerësim. Llojet e vlerësimit duhen të përdoren në përputhje me qëllimet dhe rezultatet e të nxënit të lëndës, strategjitë e të nxënit, moshës dhe kërkesave të nxënësit. Për lëndën e matematikës, vlerësimi bazohet në: vlerësim të përgjigjeve me gojë; punën në grup; aktivitetin gjatë debateve në klasë; kryerjen e detyrave të shtëpisë; rezultatet e testit për një grup temash të caktuara; rezultatet e testit në fund të vitit mësimor etj.

Udhëzime për materiale dhe burimet mësimore

Gjatë mësimit të matematikës mësimdhënësi jep informacione dhe shfaqë shkathtësi duke përdorur materiale didaktike dhe burime të nevojshme, ndërsa nxënësi jep informacione, formon shprehje, zhvillon shkathtësi dhe zotëron cilësi për fushën duke i qasur të mësuarit përmes formave të ndryshme.

Për realizimin e kompetencave të arsimit të mesëm të lartë nga fusha e matematikës për klasën e dymbëdhjetë, mësimdhënësi siguron qasje përmes përdorimit të materialeve të përshtatshme me moshën, nivelin dhe thellësinë e të mësuarit. Mësimdhënësi, përveç materiale dhe mjete të nevojshme didaktike, krijon modelime matematike, jep ndihma të veçanta, përshtatë shembuj të llojeve të ndryshme, krijon mjedise dhe hapësirë për aktivitete alternative. Ai poashtu iu ofron edhe mjete teknike dhe teknologjike për të zhvilluar aftësitë e nxënësit në mësimin e matematikës. Mësimdhënësi duhet tu mundësojë nxënësve zhvillimin e shkathtësive që të demostrojnë apo prezantojnë projektetë ndryshme dhe të formojnë qëndrime ndaj të mësuarit të matematikës.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Matematikë (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Matematika si lëndë mësimore luan një rol të rëndësishëm në studimin e fenomeneve natyrore dhe atyre teknike, ndërsa të mësuarit e saj është vlerë e domosdoshme për integrimin në shoqëri duke mundësuar zhvillimin e personalitetit të nxënësit, zhvillimin e aftësive të tij për të menduar në mënyrë kritike dhe për të punuar i pavarur e në mënyrë të vazhdueshme. Matematika e klasës së dymbëdhjetë siguron përsosmërinë e shprehive dhe shkathtësive matematikore dhe arrin zhvillimin intelektual dhe formimin e personalitetit të nxënësve për të qenë të suksesshëm në përballje me sfidat e jetës.

Një nga veçoritë më të rëndësishme të matematikës është integrimi i saj me të gjitha fushat dhe çështjet ndërkurrikulare me qëllim zotërimin e kompetencave kryesore. Me anë të matematikës nxënësi mund të interpretojë sasitë duke përdorur numrat dhe algjebren, të interpretojë format, hapësirën dhe njësitë matëse duke përdorur gjeometrinë dhe matjet, dhe të interpretojë fenomene të rastit duke përdorur statistikën e probabilitetin.

Programi i matematikës së klasës së dymbëdhjetë në vete përmban:

- qëllimet e lëndës së matematikës të cilat i shërbejnë:
 - nxënësit për zhvillimin e kompetencave kryesore të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të fushës së matematikës, në mënyrë që ai në të ardhmen të jetë qytetar i suksesshëm;
 - mësimdhënësit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore, si dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
 - prindërit për njohjen e rezultateve të të nxënësve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore për fëmijun e tij;
 - hartuesitë teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësimdhënësin dhe nxënësin.
- rezultatet e të nxënësve të lëndës për tema mësimore, përmbajtja e të cilave krijon kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të fushës dhe kompetencave kryesore;
- udhëzimet metodologjike të mësimdhënies për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes;
- udhëzimet për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare mbi kontributin e matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme;
udhëzimet për materiale didaktike, burime dhe mjete mësimore

Qëllimi

Të mësuarit e matematikës në klasën e dymbëdhjetë ka për qëllim zhvillimin intelektual të çdo nxënësi, ushtrimin e rregullave, kultivimin e vlerave si dhe përgatitjen për të siguruar një bazë solide për vazhdimin e shkollimit të lartë.

Programi i matematikës ka për qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik me idetë bazë për strukturat matematikore dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë për llogaritje dhe për zgjidhjen e problemeve në jetën e përditshme.

Programi i matematikës së klasës së dymbëdhjetë, gjatë zbatimit:

- përzgjedh dhe zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;
- bën vrojtime, hulumtime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe përsosmërinë e shprehive matematike;
- avancojnë të menduarit matematik të nxënësve përmes simboleve dhe gjuhës matematike;
- paraqet koncepte të matematikës i ndërlidh ato dhe i zbaton në zgjidhjen e problemeve.

Qëllimi i lëndës së matematikës në klasën dymbëdhjetë është *promovimi izhvillimit të përgjithshëm dhe konsolidim* i cili bëhet përmes:

- të nxënësve të integruar në kontekstin e jetës së përditshme
- përvetësimin e koncepteve elementare dhe ndërtimin e koncepteve të reja.

Temat dhe rezultatet e të nxënësve

Përvetësimi i përmbajtjes programore nga nxënësi demonstron si njohuri relevante që atij i parashirohet në raport me moshën. Shkathtësitë që i demonstroi nxënësi përfshijnë aftësitë, zotësitë, teknikat dhe metodat për zbatimin e njohurive për arritjen e rezultateve të të nxënësve të planifikuara për klasë.

Përmes lëndës së matematikës, për klasën e dymbëdhjetë, synohet të zhvillohen dhe përvetësohen kryesisht këto koncepte të përgjithshme matematikore:

- Format dhe hapësira;
- Funksionet dhe ndryshoret

Konceptet e përgjithshme zërthehen në tema, për secilën temë paraqiten rezultatet e të nxënësve të cilat bazën mbështetëse e sigurojnë nga rezultatet e të nxënësve të fushës për shkallë, që prezantojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me ato tema.

Programi lëndor i matematikës për nxënësit e klasës së dymbëdhjetë është i theksuar në drejtim të rezultateve të përgjithshme të të nxënit për lëndë dhe rezultatet specifike të të nxënit për tema dhe njësi tematike.

Rezultatet e përgjithshme janë deklarata gjithëpërfshirëse për atë që nxënësit pritet që të mësojnë në lëndën e matematikës, ndërsa rezultatet specifike janë deklarata që identifikojnë njohuri specifike dhe të kuptuarit për nxënësit që janë të nevojshme për të arritur deri në fund të lëndës. Përmes rezultateve nxënësit në mënyrë të logjikshme bëjnë arsyetime dhe analiza, vërtetime, modelime dhe zgjidhin probleme. Po ashtu nxënësi bën lidhje duke reflektuar mbi të menduarit matematik, lidh koncepte matematike brenda matematikës dhe jasht saj.

II. Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria

Rezultatet e përgjithshme e të nxënit për temë

Nxënësi:

- Përdorë me saktësi simbolet, termet, dhe konceptet e pikës dhe drejtëzës gjatë arsyetimeve analitike dhe zgjidhjes së problemeve të ndryshme gjeometrike dhe praktike
- Zhvillon arsyetimin algjebrik dhe shpreh drejtëzën dhe vijat e shkallës së dytë përmes ekuacioneve të tyre
- Zbaton zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve jolineare në përcaktimin e pozitave reciproke të drejtëzës me vijat e shkallës së dytë dhe të pozitës reciproke ndërmjet vijave të shkallës së dytë

III Funkcionet dhe ndryshoret

Rezultatet e përgjithshme e të nxënit për temë

Nxënësi:

- Përkufizon funksionin si lidhje ndërmjet dy bashkësive numerike
- Zhvillon arsyetimin algjebrik dhe gjeometrik në përcaktimin e fushës së përkufizimit, zerove të funksionit, simetrisë, kufizueshmërisë, monotonisë, shenjës së funksionit, vlerave ekstreme dhe vazhdueshmërisë së funksionit
- Zbaton kuptimin dhe vetitë e funksioneve në kuptimet e mësuara në lëndët tjera mësimore
- Përkufizon vargun, vargun aritmetik, gjeometrik dhe limitin e vargut
- Demonstron shkathhtësi në zbatimin e vargjeve dhe limitit të vargut në zgjidhjen e problemeve praktike
- Manifeston kuptimin e limitit të funksionit dhe zbaton atë në përcaktimin e asimptotave të funksionit
- Zhvillon kuptimin e vazhdueshmërisë së funksionit dhe bën interpretimin algjebrik dhe gjeometrik

Përkufizon kuptimin e derivatit dhe integralit, pëdor rregullat në njehsimin e derivateve dhe integraleve si dhe interpreton gjeometrikisht ato

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Forma dhe hapësira, matjet dhe gjeometria	Pika	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Gjen largësinë ndërmjet dy pikave në bosht, rrafsh dhe hapësirë -Ndan një segment në raport të dhënë -Gjen koordinatat e mesit të një segmenti të dhënë -Njehson syprinën e sipërfaqes së trekëndëshit nëse dihen koordinatat e kulmeve të tij -Njehson syprinën e sipërfaqes së shumëkëndëshave të çfarëdoshëm nëse dihen koordinatat e kulmeve të tij -Zbaton njohuritë për largësinë midis dy pikave dhe syprinën e sipërfaqes së trekëndëshit në zgjidhjen e problemeve të ndryshme praktike -Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë për të marrë dhe për të dhënë informacione, për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve të kësaj teme
	Drejtëza	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përcakton dhe dallon trajtat e ndryshme të ekuacioneve të drejtëzës në rrafsh nëpërmjet të ekuacioneve të tyre dhe bën kalimin nga një trajtë e ekuacionit të drejtëzës në një trajtë tjetër -Paraqet gjeometrikisht drejtëzën të dhënë në çfarëdo forme -Përshkruan në mënyrë analitike dhe paraqet gjeometrikisht pozitën e dy drejtëzave në rrafsh -Gjen këndin midis dy drejtëzave -Gjen ekuacionin e drejtëzës që kalon nëpër dy pika të dhëna në rrafsh - Gjen largësinë e pikës nga drejtëza -Gjen ekuacionin e simetrales midis dy drejtëzave -Zgjidhë probleme të thjeshta gjeometrike duke i shndërruar ato në analitike me anë të metodës së koordinatave -Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë për të marrë dhe për të dhënë informacione, për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve të kësaj teme
	Vijate shkallës së dytë	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përkufizon vijat e shkallës së dytë dhe i kupton ato si rrjedhim i prerjeve konike -Njeh terma, fakte, parime dhe koncepte bazë për rrethin -Bën interpretimin gjeometrik të vijave të shkallës së dytë si vend gjeometrik i pikave në rrafsh dhe bën arsyetimin algjebrik duke ia shoqëruar ekuacionin përkatës -Shqyrton pozitën reciproke ndërmjet vijave të shkallës së dytë dhe

		<p>drejtëzës</p> <ul style="list-style-type: none"> -Interpreton gjeometrikisht zgjidhjet e sistemeve të barazimeve jolineare me pozitën reciproke të vijave të shkallës së dytë dhe drejtëzës -Gjen ekuacionin e tangjentes së vijës së shkallës së dytë në një pikë të saj -Gjen ekuacionin e tangjentes së vijës së shkallës së dytë nga një pikë jashtë saj -Zgjidhë probleme të thjeshta gjeometrike duke i shndërruar ato në algebrike me ndihmën e koordinatave -Zbaton njohuritë e fituara për vijat e shkallës së dytë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme praktike -Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë për të marrë dhe për të dhënë informacione, për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve të kësaj teme
Funksionet dhe ndryshoret	Funksioni	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përkufizon funksionin real - Cakton fushën e përkufizimit të funksionit - Gjen zerot e një funksioni nëse ato ekzistojnë - Shqyrton shenjën, paritetin dhe periodicitetin e funksioneve dhe e interpreton atë gjeometrikisht -Përkufizon monotoninë, vlerat ekstreme, lakueshmërinë, pikat e lakueshmërisë së një funksioni -Përkufizon funksionin e përbërë dhe e kryen kompozimin e funksioneve -Përkufizon funksionin invers dhe e gjen funksionin invers të një funksioni, nëse ai ekziston -Bën klasifikimin e funksioneve -Gjen shembuj te zbatimit te funksioneve ne jetën reale -Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë për të marrë dhe për të dhënë informacione, për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve të kësaj teme
	Vargjet numerike dhe limiti i vargut	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përkufizon vargun numerik, duke përdorë kuptimin e funksionit -Përkufizon kufizueshmërinë dhe monotoninë e vargjeve numerike dhe e shqyrton atë për vargje të ndryshme -Përkufizon vargun aritmetik dhe gjeometrik dhe i dallon ato përmes vetive dhe shembujve -Zbaton vargjet aritmetike dhe gjeometrike në zgjidhjen e problemeve të ndryshme praktike - Njeh termat, faktet, parimet dhe konceptet baze të limitit të vargut

		<ul style="list-style-type: none"> -Përkufizon limitin e vargut nëpërmjet ϵ – rrethinës së pikës -Shqyrton natyrën (konvergencën, divergjencën) e vargut nëpërmjet përkufizimit të limitit -Kupton në mënyrë intuitive limitin e vargut -Shqyrton konvergencën e disa vargjeve monotone dhe të kufizuara -Kryen veprimet me vargjet konvergjente -Zgjidhë detyra të ndryshme në lidhje me limitin e vargut duke zbatuar përkufizimin e limitit të vargut dhe vetitë e tij -Përcakton numrin e si limit të vargut dhe e zbaton atë në gjetjen e limiteve të vargjeve të ndryshme -Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë për të marrë dhe për të dhënë informacione, për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve të kësaj teme
<p>Limiti i funksionit dhe vazhdueshmeria e funksionit</p>		<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njeh termat, faktet, parimet dhe konceptet bazë të limitit të funksionit -Përkufizon limitin e funksionit në gjuhën $\epsilon - \delta$ -Përkufizon limitet e njëanshme të funksionit dhe njeh kuptimin gjeometrik të tyre -Dallon kuptimin e trajtave të pacaktuara të limiteve të funksioneve -Gjen limite të funksioneve të ndryshme duke shfrytëzuar përkufizimin e limitit të funksionit dhe vetitë e tij -Gjen limitet e njëanshme të funksioneve të ndryshme -Njeh disa limite karakteristike të funksioneve dhe i zbaton ato për gjetjen e limiteve të funksioneve të tjera -Zbaton limitet e funksioneve në zgjidhjen e problemeve të ndryshme -Përkufizon asimptotat e funksioneve, njeh kuptimin gjeometrik të tyre dhe i gjen ato duke i përdorur limitet e funksioneve - Përkufizon shtesën e argumentit dhe shtesën e funksionit dhe i gjen ato për funksione të ndryshme -Gjen shpejtësinë mesatare të ndryshimit të funksionit -Zbaton kuptimin e shtesës së argumentit dhe shtesës së funksionit në zgjidhjen e problemeve të ndryshme -Përkufizon, shqyrton dhe njeh kuptimin gjeometrik të vazhdueshmërisë së funksionit në një pikë dhe interval -Njeh vetitë e funksioneve të vazhdueshme dhe i zbaton ato -Përkufizon pikat e këputjes së funksionit, i gjen ato dhe i klasifikon -Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë për të marrë dhe për të dhënë informacione, për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve të kësaj teme

	<p>Derivati i funksionit</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përkufizon dhe e kupton përkufizimin e derivatit të funksionit -Gjen derivatin e disa funksioneve themelore elementare duke zbatuar drejtpërdrejtë përkufizimin e derivatit të funksionit -Bën lidhjen e vazhdueshmërisë së funksionit me derivatin e tij -Interpreton kuptimin gjeometrik dhe kinematik të derivatit dhe i zbaton ato në zgjidhjen e problemeve të ndryshme -Njeh rregullat e derivimit - formulat për derivatin e shumës, ndryshimit, prodhimit dhe herësit të funksioneve -Gjen derivatin e disa funksioneve themelore elementare duke zbatuar rregullat e derivimit -Gjen derivatin e shumës, ndryshimit, prodhimit dhe herësit të funksioneve të ndryshme duke zbatuar rregullat e derivimit -Njeh formulën për derivatin e funksionit të anasjelltë dhe e zbaton atë në gjetjen e derivatit të disa funksioneve themelore elementare dhe disa funksioneve tjera të ndryshme -Njeh formulën për derivatin e funksionit të përbërë dhe e zbaton atë në gjetjen e derivatit të funksioneve të ndryshme - Përkufizon derivatet e rendit të lartë dhe gjen derivatet e rendit të lartë për funksione të ndryshme - Zbaton derivatin e funksionit në shqyrtimin dhe paraqitjen grafike të funksionit -Zbaton derivatin e funksionit në zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga lëndët tjera dhe jeta reale -Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë për të marrë dhe për të dhënë informacione, për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve të kësaj teme
	<p>Integrali i funksionit</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përkufizon integralin pacaktuar të funksionit - Zbaton vetitë e integralit të pacaktuar (pa vërtetim) - Shkruan formulat themelore të integrimit dhe formulon tabelën e integraleve -Njeh metodat themelore të integrimit dhe njehson integrale të funksioneve të ndryshme duke zbatuar ato -Gjen integralin pacaktuar të disa funksioneve racionale dhe trigonometrike -Zbaton integralin e pacaktuar në zgjidhjen e disa problemeve praktike -Përkufizon integralin e caktuar si limit të shumave integrale - Dallon dhe përdor vetitë themelore të integralit të caktuar (pa vërtetim) - Zbaton formulën e Njutën – Lajbnicit për njehsimin e integralit të

		<p>caktuar (pa vërtetim)</p> <p>-Njehson integralin e caktuar me anë të metodave themelore të integritimit</p> <p>-Zbaton integralin e caktuar për njehsimin e syprinave të sipërfaqeve të rrafshëta, gjatësisë së harqeve të ndryshme, vëllimin dhe syprinën e sipërfaqes së trupave rrotullues</p> <p>-Përdorë gjuhën matematike dhe teknologjinë për të marrë dhe për të dhënë informacione, për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve të kësaj teme</p>
--	--	---

Udhëzime metodologjike

Metodologjitë e mësimdhënies së matematikës në klasën e dymbëdhjetë bazohen në parimet e mësimdhënies të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë III e cila ofron një mësimdhënie që zhvillon kompetencat e të nxënit. Temat që paraqiten në programin e klasës së dymbëdhjetë nuk mund të zhvillohen të shkëputura dhe të ndara, por ato janë të lidhura me fusha të tjera kurrikulare dhe të ilustruara në kontekste nga jeta. Rezultatet e të nxënit për secilën temë shërbejnë edhe për kërkesat dhe nocionet që ndihmojnë përvetësimin e temave të tjera brenda dhe jashtë fushës.

Mësimdhënësi duhet të përqendrohet në këto aspekte:

- lidhja e rezultateve të të nxënit të kompetencave kryesore me rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës dhe rezultatve të temave;
- mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca;
- mësimdhënia me në qendër nxënësin;
- mësimdhënia dhe të nxënit e integruar;
- zhvillimi i temave ndërkurrikulare;
- zhvillimi i veprimtarive me arsimim të qëndrueshëm.

Mësimdhënësi duhet ta ndërtojë punën e vet mbi: përcaktimin e temës për të zhvilluar; listimin e metodave, teknikave dhe strategjive të cilat bazohen në ndërveprim; mundësimin në qasje në të gjitha mjetet më të domosdoshme që u nevojiten nxënësve, motivimin, nxitjen e përhershëm të nxënësve; informimin dhe mbajtjen në lidhje të vazhdueshme me prindërit për progresin e fëmijve të tyre.

Nxënësit duhet të stërvitet për punë të pavarur, punë në çifte, grupe të vogla dhe të mëdha, ngase kjo i jep mundësi për të treguar guxim në zbulimin dhe eksplorimin e së panjohurës, të respektojë rregullat, vlerat, qëndrimet personale dhe të të tjerëve, për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe punës ekipore. Përmes qasjes së të nxënit me kompetenca mësimdhënësi mundëson dhe lehtëson hulumtimin dhe identifikimin e përvojave të nxënësve, të njohurive dhe pikëpamjeve të tyre, të cilat mundësojnë zhvillimin e tyre duke marrë parasysh dallimet ndërmjet

nxënësve në klasë. Përdorimi i *metodologjive efikase në mësimdhënien e matematikës* është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e rezultateve të të nxënësve për kompetenca nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Matematika ka një shumëllojshmëri të aplikimeve në jetën e përditshme dhe është e lidhur ngusht me shumë komponente të arsimit, e që njëkohsisht kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: ngrohja globale, burime të përhershme e te pashtershme, njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, bashkëjetesa paqësore, planifikimi i buxhetit, etj., nxënësi duhet të zgjidhë probleme të natyrave të ndryshme, duhet të përdorë arsyetimin matematik dhe elemente të gjuhës matematikore. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave matematikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësit e klasës së dymbëdhjetë mësojnë të realizojë zgjidhjen e një problemi apo situatë problemore dhe të bëhen të aftësi të kontribuojnë në rritjen e tij personale duke i ndihmuar ata të gjejnë vendin e tyre në shoqëri. Kështu, ata mësojnë të marrin pjesë në jetën shoqërore në klasë dhe në shkollë, zhvillojnë një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin. Nxënësit përdorin aparatit matematik, në mënyrë që të asyetojnë dhe argumentojnë vendimet e marrura, të zhvillojnë marrëdhënie aktive në mjedisin e tij duke ushtruar një qëndrim kritik ndaj arsimit të qëndrueshëm dhe çështjeve ndërkurrikulare.

Programi dhe interpretimi i tij në vete përmban një *lidhje të matematikës me fushat e tjera* përmes shembujve dhe problemeve, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si tërësi për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi si proces është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënësve, andaj përmes vlerësimit konstatohet shkalla e arritshmërisë së të nxënësve, vlerëshmëria e programit dhe metodologjia e mësimdhënies. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësve bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Vlerësimi i përmbytjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive matematikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e nxënësve. Gjatë vlerësimit mësimdhënësi, duhet të ketë parasyshë rezultatet e të nxënësve për temë mësimore të klasës, duke i pasur në fokus rezultatet e shkallës. Vlerësimi i arritjes së nxënësve të klasës së dymbëdhjetë nga matematika realizohet nëpërmjet: evidencës së vlerësimit të vazhdueshëm,

vëzhgimit në klasë, vlerësimin përmes testeve përmbledhëse periodike, ndërsa raportimi i të arriturave të nxënësve bëhet përmes përshkrimeve me koente konstruktive të vendosura në librin e mësimdhënësit dhe vendosjen e notave numerike (1-5) në librin e klasës.

Procedura e vlerësimin rekomandohet të bëhet në harmoni me dokumentet zyrtare për vlerësim. Llojet e vlerësimin duhen të përdoren në përputhje me qëllimet dhe rezultatet e të nxënit të lëndës, strategjitë e të nxënit, moshës dhe kërkesave të nxënësit. Për lëndën e matematikës, vlerësimi bazohet në: vlerësim të përgjigjeve me gojë; punën në grup; aktivitetin gjatë debateve në klasë; kryerjen e detyrave të shtëpisë; rezultatet e testit për një grup temash të caktuara; rezultatet e testit në fund të vitit mësimor etj.

Udhëzime për materiale dhe burimet mësimore

Gjatë mësimin të matematikës mësimdhënësi jep informacione dhe shfaqë shkathtësi duke përdorur materiale didaktike dhe burime të nevojshme, ndërsa nxënësi jep informacione, formon shprehje, zhvillon shkathtësi dhe zoteron cilësi për fushën duke i qasur të mësuarit përmes formave të ndryshme.

Për realizimin e kompetencave të arsimit të mesëm të lartë nga fusha e matematikës për klasën e dymbëdhjetë, mësimdhënësi siguron qasje përmes përdorimit të materialeve të përshtatshme me moshën, nivelin dhe thellësinë e të mësuarit. Mësimdhënësi, përveç materiale dhe mjete të nevojshme didaktike, krijon modelime matematike, jep ndihma të veçanta, përshtatë shembuj të llojeve të ndryshme, krijon mjedise dhe hapësirë për aktivitete alternative. Ai poashtu iu ofron edhe mjete teknike dhe teknologjike për të zhvilluar aftësitë e nxënësit në mësimin e matematikës. Mësimdhënësi duhet të mundësojë nxënësve zhvillimin e shkathtësive që të demonstron apo prezantojnë projektet e ndryshme dhe të formojnë qëndrime ndaj të mësuarit të matematikës.

FUSHA KURRIKULARE: SHKENCAT E NATYRËS

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Biologji (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Fizikë (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Kimi (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Astronomi (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Gjeografi (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Biologji (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Hartimi i plan-programit mësimor të lëndës së biologjisë është realizuar mbi bazën e KB –të nivelit III dhe i dedikohet nxënësve të klasës XII, Gjimnazi i shkencave natyror. Hartimi i programit respekton një procedurë të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënësve, metodave dhe instrumenteve të vlerësimit.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor jemi nisur nga synimi i arritjes së kompetencave të paraplanifikuara me Kurrikulen Bërthamë, përmes rezultateve lëndore- Biologji.

Përmbajtja e programit mësimor të biologjisë, metodologjitë, qasja, shfrytëzimi i burimeve të ndryshme mësimore, fleksibiliteti dhe kreativiteti i mësimdhënësit si dhe autonomia e shkollës (hartimi i rezultateve specifike mësimore), kontribuojnë që të nxënësi të zhvillohen kompetencat e ndryshme.

Bazuar në RNF- të fushës shkencat e natyrës, në lëndën e biologjisë Klasa e XII ju mundëson nxënësve të fitojnë njohuri bazë për ciklin jetësor të qenieve të gjalla, ontogenezën apo zhvillimin individual të njeriut, indet, organet dhe sistemet e organeve të shtazët, mjedisin dhe shëndeti i njeriut si dhe edukimi shëndetësor dhe seksual.

Me këto përmbajtje programore ne konsiderojmë se nxënësit e kësaj moshe pajisen me njohuri, shkathtësi, shprehje, qëndrime dhe vlera për tu ballafaquar me sukses me sfidat e jetës.

Lënda mësimore Biologjia XII bazë referimi ka konceptin e fushës “bota e gjallë”.

Programi i lëndës mësimore Biologjia XII, krahas kërkesës për arritjen e rezultateve të nxënësve për fushë (RNF) mundëson dhe kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave, përcaktuar nga KB të shkallës së 6.

Programi Biologjia XII përmban rezultate të të nxënësve për lëndë (RNL) sipas temave:

- Cikli jetësor i organizmave
- Ontogjeneza e njeriut
- Indet, organet dhe sistemet e organeve të shtazët
- Mjedisin dhe shëndeti i njeriut
- Edukimi shëndetësor dhe seksual

Qëllimi

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën XII është vazhdimësi e programit mësimor të shkencave natyrore – biologji nga klasa njëmbëdhjetë, si i tillë, konsiston në arritjen e kompetencave për shkallën e gjashtë (në thellimin e diturive të nxënësve dhe në zhvillimin e

shkathësive, vlerave dhe të qëndrimeve etj). Andaj, mbi këtë bazë, programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën XII i siguron nxënësit synimin e zhvillimit të mëtejshëm për:

- Thellim të njohurive mbi ciklin jetësor të qenieve të gjalla, ontogjenezën apo zhvillimin individual të njeriut, indet, organet dhe sistemet e organeve të shtazët, mjedisin dhe shëndeti i njeriut si dhe edukimi shëndetësor dhe seksual.
- Aftësi dhe shprehje komunikimi duke përdorur gjuhë shkencore për interpretim të ideve, fenomeneve dhe të proceseve jetësore
- Shprehje për punë në grupe dhe në ekipe punuese, ndjenjës së shoqërizimit dhe të vetive të tjera pozitive të personalitetit të domosdoshme për bashkëpunim konstruktiv në zgjidhjen e detyrave të parashtruara.
- Shkathësi hulumtuese (përmes mësimin eksperimental, vrojtues, matës dhe analizues të zhvillojnë aftësitë krijuese, të menduarit analitik, vlerësimin objektiv ndaj vetvetes dhe grupit gjatë punës ekipore).
- Aftësi që me punën e tyre kreative të zbulojnë mënyrën përdorimit të arritjeve teknologjike me punën shkencore.
- Qëndrime për faktet shkencore në aspekt të çështjes industriale, etike dhe ambientore.
- Qëndrime për sjelljet emocionale në fazën e pubertetit.
- Vlera për mbrojtjen e shëndetit seksual personal dhe të tjerëve,
- Vlera të integritimit me shkencat e tjera duke mundësuar nxënësve formimin e parafytyrimeve të plota për zhvillimin evolutiv të qenieve të gjalla.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin konceptin e shkencave natyrore – të organizuara përmes temave dhe rezultateve me anë të të cilave përfshihet fundamenti i lëndës.

Ndërtimi i lëndës është bërë mbi bazën e theksimeve të balancuara mes koncepteve dhe temave mësimore, si dhe balancimit të rezultateve të të nxënit me temat, ku mbetet përgjegjesi e mësimdhënësit të bëjë balancimin e rezultateve të të nxënit për temë me rezultatet e të nxënit për njësi mësimore, përmes përmbajtjeve në interes të nxënësve.

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për tema (RNL)
Bota e gjallë	2.2.1 Vlerëson (grykon ndërlidhjet funksionale të strukturave qelizore gjatë proceseve jetësore të njeriut; biologjinë e njeriut dhe format bashkëkohore të mbrojtjes së shëndetit të njeriut. 2.2.2 Organizon aktivitete për vetëdijësimin e të tjerëve rreth shëndetit seksual dhe substancave të cilat rrezikojnë shëndetin e njeriut.	

<p>Cikli jetesor i organizmave</p> <p>Ontogjeneza e njeriut</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Definon dhe shpjegon rëndësinë e riprodhimit për funksionimin dhe kontinuitetin e botës së gjallë, - Përcakton dhe përshkruan dallimet në mes ndarjeve qelizore: mitozës dhe mejozës, - Hulumton procesin e replikimit të ADN-së dhe dyfishimin e kromosomeve që i paraprin ndarjes qelizore, - Dallon dhe përshkruan karakteristikat kryesore të riprodhimit seksual dhe joseksual te bimët dhe shtazët, - Numëron dhe përshkruan format e riprodhimit joseksual te bimët dhe shtazët, - Kupton dhe përshkruan riprodhimin seksual dhe proceset e gametogjenzës: spermatogjenzës dhe oogjenzës, - Përshkruan dallimet në mes të organizmave gonohorist dhe hermafrodit, - Definon procesin fekondim dhe dallon fekondimin e jashtëm dhe atë të brendshëm te shtazët, - Dallon dhe rendit sipas ndodhjes fzat e zhvillimit embrional: segmentimin, gastrullimin, histogjenzën dhe organogjenzën, - Përcakton dhe përshkruan shtresat embrionale: ekto, endo dhe mesodermën dhe derivatet që ato japin gjatë zhvillimit embrional si dhe organet ekstraembrionale: horioni, amnionin dhe alantoisi, - Kupton dhe shpjegon format e zhvillimit postembrional te organizmat e ndryshëm përfshirë metamorfozën te insektet dhe bretkoca.
<p>Indet ,organet dhe sistemet e organeve te shtazet</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Organizon nivelet hierakike të ndërtimit e organizmit të shtazëve dhe njeriut në organe dhe sisteme të organeve dhe përcakton lidhjen funksionale të tyre, - Definon termin ind dhe përcakton llojet e indeve sipas rolit dhe funksionit te shtazët dhe njeriu; - Kupton dhe përshkruan aspektet evolutive dhe specifikat me kryesore dhe dalluese të organzimit të indeve organeve dhe sistemeve kryesore të organeve në organizmat shtazor dhe njeriu, - Hulumton dhe përshkruan sistemin lëkuror te njeriu si mbrojtje e trupit nga ngacmimet nga jashtë, funksionin dhe ndërtimin e

	<p>lëkurës dhe pjesëve ndihmëse të saj: gjëndrrave, qimeve etj,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hulumton dhe përshkruan funksionet e sistemit lokomotor (për lëvizje) në botën shtazore dhe njeriut si dhe kompleksitetin e ndërveprimit të tij, - Identifikon dhe kupton ndërtimin dhe funksionit e sistemit skeletor, numrin dhe ndërtimin e eshtrave dhe rolin e tyre, funksionet e nyjeve dhe ligamenteve, - Identifikon dhe përcakton ndërtimin dhe funksionin e muskujve, me fokus te mujskujt skeletor, të lëmuar dhe atyre të brendshëm, - Përcakton dhe interpreton rolin kontrollues të sistemit nervor në të gjitha funksionet jetësore të organizmit, ndërtimin dhe funksionin e neuronit, ligjshmëritë biologjike dhe fizike të pranimi, bartjes dhe përpunimit të ngacmimeve, harkun reflektiv, - Diferencon dhe sqaron funksionet e sistemit nervor qendror dhe sistemit nervor periferik (nervave), sistemit nervor vegjetativ dhe autonom, sistemit nervor simpatik dhe parasimpatik te njeriu, - Kupton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e trurit si pjesa kryesore e sistemit nervor qendror të njeriut, truri i madhe, i mesëm dhe i vogël, hemisferat dhe zonat funksionale të trurit, - Diferencon dhe përcakton ndërtimin dhe funksionin e organeve të sistemit ndijor (shqisor) te njeriu: shqisa e të pamurit (syri), të dëgjuarit (veshi), të shijuarit (gjuha), të nuhatjes (hunda) dhe prekjes (lëkura), - Kupton dhe analizon ngacmimet nga mjedisi i jashtëm sipas natyrës së tyre: kemoreceptorët, fotoreceptorët, audioreceptorët, termoreceptorët, mekanoreceptorët dhe ciklin e veprimit të tyre në organizëm, - Emërton dhe analizon funksionet e sistemit endokrin të njeriut, gjëndrrat kryesore endokrine dhe hormonet që prodhojnë, mekanizmin e prodhimit dhe veprimit të hormoneve, rastet e hipo dhe hiperproduksionit të hormoneve me sëmundjet përcjellëse, - Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e organeve të tretjes së ushqimit, proceset fizike, mekanike, kimike dhe biologjike të këtyre organeve dhe si procesin e tretjes së ushqimit si kompleks, - Hulumton dhe analizon ndërtimin dhe funksionin e organeve të
--	--

		<p>frymëmarrjes në organizmat shtazor, mushkërit dhe ndërtimin e tyre te njeriu, kompleksitetin e frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes në procesin e shkëmbimit të gazeve dhe sëmundjet përcjellëse,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kupton dhe interpreton ndërtimin dhe funksionet e organeve kryesore të qarkullimit të gjakut: zemrës, arterieve, venave dhe kapilarëve, përfshirë dallimet mes qarkullimit të madh dhe të vogël të gjakut, - Analizon dhe hulumton indet lidhore të lëngta: gjakun sipas përbërjes, grupet e gjakut, përbërja dhe funksionin i limfës si dhe sëmundjet e gjakut (hemophilia, anemia etj), - Identifikon dhe përcakton organet kryesore ekskretuese sipas ndërtimit dhe funksionit, ndërtimi dhe funksioni i veshkës te njeriu, urina primare dhe ajo dytësore si produkti përfundimtar i sistemit ekskretues dhe sëundjet e sistemit ekskretues, - Kupton dhe përshkruan kompleksin e funksionimit të sistemit imunitar te njeriu, imunitetin e lindur dhe të fituar, mekanizmat e veprimit antigjen-antitrupt si dhe pasojat e mosfunksionimit të imunitetit (rasti i AIDS etj).
	<p>Mjedisi dhe shëndeti i njeriut</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përkufizon dhe interpreton biosferën me përbërsit, ndërveprimet dhe hierarkinë e saj si dhe ekosistemin si njësinë themelore e funksionale të biosferës, - Klasifikon faktorët ekologjik biotik dhe abiotik të ekosistemit dhe lidh konceptet e aksionit, reaksionit dhe koaksionit, - Përkufizon dhe interpreton mjedisin jetësor të njeriut me problemet përcjellëse të shkaqeve të rritjes së ndotjes globale, - Klasifikon ndotësit e mjedisit sipas origjinës, natyrës kimike e fizike, sektorëve prej nga vijnë, zërthyeshmërisë në natyrë dhe dallon konceptin ndotës dhe toksikant, - Ilustron dhe përshkruan rrugët e futjes së ndotësve në organizmin e njeriut, qarkullimin e toksikantëve nëpër organizëm, shkallët e veprimit të tyre deri te format e zbutjes së veprimit të toksikantëve, - Dallon dhe përshkruan termat: akumulacion dhe tolerancë, rezistencën e organizmit, specifikat e veprimit të toksikantëve në organizëm sipas seksit, moshës etj, - Identifikon dhe hulumton burimet primare dhe sekondare të ndotjes së ajrit dhe pasojat për shëndetin e njeriut nga kjo ndotje si: astma, emfizema etj. përfshirë sëmundjet që lidhen me efektet e ngrohjes globale,

		<ul style="list-style-type: none"> - Identifikon dhe hulumton burimet e ndotjes së ujit me format e ndotjes kimike, biologjike dhe fizike dhe pasojt në shëndet nga ndotja: dizenteria, salmoneloza, hepatiti e, - Hulumton dhe përcakton sëmundjet tek njeriu me bazë ndotjen kimike nga (pesticidet), ndotjen fizike (radiacioni, zhurma) dhe biologjike (organizmat patogjen), - Identifikon dhe zbaton masat për mbrojtjen e vetes dhe të tjerëve nga efektet e ndotjes së mjedisit.
	Edukimi shëndetësor	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon sjelljet e bazuara në gjini, të priturat dhe keqinterpretimet e këtyre roleve, • Debaton për seksualitetin dhe aftësinë e kufizuar, ndikimin e sëmundjeve të ndryshme në seksualitet, • Përgatite dhe prezanton projekt të parandalimit të sjelljeve të pa pranueshme sociale.

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore-lënda biologji, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përdorim adekuat i metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Rezultatet e të nxënit për shkallë (kompetencat) RNK, rezultate e të nxënit për fushë (RNF-të)- shkencat e natyrës, gjegjësisht rezultatet lëndore (RNL)- paraqesin jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e metodologjive duke u harmonizuar njëra me tjetrën në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK.

Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, metoda, teknika e forma tjera të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si :informacion i ri, ushtrime, detyra, punë me projekte e të tjera.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Shkencat e natyrës janë shkenca eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore, të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera për të përballur sfidat jetësore.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen këto qasje metodologjike të mëposhtme

- Mësimdhënie e drejtëdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo e drejtëdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënie anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, laborator, natyrë etj., të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërme kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmeja.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare janë tema me interes të veçantë për shoqërinë, sa janë aktuale janë edhe të vazhdueshme. Ato i integrojnë fushat kurrikulare dhe lëndët mësimore me qëllim të përkrahjes së nxënësve që të kuptojnë dhe interpretojnë drejt proceset shoqërore dhe natyrore që ndodhin në shoqëri.

Çështjet ndërkurrikulare janë:

- Edukimi për medie
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm
- Edukimi për paqë

Edukimi për media i referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të medieve për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet

lidhur publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësisë të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si: aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

Edukimi për paqe i referohet kuptimit të diversiteteve në shoqëri si vlera shoqërore. Përmbajtjet për edukimin për paqe janë tolerance, harmonia dhe bashkëjetesa etnike fetare, kulturore etj. dhe të jetuarit në harmoni me mjedisin natyror; lufta kundër terrorizmit, e drejta humanitare, dinjiteti njerëzor, ndalimi i dhunës, parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve.

Për më shumë shih Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë -Gjimnaze

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- Vlerësimi i punës praktike dhe demonstruese.
- identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënësve;
- nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve;
- vetëvlerësimit të nxënësve ;
- përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Vlerësimi i nxënësve bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrje të informacioneve të përparimit apo të ngecjes së nxënies.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veqanti për arritjen e rezultateve nga

shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së

Mësimdhënësit e shkencave natyrore - biologji, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere i hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës i dalë nga plani vlerësues në nivel DKA-ve dhe me UA i miratuar nga MASHT-i.

Duke vlerësuar se vlerësimi është një qështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkojë mundësi zhvillimi profesional, hulumtim të gjendjës, rishikim të kritereve për instrumentin vlerësues të përdorur, e mbi të gjitha të këtë gadishmëri të llogaridhenies para qdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit) dhe të jetë transparent si dhe të ju shpërndahet në formë fizike gjitha palëve të interesuara. Nxënësit e arsimit të mesëm të lartë kalojnë nëpër dy lloje të vlerësimit:

- 1.Vlerësim të brendshëm dhe
- 2.Vlerësim të jashtëm.

Vlerësimi i brendshëm u mundëson nxënësve të shprehin njohuritë e reja dhe të tregojnë nivelin e zotërimit të kompetencave .Kjo arrihet duke kombinuar vlerësimin formative (për nxënie) dhe vlerësimin përmbledhës (i të nxënit).

Llojet e vlerësimit të brendshëm:

- Vlerësim i vazhdueshëm
- Vlerësim përfundimtar
- Vlerësim për shkallë.

Vlerësimi i vazhdueshëm bëhet gjatë procesit të nxënit (vlerësim formative) dhe në fund të cdo teme mësimore, apo periudhe të mësimin (vlerësimi përmbledhës).

Vlerësimi përfundimtar bëhet në fund të vitit mësimor/shkollor.

Vlerësimi për shkallë realizohet në fund të cdo shkalle kurrikulare, përkatësisht në fund te shkallës së 5, ne fund te klasës së 11.

Vlerësimi i jashtëm bëhet në fund të klasës së 12 dhe organizohet nga autoriteti qendror për vlerësim i organizuar nga MASHT.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në shkencat e natyrës- biologji është e nevojshme të shfrytëzohen mjete dhe materiale të ndryshme mësimore si dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;

- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.;
- Mjete auditive-dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;
- Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, e-mail-i;
- Mjedisi mësimor (klasa, laborator, punëtorja, natyra, ferma etj.).

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Fizikë (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Mësimi i lëndës Fizika 12 në kuadër të fushës së shkencave natyrore u ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, e praktikave të përdorura nga njeriu për zhvillimin e njohurive shkencore, e kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.

Kurrikula e lëndëve të shkencave natyrore perkatesisht Fizika 12 ndihmon në zhvillimin e kompetencave që u shërbejnë individëve në aspektin personal, social, ekonomik dhe që lidhen me çështje lokale, kombëtare dhe globale. Kompetencat që zhvillon fusha e shkencave të natyrës në të gjitha shkallët kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyçe në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Përmbajtja lëndore Fizika 12 konceptohet si mjet për realizimin e kompetencave kyçe dhe atyre të fushës nëpërmjet formësimit të situatave të të nxënësve. Nxënësit fillojnë me idetë e tyre se si janë gjërat dhe pastaj i ndryshojnë dhe i zhvillojnë duke i provuar ato praktikisht. Gjatë veprimtarive shkencore nxënësit ndeshen me mundësitë e ndryshimit, rivendosjes ose sfidës së ideve. Kjo mënyrë e të nxënësve bën që nxënësit të zhvillojnë dhe të formojnë të kuptuarit shkencor përmes ideve dhe përvojave të tyre. Idetë dhe konceptet përpunohen për sa kohë nxënësit punojnë në situata problemore dhe zbatojnë metoda kërkimore për t'i zgjidhur problemet. Duke mësuar në këtë mënyrë, ata mund të përfytyrojnë gëzimin e zbulimit shkencor dhe të ushqejnë kureshtjen për botën që i rrethon. Mësimi i fizikes lidhet ngushtë me teknologjinë dhe së bashku i formojnë nxënësit në një kontekst më të gjerë.

Në shkallën VI fusha e shkencave natyrore integron njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet lëndëve fizikë, kimi, biologji. Në këtë shkallë nxënësit zgjerojnë fushën e njohjes për dukuritë në jetën dhe veprimtaritë e përditshme, zhvillojnë aftësitë, strategjitë dhe shprehitë e të menduarit të nevojshme për hulumtimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik. Ata lidhin njohuritë shkencore dhe teknologjike me njëra-tjetrën dhe me jetën, përdorin gjuhën dhe terminologjinë shkencore, si dhe krijojnë bazat konceptuale për të nxënësve e mëtejshëm të shkencës në studimet universitare.

Lënda mësimore, Fizika 12 më së shumti kontribuon në konceptin e fushës kurrikulare - „proceset fizike” por edhe në konceptet tjera.

Koncepti i fushës „proceset fizike” është i zberthyer në: Koncepti / Domeni: I. Levizja; II. Struktura e lëndës; III. Bashkeveprimi; IV. Energjia.

Lënda e fizikës, që do të mësohet në klasën 12 përfshin njësitë mësimore më të kondenzuara, por gjithnjë duke pasur parasysh aftësitë psikofizike të nxënësve.

të cilat kanë lidhshmëri horizontale me konceptet dhe lidhshmëri vertikale me RNF-të përgjatë gjithë arsimit parauniversitar

Qellimet

Qëllimet e programit Fizika 12 të fushës së shkencave natyrore janë konceptuar në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës.

Përmes lëndës fizikës 12 nxënësit:

- thellojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në lëndën fizikë, me synim përgatitjen e tyre për të vazhduar studimet në degët e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Inxhinierike
- zhvillojnë aftësitë shkencore, mendimin kritik dhe krijues;
- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në problemet që kërkojnë zgjidhje dhe marrje vendimesh;
- vlerësojnë kontributin e shkencës dhe teknologjisë në shërbim të shoqërisë njerëzore; ndërjegjësohen për të bashkëpunuar me mjedisin në mënyrë të përgjegjshme dhe konsensuale;
- përshkruajnë proceset natyrore në kohë dhe hapësirë; përshkruajnë burimet energjetike;
- shpjegojnë proceset përmes katër bashkëveprimeve (gravitacionale, elektromagnetike, bërthamore dhe të dobëta);
- përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin e informacionit;
- shpjegojnë rolin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit

Temat dhe rezultatet e të nxënësve

Përmbajtja e lëndës së fizikës është organizuar sipas koncepteve, temave dhe rezultateve të të nxënësve lëndore (RNL)

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin gjashtë koncepte, të zërthyera në koncepte specifike (domeni) në tema dhe rezultateve të të nxënësve lëndore me anë të të cilave përfshihet fondamenti i fushës së shkencës në lëndën përkatëse.

Rezultatet lëndore, në fizikë 12 si pika referente kanë temat:

1. Optika gjeometrike
2. Optika valore
3. Teoria speciale e relativitetit (TSR)
4. Rrezatimi termik,
5. Struktura e atomit
6. Fizika kuantike
7. Struktura e bërthamës së atomit
8. Fizika e gjysmëpërçuesve

Konceptet	Temat	Rezultatet e të nxënit,RNL
		Shpjegon ligjet e bashkëveprimeve themelore në natyrë; të dobët dhe të fuqishëm bërthamor, ndikimin e tyre në jetën e njeriut dhe ndotjen e mjedisit.
Proceset fizike	1. Optika gjeometrike.	<ul style="list-style-type: none"> -përkufizon ligjet e përhapjes drejtvizore të dritës dhe përpilon formën analitike të tyre, -përfiton formulat e pozitës së shembëllimeve dhe të burimit në pasqyre sferike dhe thjerrave të holla, -analizon pozitën dhe zmadhimin e shembëllimeve në pasqyra të rrafshta, sferike dhe thjerra të holla, -shpjegon rregullën e përcaktimit të karakterit real dhe virtual të shembëllimeve në pasqyra dhe thjerra. -identifikon të metat e thjerrave dhe paraqet mënyrën e korigjimit të tyre, -analizon krijimin dhe zmadhimin e shembëllimeve në instrumentet e thjeshta optike, -njehson devijimin minimal të rrezes në prizëm optik dhe zhvendosjen e saj pas thyerjes në pllakë Planparalele, -zgjidhë detyra numerike për përhapje drejtvizore të dritës.
	2. Optika valore	<ul style="list-style-type: none"> -dallon burimet klasike nga burimet laserike të valëve dhe përfiton shprehjen për intensitet të interferimit të dy valëve me amplituda dhe fazë të ndryshme, -analizon vijat interferenciale nga dy burime virtuale dhe vijat interferenciale të pjerrtësisë dhe trashësisë së njëjtë, -demonstron krijimin e figurës difraksionale të çarjes së ngushtë, të hapjes rrethore e vogël dhe të tehut të mpreft, -zbaton parimin e Hajgensit për përfitimin e shprehjes së difraksionit në çarje të ngushtë, -analizon difraksionin në rrjetë optike që paraqet sistem të çarjeve paralele, -trajton prizmen optike dhe rrjetën difraksionale si elemente disperzive dhe krahason zhvendosjen e ngjyrave përbërse të dritës së bardhë rënëse në to, -demonstron polarizimin e valëve me analogun mekanik të polarizatorit dhe analizatorit, -shpjegon ligjin e Malusit, dikroizmin dhe ligjin e Brusterit për polarizim, -përshkruan mënyrën e regjistrimit të hologramit me interferim të valës referente dhe valës së objektit dhe të rekonstruktimit të tij, -zgjidhë detyra numerike për dukuri të interferencës, difraksionit dhe polarizimit.

<p>3. Teoria speciale e relativitetit (TSR)</p>	<ul style="list-style-type: none"> -përshkruan fizikën në fundin e shek.19 dhe paraqitjen e eterit kozmik me qëllim të ruajtjes së parimit të unitetit mes valëve mekanike dhe EM, -shpjegon matjet e kryera në fizikë dhe astronomi që arësyetohen me tërheqje të pjesshme të eterit, tërheqje të tërsishme dhe mos tërheqjen fare, -përfiton shprehjet e transformimit të koordinatave, të shpejtsive dhe të nxitimeve në dy sisteme inerciale të referimit, -paraqet shembuj që tregojnë se drita nuk i nënshtrohet parimit klasik të mbledhjes së shpejtësive, -paraqet idenë e Ajnshtajnit për tejkalimin e krizës së krijuar në fizikë, me ndërrimin e përfytyrimit për hapësirën dhe kohën në formë të dy premisave të pranuar, -shpjegon kuptimin relativ të njëkohshmërisë dhe sinkronizimin e orëve brenda sistemit të caktuar inercial, -paraqet shprehjet e lidhmërisë mes koordinatave dhe kohës mes dy sistemeve inerciale bazuar në postulatet e Ajnshtajnit (transformimet e Lorencit), -trajton karakterin relativ të gjatësisë dhe të kohës bazuar në transformimet e Lorencit, -përfiton shprehjet relativiste për mbledhje të shpejtësive në pajtim me kërkesën e Ajnshtajnit, -njuhson shpejtësinë e përhapjes së dritës në ujë të lëvizshëm dhe arësyeton faktorin që i korespondon tërheqjes së pjesshme të eterit, -shpjegon eksperimentin virtual të Ajnshtajnit me pasqyrë dhe zbaton shprehjet relativiste të mbledhjes së shpejtësive për arësyetimin e karakterit kufitarë të shpejtësisë së dritës, -paraqet shprehjet relativiste për masën, impulsin, energjinë e përgjithshme dhe kinetike, -përfiton shprehjen për lidhmëri mes energjisë relativiste dhe impulsit dhe trajton ligjin e ruajtjes së masës dhe energjisë në TSR, -vën në dukje kontributin e Ajnshtajnit në fizikën bashkohore, -zgjidhë detyra numerike për shpjegimin e efekteve relativiste.
<p>4.Rrezatimi termik</p>	<ul style="list-style-type: none"> -dallon trupat absolut të zi, pasqyrat, trupat absolut të bardhë dhe absolut transparent duke zbatuar ligjin e ruajtjes së energjisë së rrezatimit rënës në ta, -përfiton funksionin univerzal të Kirkofit $f(\lambda, T)$ për rrezatim termik, -përshkruan vetitë e trupit absolut të zi dhe përafrimin e tij me trupa të jetës së përdtshme dhe Diellit,

		<ul style="list-style-type: none"> -shpreh analitikisht dhe grafikisht ligjet e rrezatimit të trupit absolut të zi, -shpjegon hipotezën e Plankut për mënyrën diskontinuale të emetimit të rrezatimit të trupit absolut të zi dhe paraqet formulën e densitetit të energjisë së tij, -ilustron lakoret e Plankut, për temperatura të ndryshme në grafikun, intensitet i rrezatimit/ gjatësi valore, -zbaton maksimumin e lakores së Plankut për Diellin, për përcaktimin e temperaturës efektive të tij, -përkufizon vetitë themelore të kuantit të dritës dhe dualizmin grimcë- valë për dritën, -interpretton shtypjen, fotoefektin dhe efektin e Komptonit duke shfrytëzuar vetitë themelore të kuantëve të dritës, -zgjidhë detyra numerike për zbatimin e ligjeve të rrezatimit termik, fotoefektit dhe efektit të komptonit.
	5. Struktura e atomit.	<ul style="list-style-type: none"> -përshkruan modelin e Tomsonit dhe modelin planetarë të Raterfordit për ndërtim të atomit, -shpjegon modelin e Borit për atom, kuantizimin e energjisës dhe rrugës së elektronit dhe liston vetitë themelore të tij, -analizon nivelet energjetike dhe seritë spektrale të atomit të hidrogjenit, -interpretton eksperimentin e Frank- Hecit për ekzistimin e niveleve energjetike në atom në pajtim me postulatit e dytë të Borit, -shqyrton gjenerimin e rrezeve të Rëntgenit , vetitë dhe zbatimin e tyre në studimin e strukturës së lëndës me dukuri të difraksionit (formula e Bragut), -përshkruan llojet e luminishencës sipas zgjatjes së emetimit të rrezatimit dhe i dallon sipas mënyrës së ekscitimit të lëndës, -dallon emisionin spontan nga emisioni i stimuluar i rrezatimit me populacion inverz dhe përshkruan parimin e punës së laserit, -zgjidhë detyra numerike për strukturën e atomit.
	6.Fizika kuantike	<ul style="list-style-type: none"> -identifikon arritjet dhe të metat e modelit të Borit për atom, -prezanton hipotezën e De Broilit, për natyrën duale të grimcave të lëndës që paraqet simetri të madhe të natyrës, -argumenton saktësinë e hipotezës së De Broilit me shpjegimin e interferencës së tufës së elektroneve të difraktuara në dy çarje, difraksionin e elektroneve në kristalin e MnO dhe punën e mikroskopit

		<p>elektronik,</p> <ul style="list-style-type: none"> -tregon interpretimin e Borit me valë të qëndrueshme, për gjendje stacionare të elektronit në atom, -shpjegon relacionet e Hajzenbergut për pacaktushmëri gjatë matjes së njëkohshme të madhësive Komplementare, -përshkruan pakon valore si bashkësi e numrit të madh të valëve amplituda e së cilës shpreh probabilitetin e vend ndodhjes së grimcës, -vën në dukje se në modelin kuant – mekanik të atomit, humb kuptimi grimcë- elektron dhe trajektore klasike e lejuar që zëvendësohen me konceptet re elektronike dhe orbital atomic, -shpjegon përfytyrimin e resë elektronike si zonë në të cilën elektroni është i kudogjendur, -konstaton se lëvizja e elektronit rreth bërthamës përshkruhet me valën e probabilitetit të De Broilit apo ψ (psi) funksionin dhe trajton kuptimin fizik të madhësisë $\psi ^2$, -tregon se orbitali atomik na ndihmon të përshkruajmë formën dhe dendësisë së resë elektronike, -identifikon dhe përshkruan tri eksperimentet historike të rëndësishme të cilët sollën paraqitjen e numrave kuantik, -shpjegon parimin e përjashtimit të Paulit, rregullën e Hundit dhe sistemin periodik të elementeve, -vën në dukje shtyllat themelore në të cilat qëndron modeli kuant-mekanik i atomit, -përshkruan barrierën potenciale dhe efektin tunel, me të cilin shpjegon zbërthimin α, -zgjidhë detyra numerike për problemet gjegjëse.
	<p>7.Struktura e bërthamës së atomit</p>	<ul style="list-style-type: none"> -vën në dukje ndërtimin bërthamës së atomit dhe vetitë që përcaktojnë individualitetin e saj, -përcakton energjinë e lidhjes së bërthamave atomike dhe stabilitetin e tyre, -shqyrton reaksionet bërthamore nga aspekti i lirimit apo shpenzimit të energjisë për zhvillimin e tyre, -shpjegon veçoritë themelore të forcës së fuqishme bërthamore dhe e krahason me forcën EM dhe gravitacionale, -trajton radioizotopet dhe zbatimin e tyre në lëmenj të ndryshëm të përvojës njerëzore, -interpretin shndërrimin spontan natyrorë të bërthamës së një elementi me rrezatim radioaktiv në bërthamë të elementit tjetër, -përshkruan rrezatimet e veçanta sipas vetive të veta dhe mënyrën e krijimit të tyre gjatë zbërthimit spontan radioaktiv,

		<p>-analizon ligjin e zbrërthimit radioaktiv si dukuri të rastit për të cilin vlejné ligjet e statistikës dhe pamundësia e parashikimit të saktë,</p> <p>-përshkruan proceset e transformimit të bërthamave atomike me goditje joelastike të tyre me grimca të lehta: alfa, protone, neutrone, deuteronë, kuante γ etj.(procesi i parë bërthamorë, ${}^{14}_7\text{N}(\alpha, p){}^{17}_8\text{O}$),</p> <p>-përkufizon ligjet themelore të ruajtjes në proceset e transformimit të bërthamave atomike,</p> <p>-shqyrton procesin e krijimit të elementeve transuranik me kapje rezonante të neutroneve të ngadalshme,</p> <p>-shpjegon procesin e coptimit të bërthamave të rënda atomike në dy fragmente pas goditjes me neutron,</p> <p>-përshkruan reaksionet zingjirore dhe mundësinë e kontrollimit të tyre në reaktorë bërthamorë,</p> <p>-interpretion reaksionet termobërthamore të krijimit të bërthamave të rënda me bashkimin e bërthamave të lehta dhe analizon ciklin proton - proton ($p-p$) që ndodhë në Diell,</p> <p>-identifikon dozimetritë si degë të fizikës bërthamore e cila e studion, e vlerëson dhe e matë bashkëveprimin e rrezatimit jonizues me lëndën,</p> <p>-vën në dukje krijimin e grimcave elementare nga goditja joelastike e rrezatimit parësorë kozmik me bërthamat e atomeve të shtresave të larta të atmosferës,</p> <p>-shpjegon bashkëveprimet themelore në natyrë dhe klasifikimin e grimcave elementare sipas karakterit të bashkëveprimit të cilit i nënshtrohen,</p> <p>-argumenton ekzistimin e pozitronëve (antigrimcë) si realitet fizik, bazuar në zgjidhjen simetrike të formulës për energji relativiste të shprehur me ndihmën e impulsit,</p> <p>-shpjegon kuarqet si ndërtesues të grimcave të familjes së hadroneve (mezone dhe barione) dhe janë ngritur në statusin e grimcave elementare,</p> <p>-vën në dukje veçoritë themelore të modelit standard dhe arrijtjet e fizikanëve drejt unifikimit të madh.</p> <p>-zgjidhë detyra numerike për problemet gje gjegjëse të strukturës së bërthamës.</p>
	<p>Fizika e gjysmëpërçtu</p>	<p>-shpjegon ndërtimin e trupave të ngurtë dhe veçoritë e monokristaleve, polikristaleve dhe trupave amorf,</p> <p>-dallon katër lloje themelore të ndërtimit të trupave të ngurtë sipas lidhjes mes atomeve apo grupeve të tyre në rrjete kristalore: kovalentë, metalikë jonikë dhe molekularë,</p> <p>-analizon përçueshmërinë vehtiake të gjysmëpërçuesve të pastër me ngacmim termik,</p> <p>-trajton rezistencën aktive R të përçuesit metalik nga aspekti kuantik si nevojë të tejkalimit të mangësisë</p>

	<p>esve</p>	<p>së shpjegimit me modelin klasik,</p> <ul style="list-style-type: none"> -demonstron vartësinë e rezistencës elektrike të gjysmëpërçuesit nga temperatura,. -demonstron krijimin e vetive përçuese të gjysmëpërçuesit me veprime të jashtme në të: të dritës, të rrezatimit γ apo mekanik, -dallon përçuesit normal nga superpërçuesit sipas rezistencës së tyre në temperatura afër zeros absolute, -trajton përçueshmërinë e metaleve, gjysmëpërçuesve dhe izolatorëve duke analizuar zonat energjetike të Tyre, - njehson përçueshmërinë e metalit si rrjedhojë e veprimit të fushës elektrike në gazin elektronik të tij, - interpreton zmadhimin e përçueshmërisë së gjymëpërçuesve mbi vlerën vehtiake me vendosjen e shtesave të elementeve tjerë në rrjetin kristalin të tyre, -analizon me ilustrim dallimet e spektrit energjetik të gjymëpërçueve të tipave – n dhe – p, -vën në dukje kontaktin p – n si elementin themlorë të teknikës së gjysmëpërçueve, -shqyrton ndikimin e fushës së jashtme elektrike në vetitë e shtresës p – n, -demonstron eksperimentalisht veçoritë e diodës gjysmëpërçuese me kyqjen e saj në qark elektrik, -përshkruan parimin e punës së diodës si: qelizë diellore, diodë ndriçuese apo drejtuese e rrymës alternative, -tregon parimin e punës së triodës kristaline n – p – n dhe triodës p – n – p.
--	--------------------	--

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore- fizike, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përzgjedhja e metodologjive duke u harmonizuar me rezultatet e pritshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Shkencat e natyrës janë shkenca eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës. Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj. Do të përmendim disa nga metodat të përgjithshme që mund të përdoren në këto raste.

Metoda e vëzhgimit -Metoda e vëzhgimit është një metodë që ndihmon nxënësit në formimin e koncepteve shkencore. Nëpërmjet kësaj metode nxënësit bëjnë lidhjen ndërmjet koncepteve abstrakte dhe objekteve, apo dukurive të botës reale. Kur vëzhgojnë objekte, apo dukuri, nxënësit përdorin njohuritë shkencore. Vëzhgimet i ndihmojnë ata për të krijuar përfytyrime të qëndrueshme për botën që na rrethon. Vëzhgimet në natyrë i nxisin nxënësit të punojnë në mënyrë shkencore, të ngrenë hipoteza dhe t'i testojnë ato. Vëzhgimi është hapi i parë i një hulumtimi, eksperimenti apo studimi.

Metoda eksperimentale -Metoda eksperimentale fillon me shpjegime teorike shkencore dhe vazhdon me demonstrimin e eksperimentit. Qëllimi i procedurës është të identifikojë dhe të krahasojë elementet e vëzhgueshme sasiore dhe të kontrollojë vërtetësinë e hipotezave të ngritura. Gjatë përdorimit të kësaj metode, nxënësit përdorin një sërë aparaturash për të bërë matje dhe tregojnë kujdes gjatë përdorimit të tyre.

Metoda empirike -Metoda empirike bazohet në modelet intuitive dhe siguron një mënyrë për të eksploruar elementet e një problemi. Kjo metodë udhëheq ide, hipoteza, teori dhe teknikat e reja për një studim kërkimor më të detajuar.

Hulumtimi-Nxënësit angazhohen në veprimtari, përmes të cilave kuptojnë se si shkencëtarët mendojnë dhe çfarë bëjnë në një proces vendimmarrjeje, si ngrenë pyetje dhe si planifikojnë hulumtimin. Përmes të nxënësve kërkues, nxënësit aftësohen të përftojnë njohuri dhe të krijojnë një botëkuptim për botën natyrore dhe fizike bazuar në hulumtimin shkencor. Gjithashtu, ata bëhen kompetentë që të zbatojnë aftësitë dhe proceset kërkuese, si dhe të zhvillojnë qëndrimet dhe vlerat që janë themelore për praktikën e shkencës.

Projektet -Projektet janë veprimtari të nxëni nëpërmjet të cilave nxënësit zbulojnë objektet, proceset apo dukuritë.

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit-Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit mbështet procesin kërkues, rrit cilësinë e të nxënit të nxënësve dhe siguron bashkëpunimin mes tyre. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, nxënësit mund të eksplorojnë dhe të perceptojnë konceptet abstrakte si dhe të zbulojnë marrëdhëniet ndërmjet objekteve dhe dukurive.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Kontributi i shkencave të natyrës dhe konkretisht i lëndës së fizikës është i shumanshëm për sa i takon ndikimit në shëndetin e njeriut dhe mirëqenien, mjedisin dhe ekonominë. Ka një lidhje domethënëse midis çështjeve dhe sfidave që trajtojnë temat ndërkurrikulare dhe zbulimeve e arritjeve në shkencë dhe teknologji. Fusha e shkencave të natyrës, përmes situatave të larmishme të të nxënit, zhvillon kompetencat që lidhen me çdo temë ndërkurrikulare dhe në mënyrë të veçantë me temat: mjedisi; **ndërvarësia; zhvillimi i qëndrueshëm dhe vendimmarrja morale.** Lënda e fizikës, si lëndë e fushës së shkencave natyrore i ndihmon nxënësit të kuptojnë çështje të shumta që lidhen përdorimin e burimeve natyrore, ndikimin e njeriut mbi mjedisin, menaxhimin e mbeturinave, çështje etike të lidhura me bioteknologjinë, ndryshimet klimatike dhe biodiversitetin. Përmes projekteve të ndryshme në fushën e shkencës, nxënësit mund të studiojnë ndikimin social, etik, ekonomik ose mjedisor të saj. Ata nxiten për të bërë pyetje rreth çështjeve që trajtojnë këto tema dhe sjelljes së tyre si konsumatorë të përgjegjshëm.

Nder temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për medie
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

Edukimi për media

I referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm

Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të të nxënësve. Ai mat shkallën e arritjes së kompetencave të nxënësve. Ai përfshinë mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënësve në nivel klase dhe shkalle të nxënësve. Me këtë informacion mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga ana e tyre të kompetencave të fushës së shkencave të natyrës.

Vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, ndaj është e rëndësishme që mësuesi t'ia përshtatë llojin e vlerësimit, qëllimit specifik të synuar. Para marrjes së një vendimi në lidhje me një aspekt të caktuar të performancës së nxënësve, mësuesi duhet të sigurojë që mënyra e vlerësimit të përdorur, të zotërojë informacionin që reflekton saktësisht një aspekt të veçantë të performancës që ai ka për qëllim të vlerësojë.

Është thelbësore që vlerësimi të jetë pjesë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. I gjithë procesi i të nxënësve në shkencat e natyrës mbështetet në kërkimin shkencor, si i tillë edhe vlerësimi merr shumë forma.

Duke qenë pjesë e procesit të të nxënësve, **vlerësimi formues** përdoret në të gjitha shkallët. Vlerësimi formues u shërben nxënësve për të përmirësuar të nxënësve dhe mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies.

Vlerësimi përmbledhës përdoret për të përcaktuar shkallën në të cilën janë arritur kompetencat. Ai shërben jo vetëm për të informuar nxënësit dhe prindërit për progresin e tyre, por edhe për të përmirësuar praktikatat e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Vlerësimi diagnostikues zakonisht kryhet në fillim të shkollës apo të vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth qëllimit për të cilin po kryhet vlerësimi.

Vlerësimi i kompetencave

Vlerësimi i bazuar në kompetencë është proces që siguron treguesit për: njohuritë, aftësitë, zotësitë, shkathtësitë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat fituara të nxënësve që i marrin në shkollë e që konsiderohet si pjesëpërbërëse e mësimi

Per ta realizuar kete vleraim po i permendim shkurtimisht komponentat e kompetencave kryesore

Njohuria: është tërësia e fakteve, parimeve dhe informacioneve që zotrohen. /terminologjin, simbolet, konceptet, metodat , parimet , kodet, faktet, idetë/

Aftësia – është fuqia, cilësia që zotron individi për t`a përmbushur një veprim në mënyrë të suksesshëm, brenda një kohe të caktuar. / identifikim, përshkrim, formulim, arsyetim, zbatim, vërtetim, analizë, sintezë, vlerësim, krjim /

Zotësia- është mundësia që ka individi për të arritur një nivel të caktuar të aftësisë.
/ mesatare, të lartë, me kufizime, i pa varur etj /

Shkathtësia – është mënyra e veprimit që kryhet pas një përsëritje a ushtrimi. / matje, ndërtime, skicime, zgjidhje, përdorim burimesh, përdorim informacionesh, përdorim teknologjisë, lexim të modeleve, krijim të modeleve të ndryeshme /

Shprehija - është mënyra e veprimit a e sjelljes që kryhet vetvetiu pas një përsëritje a ushtrimi të gjatë e të vazhdueshëm.
/ ushtrime, kurioziteti, fokusim në probleme , marrje e iniciativae /

Qëndrimi – është prirja për të reaguar në mënyrë specifike përkundrejt një situatë ose vlere, zakonisht e shoqëruar me ndjenja dhe emocione. / pjesëmarrje në diskutim, bashkpunim, kërkim ndihme, dhënie ndihme, verifikimi, kritika konstruktive /

Vlera – është kriter sipas të cilës gjykohet sjellja e individit në raportë me grupin / rrespektimi i mendimit të tjetrit, marrje e përgjegjësisë, vëmendje, demonstrim vullneti, rrespektim i rregullave, përmbushje e detyrave etj./

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i shoku-shokut e bën nxënësin më të vetëdijshëm për përparimin e tij dhe gjithashtu i lejon ata të analizojnë dhe krahasojnë idetë e tyre me ato të shokëve, mësuesve dhe prindërve.

Për vlerësimet me shkrim, mësuesi duhet të përdorë situatë të jetës reale që përfshijnë shkencën në jetën e përditshme, shoqëri dhe mjedis. Situatat e zgjedhura duhet të jenë domethënëse dhe tërheqëse. Përveç testeve me shkrim, mësuesit mund të kryejnë vlerësime të bazuara në performancën e nxënësve, duke përdorur mënyrat e mëposhtme, si:

- punët praktike;
- punët laboratorike;
- projektet kurrikulare dhe ndërlëndore;
- detyrat individuale;
- vrojtimit e mësuesit;
- listat e kontrollit;
- posterat;
- debatet;
- esetë;
- portofoli.

Mësuesi mund të vlerësojë nxënësin **përmes përdorimit të portofolit**. Ai është një koleksion sistematik i punës së nxënësit dhe siguron një tablo të plotë të arritjeve të tyre. Puna e mbledhur, ofron të dhëna të shumta për zhvillimin dhe progresin e nxënësve në përvetësimin e njohurive, në të kuptuarit e koncepteve shkencore, zbatimin e shkathtësive të procesit, dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ajo, gjithashtu, u ofron nxënësve mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në shkencat e natyrës- fizike, është e nevojshme të shfrytëzohen mjete dhe materiale të ndryshme mësimore si dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;
- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, diagrame, mjete grafike etj.;
- Mjete auditive-dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;
- Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, e-mail-i;
- Mjedisi mësimor (klasa, laborator, punëtorja, natyra, ferma etj.).
- Punëtorja, natyra, ferma etj.).

Këto burime, duhet të diskutohen dhe të vlerësohen nga stafi, si një pjesë e planit të tyre për shkencën. Plani duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre shkencore, si dhe në kryerjen e vizatimeve diagrame apo krijimeve të ndryshme.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Kimi (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Në këtë klasë do të mësohet për kiminë e karbonit sepse në ditët e sotme kimia organike konsiderohet kimi e komponimeve të karbonit me origjinë nga natyra ose artificiale. Prandaj njohja e kësaj lënde mundëson që në një mënyrë të “imitohet” natyra duke i sintetizuar komponimet që gjenden në planet dhe njëherit ajo mundëson krijimin e komponimeve të reja. Komponimet organike nuk përmbajnë shumë elemente të ndryshme kimike ndërsa elementet tjera kimike më të pranishme janë hidrogjeni, oksigjeni, azoti dhe në shkallë më të vogël sulfur, fosfor dhe klor. Në programin e kësaj lënde do të shtjellohen komponimet e karbonit me hidrogjen (hidrokarburet), komponimet organike që përmbajnë edhe oksigjen si dhe azot e poashtu ato me rëndësi të veçantë për jetë.

Zhvillimi i hovshëm tekniko-teknologjik ka mundësuar edhe optimizimin e shumë proceseve kimike të cilat mundësojnë prodhimin e shumë substancave me përdorim në shkallë të gjerë në jetën e përditshme. Mjafton të përmendim përdorimin e pesticideve të cilat kanë mundësuar rritjen e prodhimtarisë bujqësore, barërave të ndryshme ose të materialeve plastike dhe kauçukut. Një pjesë e këtyre materialeve janë të dëmshme për mjedisin kështu që duhet eliminuar ose ricikluar.

Qëllimi

Programi mësimor i ofruar në këtë lëndë do të mundësojë që nxënësit të:

- Zhvillojnë njohuritë për komponimet e karbonit dhe vetitë karakteristike të tyre përmes qasjeve të ndryshme të hulumtimit të problemeve, aktiviteteve të ndryshme dhe punëve eksperimentale.
- Vlerësojnë shumëllojshmërinë dhe rëndësinë fundamentale e praktike të komponimeve të karbonit si pjesë e jetës sonë, të cilat kanë rol të rëndësishëm në cilësinë e jetës.
- Zhvillojnë dhe të kultivojnë shprehitë dhe shkathësitë për punë të pavarur teorike, eksperimentale e praktike dhe të krijojnë kulturën për mbrojtjen e mjedisit.
- Formohen në rrafshin teoriko-praktik si personalitet me qëndrim autonom, kritik dhe me kulturë për bashkëpunim të ndërsjelltë, me arsimtarë, prindër dhe komunitet shkollor dhe jashtëshkollor për avancimin e të menduarit kritik e të pavarur të veprimtarisë dhe funksionit të shkollës.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e dymbëdhjetë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF)

Shkencat e natyrës, të shkallës së gjashtë të kurrikulës (Shk 6) në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të lartë:

Koncepti		
Materia, vetitë dhe shëndrrimet	RNF: Analizon përbërjen, ndërtimin dhe vetitë e substancave, ndikimin e elementeve, komponimeve inorganike e organike në botën e gjallë dhe jo të gjallë në përmasimin e cilësisë së jetës	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Kimia e karbonit, struktura dhe reaksionet e komponimeve organike	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan strukturën elektronike të atomit të karbonit, - Analizon formulat empirike molekulare strukturore dhe hapësinore të komponimeve organike, - Klasifikon komponimet organike dhe joorganike në bazë të vetive të tyre, - Klasifikon komponimet organike në bazë të grupeve funksionale dhe strukturës së vargut karbonik, - Identifikon elementet përbërës të komponimeve organike - Përshkruan hibridizimin sp^3, sp^2 dhe sp dhe interpreton formimin e lidhjeve σ (sigma) dhe π (pi), - Dallon izomeret vargor, pozicional, funksional, optik, gjeometrik dhe konformacional, - Dallon llojet e reaksioneve të komponimeve organike, - Përshkruan molekularitetin dhe rendin e reaksionit, - Përshkruan mënyrën e shkëputjes së lidhjes kovalente - Analizon efektin elektronik dhe sterik (Induktiv, mezomerik dhe efektin konjugativ), - Vlerëson ndikimin e efektit induktiv negativ dhe pozitiv në aciditetin dhe bazicitetin e komponimeve, - Përshkruan mekanizmin e reaksionit duke u bazuar në rendin dhe molekularitetin e reaksionit.
Hidrokarburet	<ul style="list-style-type: none"> - Klasifikon hidrokarburet sipas vetive të tyre dhe sipas strukturës së vargut karbonik, - Emërton Alkanet sipas nomenklaturës “IUPAC”, - Definon seritë homologe të alkaneve, - Interpretin izomerinë strukturore të alkanet, - Përshkruan përfitimin e alkaneve në industri dhe laborator, - Përshkruan vetitë fizike dhe kimike të alkaneve. 	

		<p>Pershkryan reaksionit e oksidimin,h halogjenimin,nitrimin,sukfonimin të alkaneve duke përfshi mekanizmin e reaksionit,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizon përfitimin,reaksionet, përdorimin dhe rëndësinë e alkaneve, - Emëron alkenet sipas sistemit IUPAC, - Përshkruan vetitë e alkeneve, - Përshkruan përfitimin e alkeneve më kreking të alkaneve dhe më reaksione të eliminimit të halogjenureve organike dhe më dehidratim të alkooleve. - Përshkruan reaksionet alkeneve duke përfshirë ; hidrogjenimin,halogjenimin,hidratimin,hidrohalogjenimin,oksidimin dhe polimerizimin, - Analizon rregullin e Markovnikovit për alkene jo simetrike më reagjent jo simetrike, - Vlerëson përdorimin e alkeneve, - Dallon dienet në bazë të strukturës dhe vetive të tyre, - Përshkruan reaksionet e dieneve. - Përshkruan alkinet sipas serisë homologe, - Emëron alkinet sistem IUPAC dhe trivial, - Analizon vetitë dhe përfitimin e alkineve, - Përshkruan reaksionet e identifikimit të alkineve, - Analizon reaksionet e alkineve.;Hidrogjenimin,hidrohalogjenimin,halogjenimin, oksidimin,polimerizimin dhe oksidimin, - Përshkruan vetitë përfitimin përdorimin e hidrokarbureve aliciklike, - Përshkruan Hidrokarburet Aromatike, - Shpjegon stabilitetin e bërthamës së benzenit. - Paraqet strukturat rezonante të benzenit, - Përshkruan reaksionet e benzenit siq janë halogjenimi,nitrimi,sukfonimin ,oksidimin, - Analizon reaksionet e alkilimit dhe acilimit të benzenit si substituum elektrofil, - Përshkruan derivateve ebenzenit.
	<p>Derivatet halogjene të hidrokarbureve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan emërtimin dhe klasifikimin e halogjenureve organike, - Analizon reaksionet e halogjenureve organike :

		<p>substituimit, eliminimit dhe ato të formimit të komponimeve organometalike,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerëson përdorimin e halogjenureve organike.
	Komponimet organike me oksigjen	<ul style="list-style-type: none"> - Paraqet alkoolet me ndihmën e formulave strukturale, - Dallon alkoolet sipas strukturës së vargut karbonik, - Klasifikon alkoolet sipas numrit të grupeve hidroksile, - Përshkruan vetitë fiziko-kimike të alkooleve dhe aciditetin e tyre, - Emërton alkoolet në bazë të nomenklaturës “IUPAC”, - Sintetizon alkoolet nga substancat e tjera organike, - Paraqet reaksionet e oksidimit, dehidratimit dhe substituimit të alkooleve, - Paraqet strukturën e fenoleve, - Dallon fenolet nga alkoolet në bazë të vetive të tyre, - Përshkruan vetitë përfshirë edhe ato acidike të fenoleve dhe reaksionet karakteristike të fenoleve, - Përshkruan fenolet më dy grupe hidroksile, - Paraqet eteret me ndihmën e formulave strukturale, - Emërton eteret sipas nomenklaturës “IUPAC”, - Përshkruan vetitë dhe reaksionet e etereve, - Përshkruan përfitimin e etereve simetrike dhe asimetrike, - Dallon aldehidet nga ketonet në bazë të strukturës së tyre, - Emëron aldehidet dhe kesonët më sistem IUPAC, - Përshkruan përfitimin dhe vetitë e aldehideve dhe kesonëve, - Analizon identifikimin e aldehideve dhe ketoneve, - Përshkruan reaksionet e aldehideve dhe ketoneve, - Përshkruan emërimin,klasifikimi ,përfitimin,reaksionet e acideve karboksilike, - Përshkruan derivateve acideve karboksilike, - Përshkruan hidrolizen e derivateve të acideve karboksilike, - Emërton acidet karboksilike dhe derivatat e tyre sipas nomenklaturës klasike dhe “IUPAC”, - Përshkruan përfitimin e acidit metanoik,etanoik

		<p>oksalik dhe benzoik,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizon vetitë kimike të acideve karboksilike, - Vlerëson rëndësinë e estereve, - Klasifikon acidet karboksilike sipas numrit të grupeve funksionore, - Shpjegon efektet e substituentëve në fortësinë e acideve karboksilike, - Përshkruan acidet e larta yndyrore, - Bënë dallimin në mes vajërave dhe yndyrërave, - Paraqet esteret me ndihmën e formulave strukturale, - Emërton esteret sipas nomenklaturës “IUPAC”, - Përshkruan vetitë dhe reaksionet e estereve, - Përshkruan lipidet, - Analizon vetitë ,përfitimin dhe përdorimin te yndyrat, acidet e larta yndyrore, fosfogliceridet, dyllrat, sapunët dhe detergjentet, - Interpretion hidrolizën bazike te triglicerideve - Paraqet strukturën e karbohidrateve me formula të Fisherit dhe ato ciklike, - Klasifikon karbohidratet në bazë të vargut karbonik dhe numrit të njësisve përbërëse, - Dallon stereoizomerët e karbohidrateve dhe të paraqesin ata me formula strukturale dhe me modele molekulare, - Përshkruan vetitë e karbohidrateve dhe reaksionet e tyre, - Paraqet strukturën e monosakarideve , disakarideve dhe të polisakarideve me formula kimike dhe modeleve molekulare, - Përshkruan reaksionet e formimit të hemiacetaleve dhe Hemiketaleve, - Analizon qendrat kirale apo karbonin asimetric, enantiomeret, anomeret si dhe karbonin anomer, - Dallon sheqernat reduktues dhe joreduktues, në bazë të vetive të tyre, - Përshkruan vetitë strukturën,përhapjen dhe përdorimin e polisakaridet.
	Komponimet organike me	<ul style="list-style-type: none"> - Paraqet nitrokomponimet me ndihmën e formulave strukturale,

	<p>azot</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan vetitë fizike të nitrokomponimeve, - Emërton nitrokomponimet në bazë të nomenklaturës “IUPAC”, - Paraqet reaksionet e reduktimit të nitrokomponimeve, - Paraqet aminat me formula strukturale, - Klasifikon aminat sipas strukturës së tyre, - Emërton aminat sipas nomenklaturës “IUPAC”, - Përshkruan vetitë dhe reaksionet karakteristike të aminave, - Përshkruan vetitë bazike të aminave primare, sekondare dhe terciare, - Përshkruan komponimet heterociklike 5 dhe 6 anëtarëshe - Shpjegon rëndësinë biologjike të komponimeve heterociklike, - Klasifikon alkaloidet sipas veprimit të tyre, - Përshkruan veprimin fiziologjik të alkaloideve në organizëm, - Vlerëson rëndësinë e alkaloideve dhe vitaminave për funksionimin normal të organizmit dhe për mbrojtjen e tij, - Analizon klasifikimin e vitaminave, - Përshkruan strukturën e aminoacideve dhe proteinave, - Klasifikon aminoacidet sipas pozitës së grupeve funksionore, - Analizon jonin dipolar, dhe formwn anionike, kationike si dhe pikën izoelektrike të aminoacideve, - Analizon vetitë e aminoacideve, - Përshkruan strukturën parësore, dytësore, tretësore dhe kuaternere të proteinave, - Identifikon aminoacidet dhe proteinat, - Vlerëson rëndësinë e proteinave për zhvillimin e proceseve jetësore, - Analizon albuminat dhe proteidet, - Përshkruan nukleotidet dhe nukleozidet. - Përshkruan strukturën e ADN-së me modele (ose skicime) të thjeshta, - Vlerëson rëndësinë e ADN-së për bartjen e vetive
--	--------------------	--

		trashëguese, - Përshkruan funksionin katalitik të enzimeve, - Klasifikojnë enzimet sipas veprimit të tyre katalitik, - Numëron faktorët që ndikojnë në veprimin katalitik të enzimeve, - Vlerëson funksionin e enzimeve në proceset jetësore.
	Polimerët	- Paraqet polimerët me ndihmën e formulave strukturale, - Përshkruan përdorimin e polimerëve sintetikë, - Paraqet reaksionet e polimerizimit dhe të polikondensimit, - Dallon polimeret sipas përbërjes dhe vetive të tyre, - Përshkruan fijet sintetike dhe metodat e përfitimit të tyre, - Vlerëson rëndësinë e polimerëve sintetikë për prosperitetin e përgjithshëm, - Vlerëson ndikimin e produkteve polimere në ndotjen e mjedisit.

Udhëzime metodologjike

Për realizimin me sukses të Planit dhe programit të kimisë është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike siç janë: vizatime, diagrame, modele, grafikë, kimikate, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike bashkëkohore, kompjuter etj).

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe me kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, nga se nxitin dinamikën e orës, thyjnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të kimisë e veçanërisht të atyre që nevojiten për zgjidhjen e problemeve të përditshme.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda, forma të punës dhe teknika të ndryshme:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (përmes shpjegimit, sqarimit, ushtrimeve praktike dhe shembujve);
- Mësimdhënie e tërthortë (përmes shqyrtimit, zbulimit, zgjidhjes së problemeve)
- Konstruktivizmi dhe mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (përmes grupeve të vogla, grupeve më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit (të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjuter);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Vetëhulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe objekte industriale;

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritshme.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të gjykuar për punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një aparati matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi. Vlerësimi si një sistem i gjerë që mbështetet në procesin e të nxënit të nxënësve përfshin këto kategori vlerësimi:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo temë mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ, i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e përgjithshëm të të nxënit e nxënësit (përgjigjet me gojë, projektet, punimet seminarike, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testeve dhe provimeve etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshin tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdor mjete e teknika të shumëllojta vlerësimi dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit, nxënësit vlerësohen me nota (për një temë, për një tërësi temash, për një semestër ose gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimi i shërbejnë mësimdhënësit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione rreth përparimit të nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimor;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojnë përparimin e nxënësve;
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktualë;
6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen;
7. Të reflektojnë për përmirësimin e mësimdhënies bazuar në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

Udhëzime për burimet dhe mjetet mësimore

Që të realizohet me sukses mësimdhënia dhe mësimnxënia e Planit dhe programit të kimisë, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi:

- 1) Laboratori (kabinet) i kimisë ose laborator mobil.
- 2) Teksti i kimisë, doracak për mësimdhënësit, praktikume, fletore pune dhe libra të tjerë të ngjashëm në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja.
- 3) Revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi.
- 4) Sistem periodik të elementeve, fotografi, modele, skema, diagrame, makete, koleksionar të mineraleve.
- 5) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
- 6) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
- 7) FJALORI I KIMISË, SH.B. "8 Nëntori" Tiranë.
- 8) Bardhyl Musai, METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, Tiranë, 2003.
- 9) Grup autorësh, METODAT E MËSIMDHËNIES, (Manual për mësuesit e rinj).
- 10) Literatura tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjetet e tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimdhënësit që në vartësi nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje

baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuele, e me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjedhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Astronomi (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Astronomia është shkencë teorike dhe vrojtuese. Saktësia e të gjitha metodave analitike duhet t'i nënshtrohet gjyqit shkencor që është vrojtimi. Pa verifikim të njohurive me vrojtim, nuk mund të flasim për njohuri të mirëfilltë. Rëndom, vrojtimet udhëhiqen nga arsimitari i lëndës, nga vendi i ndriçuar shumë dobët në çfarëdo nate të kthjellët dhe të qetë kur këtë e mundësojnë kushtet atmosferike. Nuk duhet pritur që vrojtimet të bëhen paralelisht me zhvillimin e lëndës, por duhet shfrytëzuar kushtet klimatike të nevojshme për këtë qëllim. Se çka do të vrojtojë në qiell do të vendosë arsimitari. Preferohet të sigurohet një teleksop shkollor me të cilin mund të kryhen shumë vrojtme interesante dhe një hartë qiellore me yjësi të vizatuara. Në mungesë të teleskopit, atë duhet huazuar nga shkollat që e kanë atë.

Në të kundërtën nuk mund të flasim për ndonjë rezultat të mësimit. Astronomia është interesante pikërisht nga mundësia e vrojtimit. Lënda mësimore, Astronomia 12 më së shumti kontribuon në konceptin e fushës kurrikulare - **Toka, mjedisi dhe gjithësia**” por edhe në konceptet tjera. Lënda e astronomisë, që do të mësohet në klasën 12 përfshin njësitë mësimore më të kondenzuara, por gjithnjë duke pasur parasysh aftësitë psiko-fizike të nxënësve.

Nëpërmjet lëndës së astronomisë nxënësit njihen me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e dukurive të natyres

Qëllimi i mësimit të astronomisë është: zhvillimi i aftësive vrojtuese dhe të menduarit kritik që në realitet është një formë e sofistikuar e të menduarit, përkatësisht proces njohës, veprues dhe ndërveprues, përdorimit të mjeteve teknologjike gjatë hulumtit shkencor

Qëllimi

Programi i astronomisë ka për qëllim:

- të zhvillojë aftësi të nxënësit për të njohur dhe kuptuar pozitën e njeriut në kohë dhe në hapësirë, Tokës ku jeton dhe raportet mes trupave të tjerë në Gjithësi.
- të zhvillojë shkathtësi për të përshkruar saktësisht formën analitike të ligjshmërive të trupave qiellore, pozitën, lëvizjet e dukshme dhe të vërteta, përcaktimin e largësive, masave, dimensioneve, përbërjen kimike dhe natyrën fizike, lindjen dhe zhvillimin e tyre dhe të Gjithësisë në përgjithësi.
- të fitojë aftësi për arritje deri te ligjshmëritë kozmike me ndihmën e gjykimit vetjak dhe të kyçet në metodat elementare të përcaktimit të lidhjeve funksionale të dukurive me anë të vrojtimit
- zhvillojnë aftësitë shkencore, mendimin kritik dhe krijues,

- vlerësojnë kontributin e shkencës dhe teknologjisë në shërbim të shoqërisë njerëzore; ndërgjegjësohen për të bashkëvepruar me mjedisin në mënyrë të përgjegjshme dhe konsensuale,
- përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Përmbajtja e lëndës së Astronomisë është organizuar sipas koncepteve, temave dhe rezultateve të të nxënit lëndore (RNL)

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin gjashtë koncepte, të zërthyer në koncepte specifike (domeni) në tema dhe rezultateve të të nxënit lëndore me anë të të cilave përfshihet fondamenti i fushës së shkencës në lëndën përkatëse.

Rezultatet lëndore, në Astronomia 12 si pika referente kanë temat

- 1.Astrognozija apo njohja e objekteve në qiell të hapur**
- 2.Sfera qiellore dhe rrotullimi i saj**
- 3.Lëvizja e dukshme e Diellit në sferë qiellore.**
- 4.Gjeocentrizmi, heliocentrizmi dhe largësitë e trupave qiellore**
- 5.Dielli dhe yjet**
- 6.Toka dhe trupat tjerë të sistemit diellor.**
- 7.Galaktika e jonë**
- 8.Metagalaktika- Gjithësia**

Konceptet	Rezultatet e të nxënit (RNF, RNL)	
	Tërësitë tematike	Vlerëson sistemin gjeocentrik dhe heliocentrik, lëvizjen e dukshme të Diellit, rrjedhojat e saj, teoritë bashkëkohore të krijimit të sistemit diellor dhe shpjegon lidhshmërinë e hapësirë – kohës në krijimin e Gjithësisë në procesin e Eksplozimit të Madh.
Toka, mjedisi dhe gjithësia	1.Astrognozija apo njohja e objekteve në qiell të hapur	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -vën në dukje lëndën e studimit të astronomisë, ndarjen në disciplina, metodat e studimit, rolin e saj dhe lidhjen me shkencat tjera, -përshkruan pajisjet për vërtetim, për analizë të burimit dhe rolin e tyre në studimin e objekteve qiellore, -përshkruan tri karakteristikat themelore të çdo ylli sipas astronomisë klasike, yjësitë themelore, cirkumpolare, sipas stinëve të vitit dhe orientimin në qiell, -paraqet me ilustrim varësinë e dukjes së planetëve nga pozita e tyre në sistemin diellor ndaj Tokës, -tregon veçmas për çdo njerin nga tetë planetet e sistemit diellor, ecurinë e vërtetimit vizual apo fotografimit me teleskop me zmadhim 100- 300 herë, -prezanton një pasqyrë të shkurtër të zhvillimit historik të astronomisë dhe sajtet për materiale dhe informata që tejkalojnë mundësitë e këtij kursi.
	2.Sfera qiellore dhe rrotullimi i saj	<ul style="list-style-type: none"> -paraqet dëshmi dhe prova të përpikta, për vërtetimin e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet. -shpjegon me ilustrim koordinatat gjeografike në sipërfaqe të Tokës, -përkufizon sferën qiellore, shpjegon rrotullimin e dukshëm ditorë të saj dhe ditën yjore, -prezanton matjet këndore në sferë qiellore, rrahët e mëdhenj dhe të vegjël, trekëndshin sferik dhe elementet themelore të saj të përfituar nga rrotullimi i dukshëm ditorë, -shpjegon koordinatat e horizontit dhe ndërrimet ditore të tyre për një objekt qiellor, -përcakton lidhshmërinë mes gjërësisë gjeografike të vendit të vërtetimit dhe lartësisë të polt verior të botës,

		<ul style="list-style-type: none"> -paraqet me ilustrim sistemin e koordinatave të ekuatorit të vendit dhe të ekuatorit qiellor, -përcakton gjeometrikisht dhe analitikisht lidhjen mes koordinatave ekuatoriale dhe përkufizon kohën yjore, duke lexuar koordinatat e të njëjtit trup në çdo njerin system, -ven në dukje kulmet e trekëndshit sferik pozicional, për pjesën perendimore të qiellit dhe përcakton elementet e tij si lidhje mes tri sistemeve të koordinatave qiellore, -përshkruan lëvizjen e dukshme vjetore të Diellit në sistem të koordinatave të ekuatorit qiellor dhe analizon pamjen e rrotullimit të dukshëm të sferës qiellore në gjërësi të ndryshme gjeografike, -përcakton me ilustrim dhe analitikisht largësinë zenitare dhe lartësinë e trupit qiellor për deklinacione karakteristike gjatë kalimit nëpër meridian, -identifikon kufijtë e brezave klimatik në Tokë duke shfrytëzuar konditën e kalimit të Diellit nëpër zenit apo konditën e takimit të tij me horizontin, -zgjidhë detyra numerike për problemet që trajtohen në këtë tërësi tematike.
	<p>3.Lëvizja e dukshme e Diellit në sferë qiellore</p>	<ul style="list-style-type: none"> - vën në dukje fakte qenësore të përpikta, për vertetimin e rrotullimit të Tokës rreth Diellit. -shqyrton rrotullimin vjetorë të Tokës rreth Diellit dhe përkufizon vitin tropic, -shpjegon lëvizjen e dukshme ditore të Diellit gjatë vitit dhe lëvizjen e dukshme vjetore të tij mes yjeve, -paraqet me ilustrim sistemin e koordinateve të ekliptikës ndaj ekuatorit qiellor, të nevojshme për studimin e lëvizjes së Tokës dhe planeteve të sistemit diellor, -ven në dukje elementet e trekëndshit sferik si lidhje mes koordinatave të ekuatorit qiellor dhe ekliptikës duke njehsuar koordinatat e të njëjtit trup në dy sistemet koordinative, -emërton yjësitë nëpër të cilat kalon disku i Diellit gjatë lëvizjes së dukshme nëpër brezin me latitudë prej 8^0 në të dy anët e ekliptikës, -paraqet elementet tjerë të sferës qiellore të përfituar nga lëvizja e dukshme vjetore e Diellit. -analizon rrjedhojat e dy lëvizjeve themelore të Tokës, -tregon orientimin në kohë dhe hapësirë me ndihmën e Diellit dhe përcakton lartësisë maksimale h të tij me ndihmën e gnomonit, -shpjegon kohën e vërtetë diellore, kohën mesatare diellore, kohën qytetare dhe njehson lidhjen mes kohës mesatare diellore dhe kohës yjore,

		<p>-tregon sistemet e njehsimit të kohës, lokale, botërore, zonale,dekrete, lidhjen me gjatësi gjeografike dhe kufirin e dates,</p> <p>-prezanton vitin tropik si bazë të ndërtimit të kalendarit, krijimin e muajit dhe tregon emërtimin e ditëve të javës në kulturën shqiptare, sipas planeteve, që paraqet veçanti,</p> <p>-vën në dukje ndikimin e atmosferës në vrojtimet e objekteve ndriçuese qiellore dhe shpjegon dukuritë në Tokë të lidhura me te,</p> <p>-zgjidhë detyra numerike për problemet që trajtohen në këtë tërësi tematike.</p>
	<p>4.Gjeocentrizmi, heliocentrizmi dhe largësitë e trupave qiellore</p>	<p>-dallon lëvizjen e dukshme nga lëvizja e vërtetë e planeteve dhe sistemin gjeocentrik të Ptolemeut nga reforma e Kopernikut të bazuar në tri aksioma,</p> <p>-vlerëson kontributin e Xh.Brunos, T.Brahes, J. Keplerit, G. Galileit, dhe I. Njutonit, për përkrahje, plotësim dhe zbulim të ligjeve për thellimin e doktrinës heliocentrike,</p> <p>-përfiton shprehjen e njehsimit të periodës sinodike dhe siderike të planeteve dhe e zbaton për Hënën, Marsin dhe ndonje planet tjetër,</p> <p>-shpreh përgjithsimin e orbitave të planeteve me ndihmën e prerjeve konike dhe zbaton ligjin e tretë të Keplerit për përcaktimin e masave, periodave dhe gjysmëboshteve të orbitave,</p> <p>-analizon kuptimin e madhësive të cilat i përcaktojnë orbitat e planeteve rreth Diellit,</p> <p>-trajton problemin e shumë trupave dhe lëvizjen me trazirë si lëvizje e shpërputhur nga ligjet e Keplerit e shkaktuar nga prania e trupave tjerë, (zbulimi i Neptunit),</p> <p>-zbaton ligjin e gravitetit për shpjegimin e forcave batico-formuese, lëvizjen e polit verior të botës mes yjeve, lëkundjet e ngadalshme të boshtit të Tokës dhe kozmike. Shpejtësitë,</p> <p>-përfiton formulat për matje të largësisë së objektit në sipërfaqe të Tokës, për varësi të largësisë nga madhësia e bazës dhe nga këndi i shikimit, për largësi të planeteve dhe largësi të yjeve,</p> <p>-përkufizon njësitë për largësi në astronomi dhe përshkruan përcaktimin e diametrave linear të trupave të sistemit diellor,</p> <p>-zgjidhë detyra numerike për problemet që trajtohen në këtë tërësi tematike.</p>
		<p>-vën në dukje veçoritë themelore të Diellit, përcakton temperaturën e fotosferës duke e trajtuar si trup absolut të zi dhe nga identifikimi i gjatësisë valore të intensitetit maksimal të rezatimit,</p>

	5. Dielli dhe yjet	<p>-shpjegon strukturën e atmosferës diellore, aktivitetin dhe ilustron lidhjen mes ndërrimeve paleoklimatologjike dhe ciklit të njollave në 400 vjetët e fundit,</p> <p>-përshkruan burimet e energjisë diellore dhe strukturën e brendshme të tij,</p> <p>-identifikon lloje të ndryshme të spektrave dhe burimet gjegjëse të dritës së tyre,</p> <p>-dallon madhësitë yjore që përcaktohen me matje nga madhësitë që përcaktohen me llogaritje dhe tregon shembuj të krahasimit të ndriçimit të ndonjë ylli në raport me Diellin,</p> <p>-zbaton ligjin e rrezatimit për përcaktimin e diametrave të yjeve dhe përshkruan llojet radioteleskopëve dhe radiointerferometrave,</p> <p>-përcakton komponentet e shpejtësisë hapësirore të lëvizjes së yjeve në hapësirën qiellore ndaj Diellit,</p> <p>-shpjegon karakteristikat e përgjithshme fizike të yjeve dhe paraqet diagramet e lidhjeve të karakteristikave të veçanta,</p> <p>-dallon lloje të ndryshme të yjeve sipas karakteristikave specifike të tyre,</p> <p>-përshkruan lindjen e yjeve, burimet e energjisë yjore dhe trajton me diagram evolucionin e Diellit dhe yjeve,</p> <p>-zgjidhë detyra numerike për problemet që trajtohen në këtë terësi tematike.</p>
	6.Toka dhe trupat tjerë të sistemit diellor	<p>-përshkruan karakteristikat fizike të Tokës dhe ndërtimin e brendshëm të saj,</p> <p>-shpjegon fushën magnetike të Tokës dhe dallon shtresat e atmosferës sipas temperatures,</p> <p>-vën në dukje karakteristikat themelore të Hënës, përcakton largësinë dhe rrezën e saj, rrotullimin siderik, sinodik, të njëkohshëm rreth boshtit dhe ndaj Tokës dhe eklipset,</p> <p>-prezanton natyrën e Hënës dhe karakteristikat e sipërfaqes së saj,</p> <p>-përshkruan ecurinë e hulumtimit të planeteve, radiolokacionin, albedon dhe veçoritë e përgjithshme të planeteve të grupit të Tokës dhe të planeteve gjigantë,</p> <p>-prezanton veçoritë e përgjithshme të trupave të vegjël të sistemit diellor, brezin e Kuiperit dhe renë e Oortit,</p> <p>-prezanton angazhimin e NASA-s në hulumtimet NEO, për përcjellje të numrit shumë të madh të asteroidëve dhe kometave që zbulohen në vit (afro 1500) si rrezik potencial për Tokën,</p> <p>-dallon hipotezat klasike katastrofike nga hipotezat bashkohore të krijimit të sistemit diellor nga materia e ftoftë ndëryjore.</p>

	<p>7.Galaktika e jonë</p>	<ul style="list-style-type: none"> -paraqet përmbajtjen dhe strukturën e Rrugës së Qumshtit, -vën në dukje me vizatim sistemin e koordinateve të Galaktikës, -identifikon veçoritë e gazit dhe të pluhurit ndëryjorë, grumbullimeve dhe asociacioneve yjore, brenda dhe në halo sferoidale të Galaktikës, -përshkruan veçmas satelitët e mëdhej dhe satelitët e vegjël të Rrugës së Qumshtit dhe paraqet formulën e kriterit të avansimit të shndërrimit në yje të gazit ndëryjorë, -shqyrton rrotullimin e Rrugës së Qumshtit, përcakton masën dhe trajton lëvizjen e yjeve, radiorrezatimin, origjinën e rrezeve kozmike dhe fushën magnetike ndëryjore.
	<p>8.Metagalaktika-Gjithësia</p>	<ul style="list-style-type: none"> -tregon mënyrët e përcaktimit të diametrit linear të galaktikave tjera, të largësive dhe të masave të tyre, -shpjegon galaktikat e grupit lokal dhe bashkëveprimin e tyre, -paraqet shumëtrajtshmërinë e botës së galaktikave, klasifikimin e Hablit sipas dukjes së jashtme dhe formulën e shtypshmërisë së galaktikave eliptike, -prezanton galaktikat me bërthamë aktive, që emetojnë më shumë energji me radiorrezatim se në spektrin optic, -përshkruan objektet më të largëta të vrojtuar në Gjithësi, si burime më të fuqishme ekzistuese të rrezatimit në spektrin e dukshëm dhe pjesën infrakuqe, -trajton Metagalaktikën si sistemit gjigant që përmban të gjitha grumbullimet galaktike të njohura deri sot së bashku me materien ndërgalaktike, -shpjegon largimin reciprok të galaktikave dhe trajton Metagalaktikën si sistem jo stacionarë dhe evolutiv të përshkruar me ligjin e Hablit, -paraqet diagramin e zhvendosjes së kuqe ndaj largësive të galaktikave në shkallë logaritmike, dhe zbaton ligjin e Hablit për përcaktimin e largësive dhe përmasave lineare të ndonjë objekti galaktik, -interpretin fillimin e Gjithësisë nga një eksplozim i hatashëm me temperaturë dhe dendësi çmendurisht të lartë i njohur si Big- Bang dhe rrezatimin relik si provë e kësaj ndodhie, -paraqet modelet kozmologjike të Gjithësisë të bazuar në parimin kozmologjik dhe njehson dendësinë kritike të materies si kriter të zgjerimit apo ngjeshjes së saj në të ardhmën.

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor në lenden e astronomisë në kuadër të shkencave natyrore qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përzgjedhja e metodologjive duke u harmonizuar me rezultatet e pritshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Shkencat e natyrës janë shkencë eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, vërtetim demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës. Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës perkatesishte në lenden e astronomisë varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Përzgjedhja e metodave për lenden e astronomisë është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve, etj. Do të përmendim disa nga metodat të përgjithshme që mund të përdoren në këto raste.

Metoda e vëzhgimit

Metoda e vëzhgimit është një metodë që ndihmon nxënësit në formimin e koncepteve shkencore. Nëpërmjet kësaj metode nxënësit bëjnë lidhjen ndërmjet koncepteve abstrakte dhe objekteve, apo dukurive të botës reale. Kur vëzhgojnë objekte (sferen qiellore, yjet, planetet e trupat tjere qiellore), apo dukuri, nxënësit përdorin njohuritë shkencore. Vëzhgimet i ndihmojnë ata për të krijuar përfytyrime të qëndrueshme për botën dhe hapsirën që na rrethon. Vëzhgimet në natyrë i nxisin nxënësit të punojnë në mënyrë shkencore, të ngrenë hipoteza dhe t'i testojnë ato. Vëzhgimi është hapi i parë i një hulumtimi, eksperimenti apo studimi.

Hulumtimi - Nxënësit angazhohen në veprimtari, përmes të cilave kuptojnë se si shkencëtarët mendojnë dhe çfarë bëjnë në një proces vendimmarrjeje, si ngrenë pyetje dhe si planifikojnë hulumtimin. Përmes të nxënies kërkuese, nxënësit aftësohen të përftojnë njohuri dhe të krijojnë një botëkuptim për botën natyrore dhe fizike bazuar në hulumtimin shkencor. Gjithashtu, ata bëhen kompetentë që të zbatojnë aftësitë dhe proceset kërkuese, si dhe të zhvillojnë qëndrimet dhe vlerat që janë themelore për praktikën e shkencës.

Projektet - Projektet janë veprimtari të nxënies nëpërmjet të cilave nxënësit zbulojnë objektet, proceset apo dukuritë.

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit - Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit mbështet procesin kërkues, rrit cilësinë e të nxënies të nxënësve dhe siguron bashkëpunimin mes tyre. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, nxënësit mund të eksplorojnë dhe të perceptojnë konceptet abstrakte si dhe të zbulojnë marrëdhëniet ndërmjet objekteve dhe dukurive.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për medie,
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

Edukimi për media

I referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm.

Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të të nxënësve. Ai mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësi. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënësve në nivel klase dhe shkalle të nxënësve. Me këtë informacion mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga ana e tyre të kompetencave të fushës së shkencave të natyrës.

Vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, ndaj është e rëndësishme që mësuesi t'ia përshtatë llojin e vlerësimit, qëllimit specifik të synuar. Para marrjes së një vendimi në lidhje me një aspekt të caktuar të performancës së nxënësve, mësuesi duhet të sigurojë që mënyra e vlerësimit të përdorur, të zotërojë informacionin që reflekton saktësisht një aspekt të veçantë të performancës që ai ka për qëllim të vlerësojë.

Është thelbësore që vlerësimi të jetë pjesë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. I gjithë procesi i të nxënësve në shkencat e natyrës mbështetet në kërkimin shkencor, si i tillë edhe vlerësimi merr shumë forma.

Duke qenë pjesë e procesit të të nxënës, vlerësimi formues përdoret në të gjitha shkallët. Vlerësimi formues u shërben nxënësve për të përmirësuar të nxënës dhe mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies.

Vlerësimi përmbledhës përdoret për të përcaktuar shkallën në të cilën janë arritur kompetencat. Ai shërben jo vetëm për të informuar nxënësit dhe prindërit për progresin e tyre, por edhe për të përmirësuar praktikatat e mësimdhënies dhe të nxënës.

Vlerësimi diagnostikues zakonisht kryhet në fillim të shkollës apo të vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth qëllimit për të cilin po kryhet vlerësimi.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i shoku-shokut e bën nxënësin më të vetëdijshëm për përparimin e tij dhe gjithashtu i lejon ata të analizojnë dhe krahasojnë idetë e tyre me ato të shokëve, mësuesve dhe prindërve.

Për vlerësimet me shkrim, mësuesi duhet të përdorë situata të jetës reale që përfshijnë shkencën në jetën e përditshme, shoqëri dhe mjedis. Situatat e zgjedhura duhet të jenë domethënëse dhe tërheqëse. Përveç testeve me shkrim, mësuesit mund të kryejnë vlerësime të bazuara në performancën e nxënësve, duke përdorur mënyrat e mëposhtme, si:

punët praktike; punët laboratorike; projektet kurrikulare dhe ndërlëndore; detyrat individuale; vrojtimit e mësuesit; listat e kontrollit; posterat; debatet; esetë; portofoli.

Mësuesi mund të vlerësojë nxënësin përmes përdorimit të portofolit. Ai është një koleksion sistematik i punës së nxënësit dhe siguron një tablo të plotë të arritjeve të tyre. Puna e mbledhur, ofron të dhëna të shumta për zhvillimin dhe progresin e nxënësve në përvetësimin e njohurive, në të kuptuarit e koncepteve shkencore, zbatimin e shkathtësive të procesit, dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ajo, gjithashtu, u ofron nxënësve mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin e përmbajtjes programore të astronomisë në klasën 12 për gjimnazin Shkencat e natyres, përveç tekstit shkollor si burim tradicional i mësimnxënies preferohet edhe qasja në internet. Për këtë qëllim, në këtë program një mësim i astronomisë është emërtuar **astronomia në internet**, në të cilin jepen sajtet për problemet më karakteristike të astronomisë. Si burim plotësues sugjerohet edhe përdorimi i tekstit të **astronomisë për universitet** në të cilin gjenden shumë të dhëna në pajtim me programin e ri të përpiluar. Në internet mund të gjenden edhe metoda të ndryshme shpjegimi dhe zbulime të reja nga observatorët e ndryshëm.

Realizimin me sukses të kompetencave në shkencat e natyrës- fizike është e nevojshme të shfrytëzohen mjete dhe materiale të ndryshme mësimore si dhe mjedis i përshtatshëm mësimor

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;
- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, diagrame, mjete grafike etj.;
- Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, , videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, e-mail-i;
- Mjedis mësimor (klasa, laborator, punëtorja, natyra, ferma etj.).
- Punëtorja, natyra, etj.).

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Gjeografi (Gjimnazi i shkencave natyrore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Programi i lëndës Gjeografia për klasën e 12-të të Gjinnazit të shkencave natyrore është ndërtuar mbi bazën e nivelit të I-rë të arsimit parauniversitar, ku përmbajtjet gjeografike janë të integruara në kuadër të fushës kurrikulare: Shkencat e natyrës, ndërsa në nivelin e II-të si lëndë e veçantë në kuadër të fushës: Shoqëria dhe mjedisi.

Programi i lëndës Gjeografia për klasën e 12-të rrjedh nga KK dhe KB e arsimit parauniversitar, rezultatet e të nxënës të kompetencave (RNK), rezultatet e të nxënës të fushës së Shkencave natyrore (RNF), shkalla VI-të kurrikulare dhe planit mësimor të arsimit të mesëm të lartë-gjinnazit.

Programi i lëndës Gjeografia në klasën 12 zhvillon të nxënësit njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të cilat kanë të bëjnë me trajtimin gjeografik regjional, duke pasur në fokus kryesor hapësirën e vendit tonë, Kosovën. Në këtë kuadër, formimi gjeografik i nxënësit fokusohet në trajtimin e hierarkisë dhe lidhjeve regjionale midis Evropës, regjionit, Kosovës dhe trevave të tjera shqiptare; si dhe në trajtimin e detajuar të dallimeve dhe mundësive në zhvillimet e ndryshme regjional të vendit.

Programi synon që nxënësit të aftësohen të zbulojnë dhe argumentojnë lidhjet shkak-pasojë të dukurive dhe proceseve natyrore dhe humane që ndodhin në rajone të ndryshme gjeografike të Kosovës, trevave tjera shqiptare dhe vendeve përreth, të zhvillojnë aftësi të kërkimit gjeografik përmes hulumtimit të tipareve dhe veçorive të regjioneve të veçanta të vendit tonë, si dhe të bëjnë gjykime e të zhvillojnë qëndrime në lidhje me perspektivat e zhvillimit të qëndrueshëm regjional.

Përmes detyrave, punëve praktike, projekteve kurrikulare e strategjive të tjera ndërvepruese, përdorimit të teknologjisë së informacionit, nxënësit aftësohen në kërkimin gjeografik dhe zhvillojnë të menduarin kritik e krijues, zhvillojnë shkathtësi të komunikimit dhe të punës në grup.

Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e kompetencave kyçe në funksion të të nxënës gjatë gjithë jetës. Zhvillimi i kompetencave është pikënisja dhe parimi bazë organizativ i këtij programi. Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e tyre nëpërmjet zhvillimit të situatave të të nxënës.

Lënda e gjeografisë për klasën e 12-të të gjinnazit trajton përmbajtjet lëndore, në përputhje me moshën e nxënësve. Zhvillimi i planit dhe programit mësimor të gjeografisë për kl.e 12-të ndërtohet mbi bazën e procedurës shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës si dhe parashtrimi i rezultateve të të nxënës për kompetenca, rezultateve të të nxënës të fushës së shkencave natyrore si dhe instrumentet e vlerësimit. Ai synon që nxënësit të nxiten të eksplorojnë dhe të zhvillojnë dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera.

Qëllimet

Të zhvillojë njohuri, shkathtësi dhe qëndrime mbi sistemet fizike, humane edhe regjionet e Kosovës, trevave tjera shqiptare dhe vendeve përreth;

Të aftësohet të zbulojë dhe argumentojë lidhjet shkak-pasojë të dukurive dhe proceseve që ndodhin në sistemet natyrore dhe humane në kuadër të Kosovës, trevave tjera shqiptare dhe vendeve përreth;

Të zhvillojnë aftësi për të gjetur zgjidhje dhe për të mbajtur qëndrime mbi proceset, dukuritë, modelet dhe marrëdhëniet midis tyre mbi bazën e ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues;

Të aftësohet për përpunimin e të dhënave statistikore, ndërtimin dhe interpretimin e diagrameve, grafikëve, hartave etj;

Të aftësohet përmes përdorimit të burimeve të ndryshme, si: harta, globi, fotografi, statistika, diagrame, ilustrime fotosh dhe video etj, të zbulon dhe përvetëson informacione dhe koncepte gjeografike mbi veçoritë specifike të Kosovës, trevave tjera shqiptare dhe vendeve përreth;

Të aftësohet përmes detyrave, punëve praktike, projekteve kurrikulare e strategjive të tjera ndërvepruese, në kërkimin gjeografik dhe të menduarin kritik e krijues;

Të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik dhe të punës në grup;

Të zhvillohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme;

Të përdorë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës së Gjeografisë është hartuar mbi bazën e koncepteve kryesore të fushës të shkencave natyrore në veçanti koncepti Toka, mjedisi dhe gjithësia, temave mësimore si dhe balancimit të rezultateve të të nxënit me temat. Mbetet përgjegjësi e mësimdhënësit të bëjë balancimin e rezultateve për temë, me rezultatet e të nxënit për njësi mësimore, përmes përmbatjeve në interes të nxënësve.

Rezultatet e njësive mësimore mbeten si mundësi e përzgjedhjes së mësimdhënësit duke respektuar autonomi e shkollës dhe të mësimdhënësit. Kjo u jep liri mësimdhënësve, të cilët duke u nisur nga kushtet konkrete (nxënësit, paisjet etj.), mund të zgjedhin rezultatet specifike, por duke u bazuar në RNL dhe RNF për t'u përvetësuar sa më mirë nga nxënësit këto rezultate.

Programi lëndorë i Gjeografisë për gjimnazin e shkencave natyrore, shkalla e 6, klasa 12 është strukturuar në temat: Regjioni (Rajoni) – "Gjeografia e Republikës së Kosovës, trevave tjera

shqiptare dhe vendeve përreth" (Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Greqia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Turqia) dhe Bashkëveprimi njeri/natyrë.

Koncepti		
Toka, mjedisi dhe gjithësia	RNF: 2.4. 6. <i>Analizon veçoritë e pozitës gjeografike, kushteve natyrore (relievit, klimës, ujërave, tokave dhe botës bimore e shtazore) dhe socio-ekonomike (popullsisë, vendbanimeve veprimtarive ekonomike), rolin e resurseve natyrore në mjedis dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe vendeve përreth.</i>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	1.Regjioni - Gadishulli Ballkanik dhe Kosova	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon veçoritë e pozitën gjeografike të kushteve natyrore (relievit, klimës, ujërave dhe botës bimore e shtazore) e socio-ekonomike (popullsisë, vendbanimeve, resurseve natyrore dhe veprimtarive ekonomike) të Gadishullit Ballkanik, • Shpjegon veçoritë e pozitës gjeografike të Republikës së Kosovës në Gadishullin Ballkanik, Mesdhe, Evropë dhe më gjërë, shtrirjen territoriale dhe kufizimin me vendet fqinje, • Identifikon tiparet kryesore ndërtimit gjeologjik dhe relievit të Republikës së Kosovës përmes veçorive dalluese të tyre, • Analizon rolin e relievit në zhvillimet dhe shpërndarjen hapësinore të elementeve demografikë dhe ekonomike, • Analizon elementet kryesore klimatike dhe tiparet e tyre duke evidentuar veçoritë kryesore të klimës së Kosovës dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj, • Vlerëson rolin dhe ndikimin e klimës në dukuritë e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe aktivitetet e saj, • Analizon veçoritë kryesore të ujërave në Republikës së Kosovës sipas veçorive dalluse të tyre dhe faktorët që kanë ndikuar, • Vlerëson rolin e pasurive hidrike për zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të ndryshme, • Analizon kushtet dhe faktorët që ndikojnë në larminë e tokave të Republikës së Kosovës

		<p>përmes veçorive dalluese të tyre,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizon faktorët dhe kushtet që kanë përcaktuar larminë dhe pasurinë e madhe bimore dhe shtazore të Republikës së Kosovës, • Evidenton disa ndër sitet e trashëgimisë natyrore të Republikës së Kosovës, • Evidenton ndryshimet në organizimet administrativo-tokësore në Republikën e Kosovës, • Analizon faktorët që kanë ndikuar në popullimin e hershëm të territorit të sotëm të Republikës së Kosovës, • Analizon ndikimin e faktorëve fizikë, mjedisor, ekonomik dhe politik në shpërndarjen e popullsisë në Republikën e Kosovës (lëvizja numerike, dendësia, lëvizja natyrore); • Evidenton tiparet e përgjithshme të strukturës së popullsisë së Republikës së Kosovës, referuar: moshës, gjinisë, arsimit, ekonomisë, etnisë, dhe fesë, • Shpjegon llojet, shkaqet dhe pasojat e migrimeve në Republikën e Kosovës, • Ndërton dhe analizon grafikë të strukturës së popullsisë dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të saj, • Identifikon faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në krijimin e vendbanimeve, funksioniet dhe kriterit kryesore të tyre në Republikën e Kosovës, • Argumenton faktorët që ndikojnë në procesin e urbanizimit (lidhjet mes industrializimit, urbanizimit dhe deagrarizimit), • Analizon shkatarrët që kanë ndikuar në krijimin e diasporës shqiptare, • Përshkruan tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Kosovës, duke analizuar ecurinë e tyre përgjatë periudhave të ndryshme si dhe rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e Kosovës, • Evidenton degët kryesore të bujqësisë, nivelin e
--	--	--

		<p>zhvillimit të tyre dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon vendodhjen e burimeve energjetike dhe të pasurive minerale të Republikës së Kosovës, • Analizon faktorët që ndikojnë në zhvillimin e industrisë, degët kryesore të industrisë, zhvillimin e tyre dhe rolin e industrisë në transformimin e përgjithshëm ekonomik në Republikën e Kosovës, • Ndërton dhe analizon grafikët e strukturës së ekonomisë dhe degëve të saj si dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të rajoneve kryesore bujqësore dhe industriale të Kosovës, • Shpjegon veçoritë kryesore të komunikacionit (automobilistik, hekurudhor, ujor, ajror) në Republikën e Kosovës, • Identifikon veçoritë kryesore të tregtisë dhe zejtarisë në Republikën e Kosovës, • Analizon bazën natyrore, kulturore dhe shoqërore në zhvillimin e turizmit në Republikën e Kosovës, • Analizon tiparet gjeografike natyrore, demografike dhe ekonomike të regjionit lindor të Republikës së Kosovës, • Analizon tiparet gjeografike natyrore, demografike dhe ekonomike të regjionit perëndimor të Republikës së Kosovës.
<p>RNF: 2.4. 6. <i>Analizon veçoritë e pozitës gjeografike, kushteve natyrore (relievit, klimës, ujërave, tokave dhe botës bimore e shtazore) dhe socio-ekonomike (popullsisë, vendbanimeve veprimtarive ekonomike), rolin e resurseve natyrore në mjedis dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe vendeve përreth.</i></p>		
	<p>Tema</p>	<p>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</p>
<p>Regjioni - Shqipëria</p>		<ul style="list-style-type: none"> • Analizon veçoritë e pozitës gjeografike të Shqipërisë në Gadishullin Ballkanik, Mesdhe, Evropë dhe më gjërë, shtrirjen territoriale dhe kufizimin me vendet fqinje, • Shpjegon tiparet kryesore ndërtimit gjeologjik dhe relievit të Shqipërisë përmes veçorive dalluese të tyre, • Identifikon elementët kryesorë klimatik dhe

		<p>tiparet e tyre si dhe evidenton tiparet kryesore të klimës së Shqipërisë dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizon larminë dhe pasurinë e madhe hidrografike të Shqipërisë dhe faktorët që kanë ndikuar, • Analizon kushtet dhe faktorët që ndikojnë në larminë e tokave të Shqipërisë, • Analizon faktorët dhe kushtet që kanë përcaktuar larminë dhe pasurinë e madhe bimore dhe shtazore të Shqipërisë, • Analizon veçoritë specifike popullesë dhe vendbanimeve të Republikës së Shqipërisë, • Analizon veçoritë themelore ekonomike-gjeografike të Shqipërisë si faktorët kryesor që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe veprimtarit ekonomike sipas sektorëve përkatës (bujqësinë, industrinë, tregtinë, transportin, turizmin, shërbimet dhe artizanatin), • Evidenton karakteristikat kryesore të kushteve natyrore, të popullimit dhe të zhvillimit ekonomik të katër regjioneve të Republikës së Shqipërisë.
	<p>RNF: 2.4. 6. <i>Analizon veçoritë e pozitës gjeografike, kushteve natyrore (relievit, klimës, ujërave, tokave dhe botës bimore e shtazore) dhe socio-ekonomike (popullsisë, vendbanimeve veprimtarive ekonomike), rolin e resurseve natyrore në mjedis dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe vendeve përreth.</i></p>	
	Regjioni - Maqedonia	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon pozitën gjeografike, veçoritë kryesore natyrore dhe demografike e socialo-ekonomike të trevave shqiptare në Maqedoni; • Shpjegon tiparet e pozitës gjeografike, veçoritë natyrore dhe socio-ekonomike të Maqedonisë;
	Regjioni - Serbia	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon pozitën gjeografike, veçoritë kryesore natyrore dhe demografike e socialo-ekonomike të trevave shqiptare në Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, • Përshkruan veçoritë e pozitës gjeografike, veçoritë natyrore dhe socio-ekonomike të Serbisë.
	Regjioni - Mali i Zi	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon pozitën gjeografike, veçoritë kryesore

		<p>natyrore dhe demografike e socialo-ekonomike të trevave shqiptare në Mal të Zi,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon veçoritë e pozitës gjeografike, veçoritë natyrore dhe socio-ekonomike të Malit të Zi.
	Regjioni - Greqia	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon pozitën gjeografike, veçoritë kryesore natyrore dhe demografike e socialo-ekonomike të trevave shqiptare në Çamëri, • Identifikon veçoritë e pozitës gjeografike, veçoritë natyrore dhe socio-ekonomike të Greqisë.
	Regjioni - Bosnja dhe Hercegovina	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon veçoritë e pozitës gjeografike, veçoritë natyrore dhe socio-ekonomike të Bosnjës dhe Hercegovinës.
	Regjioni - Kroacia	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan veçoritë e pozitës gjeografike, veçoritë natyrore dhe socio-ekonomike të Kroacisë.
	Regjioni - Turqia	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon veçoritë e pozitës gjeografike, veçoritë natyrore dhe socio-ekonomike të Turqisë.
<p>RNF: 2.4. 6. <i>Analizon veçoritë e pozitës gjeografike, kushteve natyrore (relievit, klimës, ujërave, tokave dhe botës bimore e shtazore) dhe socio-ekonomike (popullsisë, vendbanimeve veprimtarive ekonomike), rolin e resurseve natyrore në mjedis dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe vendeve përreth.</i></p>		
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	2.Bashkëveprimi njeri/natyrë	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon faktorët kryesorë dhe pasojat e problemeve mjedisore në vendin tonë, • Interpretin faktorët që kanë ndikuar në shkallën e lartë të degradimit dhe shkretimit të tokave si dhe pasojat e tyre, • Vlerëson ndikimin e veprimtarisë njerëzore në ndryshimin e peizazheve të ndryshme, • Parashikon rrugë të menaxhimit efektiv të këtij ndikimi, • Përgatit një raport mbi një problem të caktuar mjedisor (p.sh.: ndotja e ajrit në qytetin e Prishtinës, Mitrovicës, Obiliqit (Kastriotit) etj., faktorët, pasojat; ndotja e ujit në liqene e lumenj (p.sh. Sitnica), faktorët, pasojat, etj).

Udhëzimet metodike/metodologjike

Për zbatimin praktik të programit mësimor të lëndës së Gjeografisë, nevojitet përzgjedhja e metodologjive adekuate duke i harmonizuar ato me rezultatet kompetencave (RNK), rezultatet e fushës (RNF), rezultatet e të nxëniet të lëndës për temat (RNL-të), të cilat janë pika referente për realizimin e përmbajtjeve të lëndës e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies, në lëndën e gjeografisë, janë një ndër pikat kyqe të programit për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Zbatimi i metodave, teknikave, strategjive dhe formave të ndryshme të organizimit të procesit është një e drejtë profesionale e mësimdhënësve.

Rekomandohet që për aspektet e shumta të rrafshit metodologjik, teorik edhe aplikativ të tregohet kujdesi i vaçantë. Metodologjia duhet të përzgjidhet paraprakisht në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, në përshtatje me përmbajtjen e temës që do të zhvillohet, por edhe në varësi të bazës didaktike dhe nivelit të formimit gjeografik të nxënësve.

Metodologjia është mirë të jetë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive dhe vlerave gjeografike, në radhë të parë të atyre që duhen për t'u zgjidhur problemet e jetës së përditshme.

Metodat didaktike është mirë të ndërthuren me njëra-tjetrën gjatë gjithë orës së mësimin, në përputhje me karakterin e dijeve, të rezultateve lëndorë si dhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësimdhënësit dhe nxënësit.

Mësimdhënia dhe të nxëniet, bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësimdhënësit e kësaj lënde:

- të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësit;
- të nxitin vrojtimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë;
- të nxitin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- të motivojnë nxënësin, duke e konsideruar si partner, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit;
- të mbështesin të nxëniet e pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;
- të mbajnë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës "Shkencat natyrore", zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore;
- të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por të pamjaftueshëm për përmbushjen e kompetencave të fushës;
- të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxëniet;

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma

dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtëdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie joedrejtëpërdrejt (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Për realizimin e programit, mësimdhënësi duhet ketë parasysh edhe parimet bazë në mësimin e gjeografisë. Ai gjatë realizimit të programit të gjeografisë i udhëheq nxënësit në mnyrë që ata me aktivitetet e tyre në klasë, kabinet, natyrë etj., të mund të: njohin, vëzhgojnë, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, duke unisur prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërme kah e largëta, prej të thjeshtë kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmeja

Format e punës në mësimin e gjeografisë

Në procesin mësimor të realizimit të përmbajtjeve programore të gjeografisë aplikohen forma të ndryshme të punës:

- individuale
- në çifte
- në grupe
- me tërë klasën etj.

Mësimdhënia dhe të nxënësve të integruar

Shkencat e natyrës jo vetëm se janë të ndërlidhura në mes veti meqë e studjojnë natyrën në aspekte të ndryshme, por janë të ndërlidhura edhe me fushat tjera sudimore.

Në Shkencën e Gjeografisë si për njohuritë teorike, ashtu dhe për njohuritë empirike që përmban kjo lëndë, krijohen një sërë sistemesh njohurish, sikundër janë njohuritë gjeomorfologjike, klimatologjike, hidrografike, biogjeografike etj.

Mësimdhënësi e kësaj lënde duhet të kenë në qendër të vëmendjes lidhjet integruese brenda fushës së shkencave natyrore. Shkenca e Gjeografisë, fizika, kimia dhe biologjia, si lëndë të së njëjtës fushë studimi, kanë mundësi të shumta integrimi midis tyre. P.sh. Ndotja e ujit, ajrit dhe

tokës, biodiversiteti etj është objekt integrimi ndërmjet Shkencës së Gjeografisë me shkencat e natyrës.

Integrimi me fushat e tjera kurrikulare

• Komunikimi dhe të shprehurit

Si të gjitha lëndët e tjera, gjeografia krijon mundësi të zbatimit të kompetencave që zhvillon fusha "Gjuhët dhe komunikimi". Gjuha është themelore për të nxënin e nxënësve në lëndën e gjeografisë. Nxënësi përzgjedh strategjitë e përshtatshme gjuhësore për të eksploruar, prezantuar dhe komunikuar të kuptuarin e dukurive gjeografike. Ai përdor gjuhën letrare për të shprehur pozicionin e tij qartë dhe në mënyrë koherente. Por njëkohësisht dhe gjeografia ndihmon në zgjerimin dhe përpunimin e fjalorit të nxënësit, duke e nxitur atë të parashtojë qartë dhe saktësisht idetë e tij, me gojë ose me shkrim. Punët praktike, projektet dhe detyrat që nxënësi realizon, i mundësojnë zhvillimin e kompetencës së komunikimit gjuhësor dhe pasurimin e fjalorit terminologjik. Termat e ndryshme, të përdorura në këtë lëndë, janë specifike dhe ndihmojnë nxënësin për zhvillimin e kompetencës së komunikimit përmes përdorimit të gjuhës dhe terminologjisë gjeografike.

• Matematika

Nxënësi zhvillon njohuritë matematikore përmes përdorimit të informacioneve sasiore dhe cilësore, leximit apo ndërtimit të hartave, grafikëve dhe tabelave statistikore. P.sh., nxënësi llogarit mesataren ditore, mujore apo vjetore të temperaturave të ajrit; llogarit kohën lokale e zonale mbi bazën e veprimeve me thyesa; ndërton grafikë të shpërndarjes së reshjeve, temperaturës dhe i interpreton ato. Nxënësi ndërton diagrame që paraqesin strukturën e popullsisë të Kosovës, trevave tjera shqiptare dhe vendeve përreth, të ekonomisë dhe sektorëve të saj etj.

• Shoqëria dhe mjedisi

Historinë i shërben nxënësit të kuptojë më mirë ndryshimet që kanë pësuar kulturat e ndryshme dhe ndikimin e tyre në zhvillimet e vendeve dhe rajoneve, si dhe sfidat e ndërvarësisë globale. Nxënësi hulumton mbi historinë e mendimit gjeografik për të kuptuar evolucionin e ideve dhe teorive.

Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e dimensioneve të qytetarisë. Ai e sheh botën si bashkësi globale dhe të ndërvarur. Nxënësi identifikon probleme, sugjeron zgjidhje dhe reflekton për marrjen e vendimeve. Gjeografia u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret qytetaria dhe ndihmon në debate për çështje dhe ngjarje të rëndësishme.

• Jeta dhe puna

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) mbështet të nxënit në lëndën e gjeografisë përmes realizimit të detyrave të ndryshme, projekteve, kërkimit, përpunimit dhe prezantimit të informacionit. Nxënësi mëson të përzgjedhë informacionin dhe të mbajë qëndrim kritik ndaj tij, të dallojë faktin nga opinioni. Nxënësi mund të përdorë word-processor në shkrimin e

materialeve, zbaton hedhjen e të dhënave në tabelë për ndërtimin e grafikëve, përdor power point për prezantimin e një detyre, kërkon në internet harta dhe përcakton vendndodhjen e objekteve të ndryshme.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare paraqesin përmbajtje të rëndësishme kurrikulare, të cilat nuk i takojnë ekskluzivisht vetëm një lënde. Ato realizohen përmes lëndëve të ndryshme kurrikulare (mësimore), dhe janë në funksion të zhvillimit të kompetencave, respektivisht të arritshmërisë së rezultateve të të nxënësve për shkallë kurrikulare. Përmbajtjet e tyre dalin nga edukimit për paqe, të drejtat e njeriut, edukimi ndërkulturor, shkathtësitë e komunikimit, çështjet gjinore dhe edukimi qytetar, duke përfshirë edhe ndërgjegjësimin për ruajtjen dhe kujdesin e mjedisit, edukimin për karrierë dhe aftësitë për jetë.

Si realizohen çështjet ndërkurrikulare?

Çështjet ndërkurrikulare mund të integrohen në kurrikulë nëpërmjet njësive tematike dhe njësive mësimore, nëpërmjet aktiviteteve praktike në klasë, por edhe projekteve të përbashkëta që ndërlidhin fushat kurrikulare.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën shkollore të shkencave natyrore për këtë shkallë kurrikulare gjegjësisht për klasën 12-të, janë:

- Edukimi për media
- Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm

Edukimi për media - i referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja, të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit për media përfshin përmbajtje lidhur me publikimet shkencore, shpërblimet për të arriturat në shkencë qoftë në nivelin kombëtar apo ndërkombëtar. Po ashtu duhet të përfshijë edhe përparësitë, mangësitë dhe rreziqet e mesazheve (informatave), të medieve, duke pasur edhe qëndrim kritik, në rast të manipulimit të medieve dhe duke vepruar gjithmonë në përdorimin e tyre (medieve) , për të vepruar në shërbim të të mirës publike.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve, për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve për mjedisin, në vetëdijësimin e tyre, duke rritur ndjenjën e përgjegjësisë ndaj mjedisit natyror dhe atij të bërë nga dora e njeriut, në ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global.

Këtu hyjnë çështjet si: aspekti social, zhvillimi ekonomik, mjedisi i shëndetshëm, kapaciteti për t'u përballur me katastrofat natyrore dhe ato të krijuara nga dora e njeriut, shfrytëzimi i burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm.

Për më shumë shih Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë –Gjimnaz

Udhëzimet për vlerësim

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathhtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara.

Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënies në nivel klase dhe shkalle. Me këtë informacion, mësimdhënsi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësit, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga nxënësi të kompetencave të fushës “Shkencat natyrore”. Vlerësimi u shërben mësimdhënësve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, nxënësve për të përmirësuar të nxënies si dhe prindërve për të monitoruar progresin e fëmijëve të tyre në shkollë.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- Vlerësimit të punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënies;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënies;
- Vetëvlerësimit të nxënësve;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Për të arritur synimet e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA ,i bazuar në kërkesat e KK-së.

Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel klase nga mësimdhënësi/et e lëndëve mësimore përkatëse dhe sipas përshkrimit të procedurave e kriterëve për secilin lloj të vlerësimit të brendshëm, të rregulluara me akte nënligjore. Fokusi kryesor i vlerësimit të brendshëm është mbështetja e të nxënies të nxënësve për zotërimin e kompetencave të shkallëve të caktuara. Kjo arrihet duke kombinuar vlerësimin formativ (për nxënie) me vlerësimin përmbledhës (i të nxënies).

Llojet e vlerësimit të brendshëm

Korniza e Kurrikulës, përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm, të cilat janë të vlefshme për realizimin e KB:

- Vlerësimi i vazhdueshëm
- Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësimi për shkallë

Vlerësimi i vazhdueshëm përfshin:

1. Vlerësimin formativ (vlerësimi për të nxënë)
2. Vlerësimin përmbledhës (vlerësimi i të nxënit)
 1. Vlerësimi formativ (vlerësimi për të nxënë), kryhet në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e informacioneve të arritjeve të nxënësve gjatë çdo veprimtarie mësimore, me qëllim të përkrahjes së nxënësve.

1.1 . Vlerësimi diagnostikues - përdoret për marrjen e informacioneve të arritjes së nxënësit për shkallën e përvetësimit të njohurive, shkathtësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave, dhe i ndihmon mësimdhënësit në punën e mëtejme.

1.2 . Vlerësimi motivues - përdoret për nxitjen e interesimit dhe dëshirës së nxënësit/ës për të nxënë.

1.3. Përmes vlerësimit formativ (vlerësimi për të nxënë), mësimdhënësi/ja vlerëson, mbikëqyrë përparimin e nxënësit/ës gjatë procesit të të nxënit, mbledhë informacione për marrjen e vendimeve për të ofruar mbështetje të nevojshme për të nxënit e nxënësit/ës.

2. Ndërsa, me ndihmën e vlerësimit përmbledhës (vlerësimi i të nxënit), mësimdhënësi/vlerësuesi përcakton arritjet e nxënësit në përfundim të një detyre të caktuar, teme mësimore, kapitulli, periudhe mësimore, etj., për të vendosur notat dhe për të vlerësuar nxënësin/ën për nxënie të mëtejshme. Vlerësimi përmbledhës përdoret edhe për të gjykuar efektivitetin e të nxënit ose të programit mësimor. Në këtë kontekst p,sh., në lëndën e gjeografisë, në fund të çdo dymujori (periudhë të cilën e përcakton mësimdhënësi; një mujore, dymujore, tremujore), mund të organizohen procedura të vlerësimit për pjesë të ndryshme të lëndës, për të parë sa kanë nxënë nxënësit, ose sa i kanë zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e ndryshme në lëndën e gjeografisë.

3. Vlerësimi përmbledhës bëhet me notë, duke përdorur metoda dhe instrumente të ndryshme vlerësimi si: përgjigjet me gojë, me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, vetëvlerësimi, teste, etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënit. Mësimdhënësi/ja është i/e pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësit/ës, prindërve dhe komunitetit.

Vlerësimi përfundimtar:

1 Përfshin vlerësimin në fund të çdo periudhe mësimore të përcaktuar me kalendarin shkollor, sipas MASHT-it (përfundimi i tremujorit të I-rë, II-të dhe III-të). Vlerësim përfundimtar nënkupton përmbledhjen e vlerësimeve përmbledhëse brenda një tremujori.

2 Vlerësim përfundimtar, quhet edhe vlerësimi i cili realizohet në fund të vitit shkollor, që nënkupton përmbledhjen e tre tremujorëve të paraparë me kalendarin shkollor, i miratuar nga MASHT-i.

3 Vlerësimi për shkallë – realizohet në fund të shkallës kurrikulare. Mësimdhënësit/et e shkencave natyrore – Gjeografisë 12-të, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumente të vlerësimit, ku secili instrument

vlerësues të ketë një standard, të jetë i specifikuar bazuar në kritere, i hartuar nga vetë mësimitdhënësit (aktivit profesional, aktiviteti i mësimitdhënëseve), në harmoni me planin vlerësues të shkollës brenda kornizave të planit vlerësues në nivel të DKA-ve dhe UA-së i miratuar nga MASHT-i.

Gjykuar, se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimitdhënësi/ja vazhdimisht duhet të kërkojë mundësi për zhvillim profesional, hulumtim, rishikim të kritereve të përdorura gjatë vlerësimit, të rizgjedhë instrumente të vlerësimit, e mbi të gjitha të ketë gatishmëri të llogaridhënies para secilit grupi të interesit.

Mësimitdhënësi/ja harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësit/ës, i cili duhet të miratohet nga të gjitha grupet e interesit (aktiviteti profesional, drejtorit e shkollës, nxënësi/ja dhe prindërit), të jetë transparent dhe t'u shpërndalet të gjitha palëve të interesuara.

Për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ka një sërë teknikash:

- Vlerësimi me shkrim;
- Vlerësimi me gojë;
- Vlerësimi me anë të dëgjimit;
- Vlerësimi praktik;
- Vlerësimi me anë të pyetësorëve;
- Vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore dhe i punëve në terren.

Testimi - është ecuria e matjeve sipas një qëllimi të caktuar.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të testeve, si:

- Testet me përgjigje alternative;
- Testet me kombinime;
- Testet me alternativa të shumta;
- Testet me përgjigje të shkurtra dhe me plotësim.

Vlerësimi duhet të jetë:

- I vlefshëm
- I besueshëm
- I paanshëm.

Udhëzime për dhe burimet e mjetet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimitdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shkencat natyrore” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimitdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, modele, makete, diagrame, mjete grafike, filma mësimore, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj; Materiale tekstuale:

teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;

Ndërsa mësimdhënsi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues. Ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënës. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muzeume, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizive, etj.. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet Web për gjeografinë.
- Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm software.
- Përdorimi i simulimeve software.
- Përdorimi i grafikëve software.
- Paraqitja grafike e të dhënave.

FUSHA KURRIKULARE: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Edukatë qytetare (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Histori (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Psikologji (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Filozofi dhe Logjikë (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Sociologji (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Edukatë qytetare (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda mësimore Edukata Qytetare në klasën e 12-të në drejtimin shoqëror-gjuhësor nxënësit i ofron njohuri të thelluara për grupet, faktorët, raportet shoqërore dhe mënyrat e veprimit të cilat janë në harmoni me rregullat dhe sjelljet e qytetëruara. Ajo i mundëson atij që të zhvillojnë qëndrimet personale dhe grupe gjatë debateve dhe aktiviteteve tjera interaktive. Temat të cilat trajtohen në këtë klasë kanë të bëjnë me grupet formale dhe joformale, ndikimin e tyre në shoqëri, politikën dhe diplomacinë, raportin e individit me shoqërinë, përfshirjen dhe integrimin në proceset lokale, ndërkombëtare dhe globale, konfliktin dhe kohezionin social, aktet ndërkombëtare për të drejta e njeriut, organet e drejtësisë, zgjedhjet e lira, të drejta, sistemet zgjedhore dhe me karakteristikat e mjedisit, proceset shoqërore dhe ndërveprimin

Qëllimi

Përmes programit të lëndës Edukatë Qytetare synohet përgatitja e nxënësit për pjesëmarrje aktive në strukturat dhe organizimet e ndryshme shoqërore. Gjithashtu synohet që nxënësi të aftësohet që të jetë në gjendje të marre vendimi përmes rrugëve të tilla, si: rritja e vetëdijes, pjesëmarrja aktive, grupet e interesit dhe menaxhimi i problemeve, dhe të marr përsipër përgjegjësinë për vendimet dhe zgjedhjet e tyre, duke vlerësuar edhe ndikimin që kanë për vete dhe për të tjerët.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
1. Individit, grupet dhe marrëdhënit shoqërore	RNF: 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to 1. Analizon strukturën dhe funksionimin e grupeve shoqërore, dikur dhe tani, dhe nxjerr përfundime për mënyrat e angazhimit në mënyrë konkrete në dobi të interesave të bashkësisë dhe shoqërisë. 2. Merr iniciativë në organizime rinore në shkollë dhe jashtë saj për të zhvilluar proceset demokratike dhe i adreson çështjet me interes përmes veprimeve konkrete.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Grupet formale dhe joformale,	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">▪ Analizon strukturën e grupeve formale (shkollat, sindikatat, partitë politike, Organizatat qytetare, Grupet e

	<p>ndikimi i tyre në shoqëri</p>	<p>Asocimit të Lagjes, Grupet e Arsimit, Grupet e Prindërve, Grupet Politike dhe Fetare etj.) dhe joformale (grupi i shahistëve, simpatizantët, grupet e rrjeteve sociale, lagjet, miqësitë, grupet e hobi, grupet e përdoruesve të kompjuterëve etj.), duke klasifikuar karakteristikat kryesore e tyre, bazuar në burime dhe shembuj të ndryshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon ndikimin e grupeve formale dhe jo formale në fushën e mirëqenien sociale (asistenca sociale, mbështetja e kategorive me nevojë, grupeve të marginalizuara, etj), kulturës, mjedisit, etj. ▪ Angazhohet dhe kontribuon në zhvillimin e debateve interaktive në kuadër të grupeve formale (Këshilli Drejtues i shkollës, Këshilli i mësimeve, Këshilli i klasave, Organizata e rinisë shkollore etj.) dhe joformale (vullnetarët e shkollës, debatuesit, garuesit, etj.) brenda shkolle, për tema të ndryshme me interesë për vetën, shkollën, komunitetin dhe vendin në përgjithësi duke paraqitur argumente të bazuara në fakte dhe shembuj konkret
	<p>Politika dhe diplomacia</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon mundësinë e ndikimit në politikë në nivelin lokal, qendror dhe ndërkombëtar përmes pjesëmarrjes aktive në grupet formale dhe jo formale ▪ Veçon rëndësinë e politikës në funksion të zgjidhjes së problemeve të komunitetit, duke u bazuar në shembuj konkret dhe qëndrime personale (ndërtimi dhe rregullimi i rrugëve, parqeve, qendrave rekreative, shëndetësore, sociale, etj) ▪ Konstaton rolin e politikës në harmonizimin e interesave publike me ato individuale, duke garantuar jetë dinjitoze për secilin pa diskriminim (barazia në shkollim, punësim, para ligjit, dhe shërbime të tjera) ▪ Argumenton mendimet dhe qëndrimet e veta për politikën dhe demokracinë duke bazuar në shembuj dhe përvoja konkrete të jetës së përditshme personale dhe publike. ▪ Identifikon disa lloje të diplomacisë (p.sh. shtetërore, kulturore humanitare, ekonomike, etj.) dhe shpjegon funksionin dhe rëndësinë e tyre.

	Raporti i individit me shoqërinë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Konstaton të drejtat e individit në raport me shoqërinë dhe shtetin ku ata qytetarë kanë të drejta të barabarta dhe marrëdhënia e tyre me shtetin bazohet në kontratë dhe konsensus (shtetësia, mirëqenia, sigurimi i pronës dhe të drejtave të qytetarit janë disa obligime të shtetit). ▪ Vlerëson funksionet e strukturave funksionale që mbrojnë dhe kufizojnë liritë individuale si dhe kufijtë e interferimit të komunitetit në të drejtat individuale.
2.Proceset shoqërore	RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre 1. Vlerëson dhe ndërlihdh efektet e proceseve shoqërore, historike e mjedisore në jetën e individëve dhe të shoqërisë. 2. Merr pjesë aktivisht (planifikim, organizim, udhëheqje, menaxhim etj.) në aktivitete hulumtuese duke përdorur lloje të ndryshme të informacioneve për ngjarjet dhe dukuritë shoqërore, historike dhe sjell të dhëna të mbështetura në fakte, duke iu shmangur paragjykimeve dhe opinioneve subjektive.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Përfshirja dhe integrimi në proceset lokale, ndërkombëtare dhe globale	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përpunon në mënyrë kritike informatat e mbledhura nga burime të ndryshme për integrimin si proces,(të individëve, grupeve, shteteve organizatave etj.) dhe llojet e tij (kulturor, social, arsimor, ekonomik, politik, ushtarak etj.) ▪ Vlerëson ndikimin e integritimeve në jetën e individëve në aspektin kulturor, historik, shoqëror ekonomik, arsimor, politik bazuar në nivel lokal, ndërkombëtar dhe global. ▪ Veçon disa karakteristikat të integritimit duke u bazuar në skemën e punuar nga vet nxënësi; ▪ Përmbledh dhe interpreton pjesë nga materiali i hulumtuar për procesin e globalizimit dhe llojet e tij duke dhënë shpjegime në aspektin kronologjik.
	Konflikti dhe kohezionit social	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Bën diferencimin e normave të ndryshme shoqërore ▪ Veçon një konstatim të raportit të normave etike, religjioze dhe juridike ▪ Shpjegon bindjen qytetarit ndaj shtetit dhe obligimin e shtetit ndaj qytetarit. ▪ Veçon sanksionin si element themelor i kohezionit social (Njerëzit në grupet kohezive ballafaqohen me presione të fuqishme për t'iu përshtatur qëllimeve, normave dhe vendimeve të grupit.)

3.Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë	RNF: 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet 1. Vlerëson përpjekjet për liritë dhe të drejtat e njeriut, në kontekste dhe periudha të ndryshme kohore dhe angazhohet për respektimin e larushisë shoqërore. 2. Prezanton fakte dhe opinione, sqaron prejardhjen e tyre dhe përmes tyre nxjerr përfundime dhe shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e veta për çështje dhe dukuri të ndryshme shoqërore, historike, kulturore.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
4.Vendimarrja dhe institucionet	RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme 1. Veçon mënyrat e vendimmarrjes në periudha dhe në kontekste të ndryshme shoqërore e historike dhe nxjerr përfundime për rëndësinë e vendimmarrjes së drejt. 2. Vlerëson ndikimin e zhvillimit ekonomik, shkencor dhe teknologjik në shoqëri në përgjithësi si dhe në vendimmarrje.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Organet e drejtësisë	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerëson evoluimin e sistemit gjyqësor nga e kaluara deri më tani bazuar në të dhënat e grumbulluara për historinë e gjyqësorit si dhe mënyrat e vendimmarrjes (në bazë të

		<p>normave fisnore, tradicionale-morale, fetare, juridike) në periudha dhe në kontekste të ndryshme shoqërore.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kategorizon pjesët e strukturës së gjyqësorit në bazë të funksionit që kryejnë organet e gjyqësisë. ▪ Veçon rolin e gjyqtarëve dhe gjyqësorit në bazë të dhënëve që posedon.
	Zgjedhjet e lira, të drejta dhe sistemet zgjedhore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krahason karakteristikat kryesore të zgjedhjeve të lira nga periudha të ndryshme (në antikë, mesjetë, pastaj organizimi i zgjedhjeve sipas shembujve të monarkisë absolute, zgjedhjet në demokracinë liberale, lindja e parlamentit si institucion politik etj.) në rrethanat e kohës. ▪ Kategorizon llojet e sistemeve zgjedhore (sistemi pluralist, i shumicës, proporcional, i përzier, zgjedhjet parësore dhe indirekte.) në aspektin kronologjik duke sqaruar përparësit dhe mangësitë e tyre. ▪ Analizon ndikim pozitiv dhe negativ të shkencës dhe teknologjisë që kanë pasur në shoqëri, veçanërisht në fushat e mëposhtme (jeta e komunitetit, puna, shërbimi komunikimi dhe vendimmarrja) procesin e zbatimit të procedurave për zgjedhjet e lira. ▪ Argumenton ndikimin e madh në shoqëri që kanë pasur shpikjet dhe risitë në komunikim (Egjipti: papirusi dhe hieroglifët Babilonia e lashtë: kuneiform-shkrimi në trajtë pyke, Greqia antike: folja publike, retorika bindëse, drama dhe filozofia, Roma e lashtë: Alfabeti romak, Evropa moderne: shtypi, Bota sot: World Wide Web) duke i renditur në aspektin kronologjik, duke kontribuar në avancimin dhe transparencën zgjedhjeve të lira.
5.Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.	
	1. Analizon karakteristikat shoqërore-ekonomike të mjedisit, proceset ekonomike, sociale, politike, kulturore dhe paraqet ndryshimet në shoqëri si rezultat i ndërveprimit në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
Karakteristikat e mjedisit, proceset shoqërore dhe	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon karakteristikat (shoqërore, ekonomike, kulturore etj.) e mjedisit duke u bazuar në një material prezantues të ilustruar atë me shembuj konkretë. ▪ Dizajnon një skemë me tri pjesët përbërëse (qëndrueshmëria mjedisore, ekonomike dhe shoqërore) të 	

	ndërveprimi	<p>zhvillimit të qëndrueshëm duke krahasuar mënyra të shfrytëzimit të shembujve pozitivë në kontekstin lokal apo global.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shqyrton ndikimin e aspekteve të ndryshimeve shoqërore (ekonomike, politike, religjioze, morale, kulturore, shkencor dhe teknologjik) në mjedisin jetësor duke krahasuar të dhëna e mbledhura, bazuar në shembuj dhe përvoja konkrete të jetës së përditshme.
--	--------------------	--

Udhëzime metodologjike

Përveç metodologjive si mësimin me nxënësin në qendër, gjithëpërfshirjen, mësimin e diferencuar, duke respektuar stilet e ndryshme të nxënies e tjera gjithashtu mësimdhënësit e edukatës qytetare klasa 12 në drejtimin shoqëror-gjuhësor kanë mundësi të përdorin metoda të ndryshme interaktive, ku përveç mundësive të përzgjedhjeve të pavarura që kanë ata gjithashtu mund t'i përdorin edhe këto metoda në vijim:

- **Diskutim individual dhe në grupe të vogla** mund të lidhet me shumicën e temave por në mënyrë të veçantë mund të përdoret te temat: Grupet formale dhe joformale, ndikimi i tyre në shoqëri si dhe Raporti i individit me shoqërinë.
- **Diskutim plenar. Punë individuale me shkrim** mund të përdoret te këto tema: Përfshirja dhe integrimi në proceset lokale, ndërkombëtare dhe globale si dhe Konflikti dhe kohezionit social.
- **Shkëmbim i analizës për dilemën morale** mund të përdoret te tema: Aktet ndërkombëtare për të drejta e njeriut-Konteksti shoqëror
- **Analizë e mbështetur nga mësimdhënësi** në mënyrë më të veçantë mund të përdoret te temat: Organet e drejtësisë dhe Zgjedhjet e lira, të drejta dhe sistemet zgjedhore.
- **Shkrimi (përpilimi) i tregimeve. Diskutim plenar,** mund të përdoren te të gjitha temat
- **Analiza kritike të strukturuar. Analiza në grupe të vogla dhe diskutim. Arritja e konsensusit dhe negocimi. Shënim personal,** mund të përdoren në mënyrë të veçante te tema: Raporti i individit me shoqërinë.
 - **Punë në grupe. Negocimi. Arsyetimi moral. Vlerësimi kritik. Punë kërkimore. Prezantim në grupe** këto mund të përdoren te tema: Karakteristikat e mjedisit, proceset shoqërore dhe ndërveprimi

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Çështjet e rëndësishme ndërkurrikulare në fushën shoqëria dhe mjedisi si dhe lëndën e edukatës qytetare në klasën 12 janë këto:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media, dhe
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare u ndihmon nxënësve në njohjen e procesëve që ndodhin në shoqëri:

- **Edukimi për qytetari demokratike** - është temë ndërkurrikulare e cila nga ana e mësimdhënësve kontribuon mbështetë të kompetencat për qytetari demokratike, dhe mund të ndërlidhet me temat që kanë qasje ndaj edukimit për demokraci dhe të drejtat e njeriut.
- **Edukimi për paqe** – kjo temë ndërkurrikulare mund të ndërlidhet me këto tema: Aktet ndërkombëtare për të drejta e njeriut-Konteksti shoqëror, Organet e drejtësisë, Zgjedhjet e lira, të drejta dhe sistemet zgjedhore, në aspektin e qëllimeve, mënyrën e funksionimit të proceseve etj.
- **Globalizimi dhe ndërvarësia** - mund të ndërlidhet me shumicën e temave të paraqitura më lartë por në mënyrë më të veçantë mund të ndërlidhet me temën Përfshirja dhe integrimi në proceset lokale, ndërkombëtare dhe globale.
- **Edukimi për media** – kjo temë ndërkurrikulare mund të ndërlidhet me temën Zgjedhjet e lira, të drejta dhe sistemet zgjedhore ku në veçanti rezultati i fundit i kësaj teme prek çështjet historike të zhvillimit të mediave.
- **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**- tema u fundit ndërkurrikulare ndërlidhe shumë me konceptin: Mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm, si dhe me temën e veçantë Karakteristikat e mjedisit, proceset shoqërore dhe ndërveprimi.

Udhëzimet për vlerësim

Në lëndën edukate qytetare klasa 12 vlerësimi është një proces, ku forma dhe veçanërisht mënyra në të cilën rezultatet raportohen, gjithmonë duhet të reflektojnë qëllimin e vlerësimit. Mësimdhënësi ka mundësi të përzgjedhë mënyra të vlerësimit të cilat ndërlidhen me rezultatet e lëndës, fushës dhe kompetencës për shkallë.

- Diskutim individual dhe në grupe të vogla mësimdhënësi bënë vlerësimin individual dhe grupor mund të bëhet aplikimi i vlerësimit përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve dhe mbajtja e evidencës.
- Diskutim plenar. Punë individuale me shkrim mësimdhënësi bënë vlerësimin individual të nxënësit (vlerësim me kriter) mund të bëhet vlerësimi me anë të esesë etj.
- Shkëmbim i analizës për dilemën morale mund të bëhet vlerësimi në bazë të aktiviteteve bazuar në kritere,

- Analizë e mbështetur nga mësimdhënësi mund të bëhet vëzhgimi i punës në grupe dhe nismave individuale mund të bëhet edhe përmes listës së kontrollit etj.
- Punë në grupe. Negocimi. Arsyetimi moral. Vlerësimi kritik. Punë kërkimore. Prezantim në grupe mund të bëhet vlerësimi përmes miniprojekteve etj., që tek nxënësit do të matnin shkathtësitë e bashkëpunimit e të hulumtimit.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Mësimdhënësit e edukatës qytetare për klasën e 12 mund të përdorin shumëllojshmëri të aktiviteteve mësimore, fletoret e punës, broshura, atlaset, globet, projekte, studime të ndryshme nga interneti, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës, vizita të ndryshme njohëse, si, p.sh. objekteve shoqërore, kulturore etj. Mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë dhe të krijojnë dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës, varësisht prej ndërlidhjes së temave dhe rezultateve të synuara.

Burimet mësimore

- <http://www.living-democracy.al/textbooks/volume-1/>
- http://www.pp.gov.al/ëeb/karta_e_okb_770.pdf
- <http://www.uis.unesco.org/Library/Documents/gmr-2013-14-teachingand-learning-education-for-all-2014-en.pdf>
- <http://www.education.gov.uk/publications/>
- [.assessment-reform-group.org.uk](http://www.education.gov.uk/assessment-reform-group.org.uk)
- www.education.gov.uk;
- http://www.masht.gov.net/advCms/documents/UA_standardet.pdf
- <http://www.mun.ca/sac/inquiry.html>
- <http://services.bglf.org/services/assess/a4learn.html>
- www.edchange.org/multicultural/papers/genderbias

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Histori (Gjimnazi i shkencave shoqërore –gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda e Historisë si pjesë e fushës Shoqëria dhe Mjedisi, luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësve. Përmes kësaj lënde nxënësit e klasës së dymbëdhjetë – Gjinnazi i shkencave shoqërore - gjuhësore, do të thellojnë njohuritë për zhvillimet shoqërore, ekonomike, kulturore, shkencore, politike etj., nga koha e formimit të shteteve të reja kombëtare (gjysma e dytë e shek. XIX) deri në fund të procesit të formimit të shteteve të reja në Evropë (2008). Përveç kësaj, duke studiuar të kaluarën në të gjitha dimensionet e saj, nxënësit vlerësojnë rolin e shkencës së historisë në vetëdijesimin e njeriut për të kaluarën e tij, për të kuptuar të sotmen dhe për të projektuar të ardhmen.

Qëllimi

Qëllimi i lëndës së Historisë në këtë klasë, përveç thellimit të njohurive të përgjithshme për këtë periudhë historike është dhe zhvillimi i të menduarit kreativ dhe kritik si dhe të argumentuarit dhe gjykuarit logjik përmes analizës krahasuese të veprimtarisë njerëzore të asaj periudhe, gjë që do të ndikojë në zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësit si një personalitet i qëndrueshëm dhe qytetar i përgjegjshëm, i cili do të respektojë identitetet dhe përkatësitë e ndryshme, si ato: gjinore, etnike, shoqërore, kulturore, të besimit, orientimit seksual etj.

Temat dhe rezultatet e të nxënësve

Nxënësit në klasën e dymbëdhjetë i arrijnë rezultatet e të nxënësve të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dalta nga rezultatet e të nxënësve të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, të shkallës së gjashtë (Shk 6) në Kurrikulën Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Lartë.

Koncepti	RNF, Temat dhe RNL
Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore	RNF: 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to 1. Analizon strukturën dhe funksionimin e grupeve shoqërore, dikur dhe tani, dhe nxjerr përfundime për mënyrat e angazhimit në mënyrë konkrete në dobi të interesave të bashkësisë dhe shoqërisë. 2. Merr iniciativë në organizime rinore në shkollë dhe jashtë saj për të zhvilluar proceset demokratike dhe i adreson çështjet me interes përmes veprimeve konkrete.

	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Roli i personaliteteve të shquara të Historisë Moderne dhe Bashkëkohore	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Debaton mbi veprimtarinë e personaliteteve të shquara dhe vlerëson kontributin në fushëveprimin e tyre. ▪ Identifikon grupet e reja shoqërore dhe analizon format e organizimit dhe veprimit shoqëror e politik të tyre.
Proceset shoqërore dhe natyrore	RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre	
	<p>1. Vlerëson dhe ndërlidh efektet e proceseve shoqërore, historike e mjedisore në jetën e individëve dhe të shoqërisë.</p> <p>2. Merr pjesë aktivisht (planifikim, organizim, udhëheqje, menaxhim etj.) në aktivitete hulumtuese duke përdorur lloje të ndryshme të informacioneve për ngjarjet dhe dukuritë shoqërore, historike dhe sjell të dhëna të mbështetura në fakte, duke iu shmangur paragjykimëve dhe opinionëve subjektive.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Nacionalizmi - formimi i shteteve kombëtare	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Evidencon faktorët ideologjikë me ndikim në lindjen e nacionalizmit dhe analizon rrethanat e politizimit të tij. ▪ Analizon kontekstin historik të formimit të shteteve të mëdha kombëtare dhe vlerëson rolin e tyre në rrjedhat ndërkombëtare. ▪ Identifikon lëvizjen revolucionare të viteve '40 të shek. XIX në Evropë dhe përkufizon grupet shoqërore bartëse dhe mbështetëse të tyre.
	Epoka e shpikjeve dhe teorive të reja shkencore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Evidencon arritjet e reja në shkencë dhe vlerëson ndikimin e tyre në shoqëri. ▪ Identifikon teoritë dhe shpikjet e reja teknike-teknologjike dhe vlerëson ndikimin e tyre në shoqërinë njerëzore dhe në mjedis. ▪ Hulumton për jetën e përditshme të shoqërisë evropiane dhe veçon dukuritë e reja në organizimet qytetare
Lëvizja Kombëtare	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shqyrton reformat centralizuese osmane dhe 	

	<p>Shqiptare</p>	<p>analizon pozitën specifike të shqiptarëve dhe reagimin e tyre në këtë kontekst.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Argumenton rolin e rilindësve dhe veprimtarëve kombëtarë shqiptarë në emancipimin kombëtar dhe politik të shqiptarëve. ▪ Analizon kontekstin historik të themelimit të organizatave politiko-ushtarake shqiptare (1878-1912) dhe evidencon programin dhe veprimtarinë e tyre. ▪ Shpjegon ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare dhe analizon qëndrimin e Fuqive të Mëdha ndaj saj. ▪ Përshkruan zhvillimet kulturore-arsimore tek shqiptarët dhe analizon politikat e Portës së Lartë ndaj këtyre zhvillimeve. ▪ Evidencon angazhimin e shqiptarëve në proceset politike osmane dhe analizon rolin e lëvizjes xhonturke në promovimin e pluralizmit politik. ▪ Analizon kontekstin historik të Kuvendit të Vlorës dhe vlerëson vendimin e tij për shpalljen e Shqipërisë së pavarur.
	<p>Shqiptarët në periudhën e kompozimit të ri politik të Ballkanit 1912-1914</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon veprimtarinë e organeve shtetërore të dala nga Kuvendi i Vlorës dhe definojnë pozitën specifike të shqiptarëve në konfrontimin ballkanik 1912-1913. ▪ Vlerëson rolin e Fuqive të Mëdha evropiane në përcaktimin e fizionomisë të shtetit shqiptar (statusi, kufijtë, rregullimi i brendshëm) dhe analizon procesin e jetësimit dhe ngritjes së tij. ▪ Përshkruan procesin e pushtimit dhe aneksimit të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nga shtetet fqinjë dhe ilustron politikat e tyre ndaj shqiptarëve. ▪ Shqyrton rezistencën dhe kundërshtimin e

		<p>shqiptarëve kundër pushtimit nga shtetet fqinje dhe vendimeve lidhur me kufijtë e Shqipërisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shqyrton shkaqet e brendshme të krizës shtetërore dhe evidencon rolin e faktorit të jashtëm në këtë mes.
	Evropa Juglindore midis Perandorisë Osmane dhe Austro-Hungareze	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krahason synimet dhe politikat austro-hungareze dhe ruse ndaj Ballkanit dhe evidencon marrëveshjet e tyre lidhur me këtë çështje. ▪ Shpjegon pozitën e shteteve autonome ballkanike në kuadër të Perandorisë Osmane dhe kontekstin historik të pavarësimit të tyre.
	Periudha e imperializmit: Ndarja e sferave të interesit-kolonializmi	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon synimet imperialiste të Fuqive të Mëdha dhe përshkruan ndarjen e sferave të interesit. ▪ Përkufizon aleancat e reja evropiane dhe evidencon krizat si pasojë e kundërshtimeve mes tyre.
	Lufta e Parë Botërore, Sistemi i Versajës dhe zhbërja e tij.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon faktorët e përshkallëzimit të krizës, rreshtimin e shteteve në blloqet ndërluftuese dhe identifikon frontet kryesore të Luftës së Parë Botërore. ▪ Përshkruan organizimin e Konferencës së Paqes, vendimet kryesore të saj (Sistemi i Versajës) dhe analizon rolin e Lidhjes së Kombeve. ▪ Analizon rrethanat e instalimit dhe fuqizimit të pushteteve totalitare si dhe krahason veçantit mes tyre. ▪ Analizon zhvillimet kryesore politike, ekonomike dhe shoqërore në vendet demokratike perëndimore. ▪ Analizon zhvillimet në rrafshin ekonomik, shoqëror, kulturor, artistik dhe shkencor 1919-1939 dhe analizon aspekte të jetës së përditshme të kategorive të ndryshme shoqërore.

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Evidencon faktorët që ndikuan në zhbërjen e Sistemit të Versajës dhe analizon shkaqet e dështimit të përpjekjeve të demokracive perëndimore për ruajtjen e paqes.
	Shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikon zonat pushtuese në Kosovë dhe Shqipëri, dhe krahason politikat e zbatuara nga regjimet pushtuese. ▪ Analizon angazhimin politik të shqiptarëve gjatë Luftës së Parë Botërore dhe argumenton synimet e tyre kombëtare.
	Shqiptarët ndërmjet dy Luftërave Botërore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon programin politik të shqiptarëve, kërkesat drejtuar Konferenca e Paqes së Parisit dhe përshkruan pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë 1920-1921. ▪ Analizon zhvillimet politike në Shqipëri dhe vlerëson përpjekjet për demokraci 1921-1924. ▪ Dallon veçoritë në zhvillimet politike, kulturore, arsimore, ekonomike, shoqërore në Shqipëri dhe Kosovë dhe krahason rezultatet në këto fusha në fund të kësaj periudhe historike. ▪ Shqyrton pozitën e shqiptarëve në Mbretërinë SKS-Jugosllavi dhe identifikon format e rezistencës, organizimit dhe veprimet politike për realizimin e të drejtave të tyre qytetare dhe kombëtare.
	Lufta e Dytë Botërore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përshkruan shkaqet e Luftës së Dytë Botërore, evidencon fazat e saj dhe frontet kryesore. ▪ Analizon aspekte të jetës së përditshme të qytetarëve dhe ushtareve gjatë Luftës së Dytë Botërore. ▪ Evidencon dhe përshkruan aspektet kryesore të Holokaustit dhe vlerëson efektet e dënimeve të krimeve të luftës. ▪ Evidencon zhvillimet diplomatike gjatë LDB dhe analizon vendimet për rendin e ri botëror

	<p>Bota gjatë Luftës së Ftohtë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon shkaqet e fillimit të Luftës së Ftohtë dhe krizat lokale në botë. ▪ Analizon zhvillime kryesore politike, ekonomike e shoqërore ne vendet demokratike të perëndimit dhe ato komuniste të lindjes. ▪ Krahason aspektet e jetës së përditshme të shoqërisë në vendet e bllokut komunist dhe vendet perëndimore.
	<p>Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krahason politikat italiane dhe gjermane ndaj Shqipërisë gjatë periudhës së pushtimit të saj 1939-1944. ▪ Përshkruan përfshirjen e Kosovës në Luftën e Dytë Botërore, zonat e pushtimit dhe pozitën e shqiptarëve dhe komuniteteve tjera në to. ▪ Analizon programet dhe rolin e formacioneve politiko-ushtarake shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore. ▪ Evidencon raportet në mes të komuniteteve etnike në kushtet e LDB dhe vlerëson rolin e shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Holokaustit. ▪ Analizon kontekstin historik të vendosjes së sistemit komunist në Shqipëri dhe evidencon fazat e fuqizimit të tij. ▪ Përshkruan transformimet shoqërore dhe jetën e përditshme të qytetarit të zakonshëm në sistemin komunist dhe evidencon rolin dhe ecuritë e arsimit, shkencës dhe kulturës në këtë sistem.
	<p>Evropa Juglindore gjatë periudhës komuniste</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon rrethanat e përfshirjes dhe pozitën e shteteve ballkanike në Bllokun Lindor si dhe shpjegon arsyet e largimit të Jugosllavisë nga ky Bllok. ▪ Debaton për shkaqet e rënies së sistemit komunist në Ballkan dhe në veçanti për shpërbërjen e Jugosllavisë.

	<p>Kosova në kuadër të Jugosllavisë Federale, përpjekjet për pavarësi-lindja e një shteti të ri evropian</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përshkruan pozitën e Kosovës në kuadër të Jugosllavisë dhe analizon format e organizimit dhe veprimit të shqiptarëve për të drejtat njerëzore dhe kombëtare të tyre. ▪ Analizon evoluimin e pozitës kushtetuese të Kosovës si dhe vlerëson zhvillimet pozitive në rrafshin shoqëror, kulturor, arsimor dhe ekonomik 1966-1974. ▪ Evidencon masat e regjimit jugosllav-serb në sferën politike, kushtetuese, arsimore, shëndetësore dhe ekonomik ndaj Kosovës 1989-1999. ▪ Përshkruan periudhën e Rezistencës Paqësore dhe Luftës Çlirimtare si dhe vlerëson rolin e tyre për çështjen e Kosovës. ▪ Vlerëson kontributin e Diasporës shqiptare në aspektin ekonomike dhe politik për çlirimin dhe shtet ndërtimin e Kosovës. ▪ Analizon rolin e faktorit ndërkombëtar për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe vlerëson Shpalljen e Pavarësisë dhe konsolidimin e shtet ndërtimit të Kosovës.
	<p>Rënja e rendit bipolar në botë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Evidencon lëvizjet politike dhe shoqërore (disidenca) në shtetet komuniste, rolin e tyre në rënien e komunizmit. ▪ Analizon rolin e fuqive të mëdha demokratike në rënien e komunizmit dhe evidencon efektet globale të rënies së botës bipolare. ▪ Përshkruan jetën e përditshme të njerëzve gjatë procesit të tranzicionit shoqëror, ekonomik e kulturor në ish shtetet komuniste.
<p>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë</p>	<p>RNF: 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</p> <p>1. Vlerëson përpjekjet për liritë dhe të drejtat e njeriut, në kontekste dhe periudha të ndryshme kohore dhe angazhohet për respektimin e larushisë shoqërore.</p>	

	<p>2. Prezanton fakte dhe opinione, sqaron prejardhjen e tyre dhe përmes tyre nxjerr përfundime dhe shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e veta për çështje dhe dukuri të ndryshme shoqërore, historike, kulturore.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Integrimet evropiane	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkufizon parakushtet dhe procesin e integrimi evropiane dhe analizon mënyrën e funksionimit të organeve vendimmarrëse të Bashkimit Evropian. ▪ Përkufizon të drejtën, obligimet dhe fazat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe krahason stadin e integritit të Kosovës, Shqipërisë dhe vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor.
	Siguria kolektive (OKB, Këshilli i Evropës, KSBE/OSBE)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikon mekanizmat e sigurisë dhe bashkëpunimit Evropian dhe Botëror si dhe fushëveprimin dhe funksionimin e tyre. ▪ Shpjegon funksionimin e OKB-së dhe rolit të saj në mbrojtjen e paqes botërore. ▪ Argumenton dhe vlerëson rolin dhe rëndësinë e NATO-s në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në botë.
Vendimmarrja dhe institucionet	<p>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</p> <p>1. Veçon mënyrat e vendimmarrjes në periudha dhe në kontekste të ndryshme shoqërore e historike dhe nxjerr përfundime për rëndësinë e vendimmarrjes së drejt.</p> <p>2. Vlerëson ndikimin e zhvillimit ekonomik, shkencor dhe teknologjik në shoqëri në përgjithësi si dhe në vendimmarrje.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Ideologjitë dhe shtetet totalitare (komunizmi, nacizmi, fashizmi)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shpjegon kontekstin historik të marrjes së pushtetit nga bolshevikët-komunistët në Rusi dhe analizon shtrirjen e ndikimit të ideologjisë komuniste në Ballkan dhe në botë. ▪ Analizon shkaqet të cilat mundësuan marrjen e

		<p>pushtetit nga forcat fashiste (Itali) dhe naziste (Gjermani) dhe hulumton shembuj të oponencës politike ndaj tyre ndërmjet dy Luftërave Botërore.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shqyrton ndikimin ideologjik në Luftën Qytetare spanjolle dhe identifikon interferencën e jashtme (në këtë luftë) mbi baza ideologjike.
	Vendimmarrja në shtetet demokratike	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon procesin zgjedhor në shtetet demokratike dhe specifikon rolin e organeve politike shtetërore (parlamenti, qeveria, presidenti). ▪ Krahason rolin e presidentit në sistemin presidencial (p.sh. ShBA) me ato në sistemin parlamentardhe arsyeton përse në disa shtete demokratike ka mbijetuar institucioni i mbretit- mbretërisë (p.sh. në Britani të Madhe etj.).
Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm	RNF: 5 . Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm	
	1. Analizon karakteristikat shoqërore-ekonomike të mjedisit, proceset ekonomike, sociale, politike, kulturore dhe paraqet ndryshimet në shoqëri si rezultat i ndërveprimit në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Globalizimi dhe sfidat e tij	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkufizon globalizimin dhe argumenton rolin e tij në jetën e përditshme të njeriut. ▪ Vlerëson te arriturat shkencore teknike-teknologjike dhe identifikon rrjedhojat pozitive dhe negative të tyre për Tokën dhe njerëzimin. ▪ Dallon sfidat globale (ekstremizmi, terrorizmi, ngrohja globale, emigracioni, uniformizmi, etj.) ▪ Argumenton rolin e njeriut në shfrytëzimin racional të resurseve natyrore për një zhvillim të qëndrueshëm dhe shpjegon për përgjegjësitë e shteteve dhe organizatave ndërkombëtare për ruajtjen e mjedisit.

Udhëzime metodologjike

Për të arritur suksesin e dëshiruar tek nxënësi, kërkohet përgatitje dhe planifikim i kujdesshëm paraprak nga mësuesi. Mësuesi duhet që gjatë planifikimit të ndjek parimet, qëllimet dhe filozofinë e kurrikulës dhe të përcaktoj metodat, strategjitë, teknikat dhe qasjen ndërvepruese – gjithëpërfshirëse në harmoni me rezultatet dhe temat e përcaktuara në program.

Lënda e historisë ka rol të rëndësishëm në zhvillimin e shkathtësive për hulumtim, analizë e interpretim, për këtë arsye mësuesi gjatë procesit të mësimit duhet të kushtoj rëndësi aktiviteteve të cilat kërkojnë pjesëmarrje aktive të nxënësit. Në këtë mënyrë tek nxënësi nxitet kureshtja për hulumtim, të menduarit kritik kreativ e i pavarur. Kjo mund të arrihet duke nxitur dhe përdorur punën me projekte, mësimin në bashkëpunim, mësimin me ndërveprim si dhe përdorimin e TIK-ut për hulumtimin e ngjarjeve, fakteve dhe temave të ndryshme.

Pasi që për tema, ngjarje e çështje të ndryshme historike ka pikëvështrime e interpretime të ndryshme është me shumë interes që mësuesi gjatë orëve mësimore të përdorë burime e materiale të ndryshme. Në këtë mënyrë sigurohet shkathtësia e krahasimit, analizë, argumentimit të nxënësit. Nxënësi duke u ballafaquar vet me argumente të ndryshme, do të nxjerrë përfundimet e tija për ngjarjet historike. Kjo do të zhvilloj gjykimin e tij të pavarur dhe aftësinë për vendimmarrje të bazuar në argumente.

Mësuesi gjithmonë duhet të ketë parasysh stilet e ndryshme të nxënies dhe për këtë sugjerohet që gjatë orëve mësimore të bëjë gërshetimin e formave, metodave e teknikave të punës. Gjithashtu, mësuesi duhet të kujdeset edhe për qasjen e mësimit të diferencuar, në bazë të potencialit të nxënësit.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Mësuesi duhet të kujdeset edhe për trajtimin e çështjeve/ temave ndërkurrikulare. Integrimi i këtyre temave me rezultate/temat e lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë më mirë ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe mjedisi, ndërvarësinë e tyre dhe në këtë mënyrë të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Me programin e lëndës së historisë për këtë moshë të nxënësve mund të integrohen të gjitha çështjet/temat ndër kurrikulare:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media, dhe
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Këto tema mund dhe duhet të ndërlidhen dhe të trajtohen gjatë shtjellimit të temave të parapara me program. Për shembull kur trajtohet tema Transformimi i vendimmarrjes gjatë Mesjetës dhe Kohës Moderne mund të ndërlidhet shumë mirë me çështjen/temën Edukimin për qytetari demokratike, ku pjesëmarrja në vendimmarrje mund të shpjegohet në konteste dhe periudha të ndryshme, si ka ndodhë evoluimi i tyre etj. E njëjta qasje vlen edhe në trajtimin e temave/çështjeve tjera si për shembull Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, që mund të ndërlidhet shumë mirë me rezultate e temës Avancimet shkencore e teknike dhe ndikimi i tyre në cilësinë e jetës dhe mjedisit. Por, edhe për realizimin me sukses të çështjeve/temave ndërkurrikulare kërkohet një përgatitje dhe planifikim paraprak i mësimdhënësit. Mësimdhënësi duhet që të identifikoj rezultate dhe temat e programit që kanë lidhmëni me çështjet/temat ndërkurrikulare dhe të planifikoj aktivitetet, detyra dhe rezultatet që donë t'i arrij me nxënësin.

Udhëzimet për vlerësim

Vlerësimi si një nderë çështjet më komplekse është i lidhur ngushtë me procesin e mësimin. Kështu që krahas planifikimit për metodologjinë e mësimdhënies kërkohet që edhe vlerësimi të jetë pjesë e planifikimit paraprak. Mësimdhënësi duhet të harmonizojë vlerësimin me atë që ka planifikuar, synuar, ta arrijë tek nxënësi. Pra duhet vlerësuar atë që e kemi vënë në objektin e vlerësimit, njohuritë, shkathtësitë, sjelljet, qëndrimet e nxënësve. Për vlerësimin e nxënësit në këtë moshë mund të përdoren forma dhe instrumente të ndryshme, përveç llojeve të ndryshme të testimit, si ai verbal, jo verbal, vlerësimi i nxënësit në punë grupore, i punës me projekte etj., mund dhe duhet të bëhen edhe vëzhgime të përvetësimit të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve, dhe shkallës së rritjes së shkathtësive dhe aftësive për të zbatuar rezultatet e parapara në Kurrikulën Bërthamë për nivel dhe rezultate e lëndës për këtë klasë.

Për të gjitha llojet e vlerësimeve që duhet t'i bëhen nxënësit pikë referimi janë rezultatet e lëndës, të fushës në nivel klase si dhe ato për kompetenca në nivel shkalle. Mësimdhënësi, varësisht nga specifikat e tyre, hulumton gjetjen e formave më të përshtatshme për vlerësimin e arritjeve të tyre.

Qasja kurrikulës së re me kompetenca, synon vlerësimin e asaj se çka është në gjendje të bëjë nxënësi, pra vlerësimi i zbatimit praktik të njohurive të marra gjatë shkollimit. Kështu, aplikimi i vlerësimit përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve dhe mbajtja e evidencës për qëllime dokumentimi dhe planifikimi të punës së mëtuqeshme me nxënësin është e domosdoshme. Pjesë e vlerësimit duhet të jenë edhe shkathtësitë, sa nxënësi është në gjendje të bashkëpunojë me të tjerët, sa ai përdor shkathtësitë në hulumtim dhe prezantim të argumentuar etj. Vlerësimi gjithmonë duhet të ketë karakter motivues në mënyrë që nxënësi të edukohet të pranojë vlerësimin real dhe të synojnë arritje sa më të larta.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Tekstet shkollore bazë janë vetëm njëri nga burimet për mësimin e lëndës. Por, lënda e historisë kërkon përdorimin edhe të burimeve tjera. Mësimdhënësi dhe nxënësi janë të lirë dhe inkurajohen që të përdorin burime e materiale të ndryshme që do t'i kontribuojnë arritjes së rezultateve të parapara në program. Tekstet alternative, atlaset, enciklopeditë, revistat, gazetat, literatura të specializuar apo doracakë të ndryshëm, harta, materiale të ndryshme të shkarkuara nga interneti, fotografi, artefakte, sekuenca nga filma të ndryshëm artistik dhe dokumentar, këngë etj. mund dhe duhet të përdoren si burime për lëndën e historisë. Rekomandohet që përzgjedhja e tyre të jetë e përshtatshme për moshën e nxënësit dhe t'i kontribuojë rezultateve të nxënësve. Gjatë përzgjedhjes së burimeve preferohet të ketë qasje multiperspektive, me qëllim që nxënësi të njoh këndvështrime të ndryshme dhe përmes tyre të zhvillojë vetëdijen dhe edukimin historik. Ai duhet të kuptojnë kompleksitetin e historisë, shkaktarët e ndryshëm të ngjarjeve historike, si dhe interpretimin e tyre duke nxitur pyetje shtesë për burimet dhe gjetjet tjera të së vërtetës historike. Qasja multiperspektive do ta aftësojë nxënësin të marrë në konsideratë perspektiva të ndryshme historike, që do t'i ndihmojnë për t'i kuptuar rrethanat e ndërlikuara të së kaluarës. Vetëdija dhe edukimi historik duhet të jetë bazë e mendimit historik, që shprehet me shkathësinë e hulumtimit vetanak, aftësimin e kontestimit të burimeve duke mbrojtur dhe argumentuar pikëpamjet e veta.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Psikologji (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Psikologjia, që nga lindja e saj si shkencë dhe profesion, ka ndihmuar, që jeta dhe mirëqenia e njerëzve të jenë më të mira. Probleme aktuale të rëndësishme të shoqërisë po ashtu lidhen me psikologjinë dhe kjo shkencë po shfaq gjithnjë e më tepër potencial për të ndihmuar në zgjidhjen e tyre. Kjo është vetëm një nga arsytet, se përse është i rëndësishëm vazhdimi i mësimimit të lëndës së psikologjisë si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi” edhe në klasën e dymbëdhjetë për gjimnazin shoqëror-gjuhësor. Arsye tjetër domethënëse është, që nxënësit e këtij drejtimi të kenë vazhdimësi në lëndën e psikologjisë dhe të kompletojnë njohuritë e marra në klasën 11, duke konsoliduar aspektin teorik dhe atë të zbatimit të tyre.

Lënda e psikologjisë në klasën e 12 u jep nxënësve njohuri për zhvillimin e psikologjisë si shkencë dhe si profesion, metodat e saj të hulumtimit, ndërlihdhen në mes të bazës biologjike dhe proceseve psikike si ndijimi, perceptimi, vëmendja, kujtesa, harresa, të menduarit, gjuha dhe të folurit. Gjithashtu, kjo lëndë u mëson nxënësve për emocionet, stresin dhe menaxhimin e tij, motivacionin dhe rëndësinë e tij në arritjen e rezultateve në jetë, të mësuarit dhe të nxënimit e lëndëve shkollore, të cilat u mundësojnë atyre realizimin e procesit të të nxënimit në mënyrë efektive. Po ashtu, në lëndën e psikologjisë nxënësit mësojnë për zhvillimin njerëzor, seksualitetin dhe gjininë, personalitetin dhe mënyrat e vlerësimit të tij, ndikimin e dimensioneve sociale dhe kulturore mbi sjelljen, si dhe njohuri bazike lidhur me çrregullimet psikologjike dhe trajtimin e tyre. Vazhdimi i mësimimit të lëndës së psikologjisë në klasën e 12 u mundëson nxënësve thellimin e njohurive lidhur me çështjet psikologjike të lartpërmendura. Gjithashtu, këto njohuri u ndihmojnë nxënësve të njohin edhe më mirë vetveten dhe botën, si dhe të lehtësojnë ndërveprimin efektiv dhe cilësor me mjedisin.

Qëllimi

Qëllimi i lëndës së psikologjisë në klasën e 12-të është, që përveç njohjes bazike të nxënësve me njohuri nga fusha e psikologjisë, të marrin edhe njohuri më të thella në këtë drejtim. Një qëllim dytësor është aplikimi nga ana e nxënësit i këtyre njohurive në jetën e përditshme. Duke arritur këto qëllime, realizohen edhe arritjet e kompetencave kryesore të përcaktuara në kornizën kurrikulare të arsimit, duke e bërë nxënësin hulumtues efektiv, të suksesshëm, kontribues produktiv, individ të shëndoshë dhe qytetar të përgjegjshëm.

Po ashtu, lënda e psikologjisë ka për qëllim t’u ndihmojë nxënësve të zhvillojnë identitetin personal, të njohin dhe respektojnë përkatësitë e ndryshme sociale, etnike, kulturore, racore, orientimin seksual, në funksion të zhvillimit të personalitetit të qëndrueshëm. Gjithashtu, meqenëse nxënësit janë klasën e fundit të shkollimit të mesëm, lënda e psikologjisë mundëson të zhvillojë te nxënësit aftësinë për të gjykuar drejt, për të marrë vendime dhe krijimin e shprehive

të shëndosha, në mënyrë që ata të formojnë bazë të qëndrueshme për orientimin profesional dhe atë në karrierë.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Individi, grupet dhe marrëdhëni etshoqërore	RNF: 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to 1. Analizon dhe nxjerr përfundime për ndikimin e personaliteteve të shquara historike, shoqërore, politike, kulturore e arsimore, kombëtare e botërore, gjatë periudhave të ndryshme historike 2. Krahason zhvillimet e grupeve shoqërore, institucioneve, strukturat dhe mënyrat e organizimit të tyre, dikur dhe tani.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Historia dhe metodat e hulumtimit në psikologji	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon qëllimet dhe disa koncepte kryesore të statistikave në hulumtimet në psikologji • Përshkruan konceptin e korrelacionit dhe shpjegimi se si përdoret ky koncept në psikologji • Përshkruan elementët e një eksperimenti • Përshkruan udhëzimet etike të përdorura nga hulumtuesit në psikologji
Biopsikologjia	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon strukturën dhe funksionin e zonave kryesore të trurit • Saktëson lobet specifike të korteksit cerebral, ku janë të përqendruara funksionet specifike • Krahason hemisferën e djathtë dhe të majtë lidhur me funksionimin e trurit • Shpjegon se si tendencat e evoluara ndërveprojnë me ambientin dhe kulturën e tanishme në përcaktimin e sjelljes • Shpjegon konceptet e pragut, adaptimit dhe konstantes • Identifikon tipat e çrregullimeve të gjumit • Demonstron kuptim të dallimeve individuale përsa i përket përmbajtjes së ëndrrave • Krahason teoritë e ndryshme mbi dobinë dhe kuptimin e ëndrrave • Njeh ndikimet kulturore në përdorimin e drogave 	

		psikoaktive
	Zhvillimi dhe të nxënë	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon çështjet kryesore lidhur me zhvillimin (vazhdimësi/jovazhdimësi; stabilitet/ndryshim) • Aplikon parimet e ciklit jetësore mbi përvojën personale • Identifikon ndryshimet fizike dhe kognitive në pjekuri dhe moshën madhore të vonshme • Diskuton çështjet sociale, kulturore dhe emocionale të lidhur me moshën madhore të vonshme • Diskuton të nxënit nga pikëpamja psikologjike • Njeh të nxënit si mjet për promovimin e adaptimit nëpërmjet përvojës • Identifikon kontributet biologjike të të nxënit • Diskuton mbi rolin e kulturës në atë se çfarë sjelljesh do të mësohen • Zbërthen se si faktorët biologjikë dhe kulturorë ndërveprojnë të pengojnë ose të zgjerojnë të nxënë • Përshkruan natyrën bashkëpunuese të disa formave të të nxënit me kulturën • Vlerëson teoritë mbi përvetësimin e gjuhës
	Kognitiviteti	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon faktorët, që interferojnë me kujtesën • Zhvillon strategji për përmirësimin e kujtesës bazuar në kuptimin tonë për të • Identifikon tipet e kujtesës dhe çrregullimeve të saj • Analizon pengesat në zgjidhjen e problemeve, vendimmarrjen dhe gjykimin e shëndoshë • Shpjegon të menduarit kreativ në zgjidhjen e problemeve • Diskuton mbi atë se si testet e inteligjencës pasqyrojnë dallimet midis njerëzve • Shpjegon se pse testet e inteligjencës mund të parashikojnë arritjet e njerëzve • Shpjegon kufizimet e përdorimit të testeve konvencionale të inteligjencës
Proceset shoqërore	RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre 1. Analizon në mënyrë kritike shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, dukurive dhe proceseve të ndryshme në shoqëri dhe shpreh opinionet personale për ndikimet e tyre në individë, në sisteme shoqërore dhe në zhvillime globale.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)

	Dallimet individuale	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon se si zhvillohen motivet e përbashkëta • Shfrytëzon teorinë e vlerave-pritshmërive për të shpjeguar sjelljen e vetes dhe të tjerëve • Përshkruan teoritë të emocioneve si James-Lange, Cannon-Bard dhe teorive kognitive • Shpjegon ndikimet e ndryshme mbi personalitetin • Dallon metodat e ndryshme të vlerësimit të personalitetit • Diskuton stabilitetin dhe ndryshimin në personalitet • Analizon lidhjen midis kulturës kolektivistë/individualiste dhe personalitetit • Identifikon përparësitë dhe kufizimet e metodave të ndryshme të hulumtimit të sjelljes anormale • Diskuton ndikimin e çrregullimeve në jetën e individit, familjes dhe shoqërisë • Diskuton kategoritë kryesore të anormalitetit • Diskuton stigmën, që shoqëron anormalitetin • Shqyrton mundësitë për një promovim më të madh të kuptimit mbi sjelljen anormale
	Sociokultura	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon kategoritë sociale dhe kulturore • Diskuton procesin e ndikimit të kategorive sociale dhe kulturore mbi sjelljen • Diskuton si ndikojnë dinamikat grupore sjelljen dhe se si individi ndikon sjelljen grupore • Përkufizon kulturën dhe diversitetin • Identifikon se si ndryshon kultura në kohë • Diskuton marrëdhënien midis kulturës dhe konceptit të vetes dhe identitetit • Përshkruan atë, se si struktura sociale mund të ndikojë marrëdhëniet ndërgrupore • Diskuton hulumtimet në psikologji lidhur me identitetin gjinor dhe diversitetin në orientim seksual • Krahason dhe ballafaqon identitetin gjinor dhe orientimin seksual • Diskuton hulumtimet në psikologji dhe çështjet, që lidhen me çështjet dhe diskriminimin gjinor
Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë	RNF: 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet 1. Hulumton të dhënat që ndërlidhen me identitetin si: traditat, rregullat,	

	<p>besimet, mitet, legjendat, arkitekturën autoktone) monumentet, veshjet, ushqimet, etj., e popullit të vet dhe të popujve të tjerë; shpjegon vlerat e identitetit kombëtar, rajonal, evropian dhe global.</p> <p>2. Analizon dhe vlerëson shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.</p>
Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
Zbatime të psikologjisë	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan strategjitë për gjetjen e terapistit të duhur për llojet e ndryshme të çrregullimeve • Përshkruan lidhjen midis shëndetit mendor dhe ligjit • Zbërthen ndikimin e ligjit mbi praktikimin e psikoterapisë • Përshkruan karakteristikat dhe faktorët, që promovojnë ripërtëritjen dhe optimizmin • Identifikon burime për ndihmë në selektimin e programeve të psikologjisë për studim të mëtejshëm • Diskuton mënyrën e adresimit të çështjeve lokale dhe globale nga psikologjia • Argumenton rëndësinë e parandalimit të radikalizmit dhe terrorizmit në shoqëri • Gjeneron ide për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë

Udhëzime metodologjike

Ndër sfidat më të rëndësishme në sigurimin e cilësisë më të lartë në mësimdhënie në psikologji është zbatimi i plotë dhe i tërësisëm i programit të lëndës. Më konkretisht, temat dhe RNL-të e paraqitura në këtë dokument kërkojnë në radhë të parë një planifikim shumë të mirë të punës. Në funksion të këtij lloji planifikimi, mësimdhënësve u duhet fillimisht të planifikojnë kohën, që do t'i kushtojnë secilës temë. Planifikimi i kohës do të mundësojë përgatitjen e planit mësimor për secilën temë dhe rezultate të të nxënit të lëndës. Në këtë mënyrë mësimdhënësi siguron zbatimin e plotë dhe të tërësisëm të programit të lëndës, gjë që është gjëja më e rëndësishme e sigurimit të standardeve të larta në mësimdhënie.

Mësimdhënësi është i lirë të zgjedhë metodologjinë e punës, por rekomandohet të përdoren metoda, që mundësojnë realizimin e kompetencave të përcaktuara në kornizën kurrikulare (Rnsh), rezultatet e të nxënit të fushës (Rnf) dhe rezultatet e të nxënit të lëndës (Rnl).

Padyshim, që rezultati në lëndën e psikologjisë, varet nga metodologjia e punës, prandaj mësimdhënësi duhet të marrë në konsideratë përdorimin e metodave, që ndër të tjera

mundësojnë edhe realizimin e parimeve të kurrikulës si gjithëpërfshirjen, llogaridhënien, zhvillimin e kompetencave, mendimin kritik, mësimëdhënien e integruar, autonominë dhe fleksibilitetin tek fëmijët.

Në këtë rrafsh, lënda e psikologjisë ofron mundësi të shumta të përdorimit të metodave të ndryshme, që mundësojnë të nxëniet efektiv dhe t'u përgjigjet interesave dhe aftësive të të gjithë nxënësve. Për këtë arsye duhet të përdoren një sërë metodash të ndryshme si: punë individuale, punë grupore, luajtje e roleve, hulumtime, projekte, punë në terren etj.

Mësimëdhënësi është i lirë të zgjedhë metodologjinë e mësimëdhënies, por këtu do të sugjerohen disa metoda, që lidhen me disa njësi përkatëse të lëndës së psikologjisë si më poshtë:

- *Puna individuale*, e cila do të ishte shumë pozitive të përdorej sa herë që mësimdhënësi gjykon se nxënësi duhet të reflektojë në mënyrë individuale në radhë të parë për konceptet dhe çështjet e trajtuara në klasë. Kjo metodologji mund të gërshetohet me punën në çifte.
- *Puna në çifte*, kësaj metodologjie pune zakonisht i paraprin puna individuale. Kjo metodologji pune shfrytëzohet zakonisht për të rikonfirmuar njohuritë e nxënësve dhe për t'u dhënë mundësi atyre të krijojnë një ambient diskutues në mes tyre.
- *Puna në grupe të vogla*, kjo metodologji ndikon që nxënësit nën vëzhgimin e mësuesit të kenë mundësi që t'i diskutojnë idetë e tyre në grup, të formulojnë mendime në mënyrë ekipore dhe t'i prezantojnë ato përpara klasës. Kjo metodë mund të përdoret për për çështje të tilla si diversiteti, zhvillimi, çështje të karrierës në psikologji, ballafaqimi me stresin, etj. dhe prezantimi i rezultateve para klasës.
- *Ndarja e klasës në dy grupe*, kjo metodologji pune do të ishte ideale sidomos kur mësimdhënësi synon që të nxisë diskutimin dhe shprehjen e qëndrimeve për koncepte ose çështje të caktuara nga ana e nxënësve si për çështje të diversitetit dhe kontekstit sociokulturor, psikologjinë e anormalitetit etj.
- *Pyetje autorit* – Kjo metodë është tepër e rëndësishme që nxënësit të reflektojnë me sy kritik ndaj materialit që i ofrohet.
- *Luajtja e roleve* – Ku nxënësit zhvillojnë debat, duke argumentuar idetë lidhur me temën , që ata përfaqësojnë. Në këtë mënyrë nxënësit krijojnë shprehje të menduarit kritik, të folurit në publik, të menduarit kreativ etj.
- *Përgatitja e një hulumtimi në terren nga nxënësit* kur është fjala për metodat e hulumtimit në psikologji, por edhe për tema specifike sipas përcaktimit të mësimdhënësit. Në këtë mënyrë, nxënësit zbatojnë procedurat e mësuara të përgatitjes dhe aplikimit të metodave dhe teknikave të hulumtimit, që janë aq të rëndësishme në psikologji si mësojnë disa koncepte kryesore të statistikave në hulumtimet në psikologji.
- *Përdorimi i teknologjisë* si për shembull, paraqitja e punës së nxënësve në PowerPoint, gjetja nga ana e nxënësve të filmave të metrazhit të shkurtër lidhur me njësinë që diskutohet, përdorimi i aplikacioneve për ilustrimin e temave të veçanta etj. Kjo u mundëson nxënësve shfrytëzimin e teknologjisë informative, zhvillimin e shkathtësive për shfrytëzimin e burimeve alternative të fitimit të njohurive etj.
- *Ardhja e folësve ekspertë* të ftuar për të diskutuar (nën)tema specifike nga programi i lëndës.

Në mënyrë që nxënësit t'i paraqiten temat në koherencë me njëra-tjetrën, mësimdhënësi duhet të analizojë rezultatet e fushës, temat dhe njësitë mësimore, si dhe ndërlidhjen e tyre me çështjet ndërkurrikulare, gjë që do të mundësonte edhe mësimdhënien e integruar.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Psikologjia është njëra nga disiplinat shkencore, që përpiqet të zgjerojë të kuptuarit tonë për shumë probleme, që kanë të bëjnë me mendjen dhe sjelljen. Për ta bërë këtë, kjo disiplinë merr dhe jep natyrshëm me shkenca të tjera. Pikërisht kjo është arsyeja kryesore, se përse programi lëndor i paraqitur në këtë dokument integron edhe informacione nga disiplina të tjera shkencore. Disa të tilla janë filozofia, statistikat, biologjia, anatomia dhe fiziologjia, sociologjia, kulturologjia, shëndeti mendor, linguistika, çështjet gjinore, teknologjia etj.

Në pikëtakimet me çështjet kurrikulare mësimdhënësit inkurajohen të evokojnë njohuri në fillim të orës, të cilat nxënësit i kanë marrë më herët. Në fund, mësimdhënësit inkurajohen të sqarojnë informacionet ndërkurrikulare, për të cilat konsiderojnë, se nxënësit nuk kanë shumë informacion për fusha, të cilat nuk janë pjesë formale e kurrikulës si kulturologjia, antropologjia etj.

Udhëzime për vlerësim

Në mënyrë që vlerësimi të reflektojë objektivisht njohuritë e marra nga nxënësit në klasë, integrimin e tyre në mendimin personal, shprehjen e të njëjtave me anë të të shkruarit metodat e vlerësimit e rekomanduara do të ishin:

Vrojtimi – kjo metodë do të vlente për të parë dhe vlerësuar aktivitetin në klasë të nxënësve. Mësimdhënësi mund t'i shënojë vrotimet e tij në ditarin e tij në mënyrë që të ketë sistematizëm në këtë pikë dhe të shmangë mundësinë e harrimit të detajeve për çdo student.

Kuize të shkurtra – kjo metodë vlerësimi përdoret për të ruajtur angazhimin dhe intensitetin e punës së nxënësit gjatë vitit. Mund të aplikohet pas çdo nënteme të nxjerrë nga RNL-të.

Prezantime – kjo metodë vlerësimi nxit punën e pavarur të nxënësve dhe shkathtësitë e komunikimit publik të ideve të përgatitjes dhe ideve të tyre.

Testi me shkrim – kjo metodë vlerësuese ndoshta do të ishte mirë të aplikohet pas çdo teme dhe në fund të lëndës.

Eseja – kjo metodë vlerësuese do të përdorej me qëllim që të vërtetohet se sa mund t'i integrojë dhe riprodhojë nxënësi njohuritë e marra me anë të të shkruarit. Gjithashtu, eseja do të ishte metodë ideale për të parë se ç'qëndrim personal ka nxënësi ndaj koncepteve të trajtuara në klasë.

Më tej, kjo metodë vlen edhe si parapërgatitje e nxënësit për një punë akademike më të avancuar, nëse do të vijojë studimet universitare. Normalisht, eseja do të ishte një detyrë që do të jepej në fund të lëndës, por mund të zbatohet edhe teknika e minieseve, nëse shihet e arsyeshme nga mësimdhënësi.

Testi me gojë – kjo metodë vlerësuese do të ishte e vlefshme për të verifikuar në klasë njohuritë e marra. Gjithashtu, nxënësit do të kishin mundësi t'i përvetësonin edhe më tepër duke folur termat dhe njohuritë specifike të përfituara.

Mendimi kritik – rekomandohet, që mësimdhënësit t'i vlerësojnë nxënësit edhe për mendimin e tyre kritik të shprehur në lëndë, nëpërmjet pyetjeve, aktivizimit, diskutimeve në klasë, etj.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Psikologjia është një disiplinë shkencore në ekspansion dhe shumë dinamike. Kjo kërkon, që mësimdhënësit duhet të përditësojnë vazhdimisht njohuritë e tyre për zhvillimet në këtë fushë.

Mësimdhënësit inkurajohen të punojnë në vazhdimësi me tekstin e psikologjisë 12 aktual dhe me atë të ardhshmin. Gjithashtu, ata inkurajohen të shfrytëzojnë tekstet e ndryshme të psikologjisë, numri dhe cilësia e të cilëve është gjithnjë në rritje, të botuara në gjuhën shqipe në rang parauniversitar dhe universitar. Më tej, është e rëndësishme, që mësimdhënësit të shfrytëzojnë platformat e ndryshme me qasje në studime dhe artikuj shkencorë, të cilat mund të përdoren në segmente të ndryshme të mësimdhënies si përditësim i të dhënave, pikënisje për diskutime në klasë etj.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Filozofi dhe logjikë (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda Filozofi dhe logjikë përfshihet në programin e klasës XII, drejtimi Gjinnazi i shkencave shoqërore -gjuhësore, me qëllim të përgaditjes së nxënësve për jetë, përmbushjes së aspiratave dhe potencialeve të tyre në zhvillimin e shkencës dhe kulturës, dhe në krijimin e bazës së koncepteve dhe njohurive për arritjen e qëllimeve individuale, që shpijnë në drejtim të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror.

Të rinjtë në Kosovë kanë nevojë për një filozofi jete dhe aftësim për të menduar në mënyrë kritike dhe argumentative, e cila do t'i aftësojë për të jetuar dhe për të vepruar, duke projektuar qëllime dhe duke qenë të angazhuar në realizimin e tyre. Pikërisht një filozofi të tillë, e plotësuar me bazat e logjikës, do të kontriboj në zhvillimin intelektual të nxënësëve dhe aftësimin profesional të tyre, ndërsa si e tillë do t'iu ofrohet nxënësëve të shkollave të mesme përmes kësaj kurrikule.

Mendimi filozofik është zhvilluar përmes problemeve filozofike, prandaj mënyra më e natyrshme e paraqitjes së filozofisë për nxënësit është duke e përcjellur rrugën e të filozofuarit vetë.

Në këtë perspektivë, kurrikula e re për lëndën Filozofi dhe logjikë ofron një mori problemesh, një seri mendimesh, duke u nisur nga përvoja e përditshme e nxënësve drejt refleksionit të mirëfillt filozofik dhe mendimit shkencor. Synimi i kurrikulës është formimi i mendimit kritik filozofik të nxënësve, duke u nisur nga ndërlidhja e dy elementeve kryesore: ofrimit të informatave mbi nocionet dhe problemet kryesore të filozofisë dhe logjikës (përmes teksteve filozofike) dhe mësimin aktiv (të bazuar në reflektime, analiza, krahasime) i cili njëkohësisht paraqet një nga sfidat kryesore të procesit mësimor.

Poashtu, programi do të ndikojë në nxitjen e raportit krijues të nxënësve ndaj botës dhe vetvetes.

Qëllimi

Duke pasur parasysh se në klasën XII nxënësit për herë të parë merren me problematikën e gjërë filozofike, qëllimi i programit mësimor i lëndës Filozofi dhe logjikë është:

1. Zhvillimi i aftësive të nxënësi për të menduar në mënyrë kritike dhe analitike mbi botën dhe vetëveten, duke u bazuar në njohjen dhe kuptimin e nocioneve themelore filozofike dhe logjike.
2. Zhvillimi i shkathtësive të përgjithshme të nxënësit për t'i shprehur qartë, në të folurit dhe në të shkruarit, nocionet dhe kategoritë filozofike dhe logjike.
3. Nxitja për aplikim të njohurive të përfituara nga lëmia e filozofisë dhe logjikës.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e dymbëdhjetë i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, të shkallës së pestë (Shkalla 6) në Kurrikulën Bërthamë III.

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Individi, grupet dhe marrëdhëni etshoqërore	RNF: 1. Hulumton konceptin e individit dhe strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to	
	<p>1. Analizon strukturën dhe funksionimin e grupeve shoqërore, dikur dhe tani, dhe nxjerr përfundime për mënyrat e angazhimit në mënyrë konkrete në dobi të interesave të bashkësisë dhe shoqërisë.</p> <p>2. Merr iniciativë në organizime rinore në shkollë dhe jashtë saj për të zhvilluar proceset demokratike dhe i adreson çështjet me interes përmes veprimeve konkrete.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
Filozofia, kultura dhe shoqëria	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon termin dhe zanafillen e filozofisë • Ilustron rolin e filozofisë në shoqëri • Identifikon çështjet dhe disiplinat themelore të filozofisë • Diskuton mbi zhvillimin e filozofisë dhe raportin e saj me shkencat e tjera • Identifikon elemente të përbashkëta dhe dallime në mes të filozofisë, kulturës dhe religjionit • Përcakton pozitën e filozofisë në raport me historinë e saj • Analizon dallimin në mes të dy metodave kryesore në interpretimin e filozofisë (metoda historike-kronologjike dhe metoda problemore) 	
Proceset shoqërore dhe natyrore	RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre	
	<p>1. Vlerëson dhe ndërlidh efektet e proceseve shoqërore, historike e mjedisore në jetën e individëve dhe të shoqërisë.</p> <p>2. Merr pjesë aktivisht (planifikim, organizim, udhëheqje, menaxhim etj.) në aktivitete hulumtuese duke përdorur lloje të ndryshme të informacioneve për ngjarjet dhe dukuritë shoqërore, historike dhe sjell të dhëna të mbështetura në fakte, duke iu shmangur paragjykimeve dhe opinioneve</p>	

	subjektive.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Njeriu dhe bota e tij	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diskuton për njeriun si qenie shumëdimensionale (ontologjike, gnoseologjike, etike, estetike, historike etj.) • Shpjegon nocionin e njeriut në antropologjinë filozofike • Interpreteton njeriun si qenie: <ul style="list-style-type: none"> a) racionale dhe kulturore b) irracionale dhe biologjike • Dallon konceptet e vetëdijës, vetëvetëdijës dhe vullnetit të lirë • Diskuton për problemin e lirisë (determinizmi dhe indeterminizmi)
	Qenia dhe ekzistenca	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon nocionin e esencës nga nocioni i ekzistencës (dallimi midis esencializmit dhe ekzistencializmit) • Shpjegon nocionin e kozmosit në filozofi • Interpreteton problemin kompleks filozofik të kohës dhe hapësirës • Dallon qasjen filozofike nga qasja teologjike mbi religjionin • Shpjegon problemin e ekzistencës së zotit në filozofi (interpreteton argumentet tradicionale filozofike mbi ekzistencën e zotit: argumenti ontologjik, kozmologjik, fiziko-teleologjik)
	E bukura dhe arti	<ul style="list-style-type: none"> • Kupton nocionet themelore të estetikës (e bukura dhe arti) • Diskuton mbi teoritë relevante estetike
Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë	<p>RNF: 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerëson përpjekjet për liritë dhe të drejtat e njeriut, në kontekste dhe periudha të ndryshme kohore dhe angazhohet për respektimin e larushisë shoqërore. 2. Prezanton fakte dhe opinione, sqaron prejardhjen e tyre dhe përmes tyre nxjerr përfundime dhe shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e veta për çështje dhe dukuri të ndryshme shoqërore, historike, kulturore. 	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Shteti, e	Nxënësi:

	drejta dhe liria	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon elementet themelore të filozofisë sociale dhe politike • Krahason teoritë e kontrates sociale lidhur me prejardhjen, rolin dhe funksionimin e shtetit • Elaboron nocionin e individit, të drejtat dhe liritë e tij, dhe kufizimin e tij nga struktura shoqërore • Dallon paradigmat e raportit të politikës me etikën (paradigma platonike, makiaveliste dhe ajo liberale) • Kupton historinë nga pikëpamja filozofike
	Morali dhe vlerat	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon çështjet themelore të filozofisë së moralit • Demonstron karakterin kompleks të vlerave morale • Artikulon teoritë e ndryshme të etikës, qasjen e tyre deskriptive dhe normative • Lidh moralin me vullnetin e lirë • Shqyrton moralin në kontekstin e konsekuencave • Kontekstualizon aplikimin e teorive etike në praktikë (bioetika)
Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	<p>RNF: 4. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.</p> <p>1. Analizon karakteristikat shoqërore–ekonomike të mjedisit, proceset ekonomike, sociale, politike, kulturore dhe paraqet ndryshimet në shoqëri si rezultat i ndërveprimit në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Etika ambientaliste	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerëson rolin e mjedisit në jetën individuale dhe sociale të njeriut ▪ Reflekton mbi raportin moral midis njeriut dhe ambientit natyror (qenieve jo-humane) ▪ Artikulon teoritë filozofike mbi raportin njeriu v.s. ambienti (antropocentrizmin dhe ekocentrizmin)
Vendimmarrja	<p>RNF: 5. Jep ide dhe propozime, argumenton si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</p> <p>1. Veçon mënyrat e vendimmarrjes në periudha dhe në kontekste të ndryshme shoqërore e historike dhe nxjerr përfundime për rëndësinë e vendimmarrjes së drejt.</p> <p>2. Vlerëson ndikimin e zhvillimit ekonomik, shkencor dhe teknologjik në shoqëri në përgjithësi si dhe në vendimmarrje.</p>	

Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
Mendimi filozofik si mendim kritik	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Ilustron rolin e mendimit filozofik dhe ndikimin e tij në mënyrën kritike të të menduarit
Koncepti i së vërtetës	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Diskuton rreth karakterit kompleks të së vërtetës • Dallon nocionin e së vërtetës nga nocioni i realitetit • Artikulon teoritë themelore filozofike mbi të vërtetën (teoria e korrespondencës, koherencës dhe teoria pragmatike)
Burimet, mundësitë dhe kufijtë e njohjes	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Analizon elementët themelore të teorisë së njohjes • Bën dallimin midis njohjes dhe dijes • Artikulon teoritë filozofike mbi burimet dhe metodat e njohjes (empirizmin dhe racionalizmin) • Shpjegon pikëpamjet filozofike mbi mundësinë dhe kufijtë e njohes (dogmatizmin dhe skepticizmin) • Demonstron rolin e dyshimit në procesin e njohjes • Artikulon kritikizmin dhe transcendentlizmin e teorisë së njohjes së Kant-it • Definon nocionin e shkencës dhe njohjes shkencore • Shpjegon komponentet, qëllimet dhe funksionin e shkencës • Shpjegon procesin e hulumtimit shkencor (paraqitja e problemit, parashtrimi i hipotezës, përcaktimi i metodave dhe testimi i hipotezës)
Format e mendimit logjik (nocioni, propozicioni dhe argumentimi)	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Definon logjikën si disiplinë filozofike • Artikulon rolin e mendimit logjik në shkencë dhe në jetën praktike • Dallon logjikën formale nga logjika përmbajtësore (jo-formale) • Artikulon format themelore të mendimit logjik • Bën dallimin në mes mendimit logjik valid dhe jo-valid • Dallon logjikën deduktive nga logjika induktive

		<ul style="list-style-type: none"> • Definin kuptimin e nocionit, përmbajtjen dhe vëllimin e tij • Shpjegon llojet dhe raportin midis nocioneve • Definin propozicionin dhe strukturën e tij • Shpjegon llojet themelore të propozicioneve në logjikën tradicionale të predikateve (propozicionet kategorike sipas sasisë dhe cilësisë) • Interpreton raportin midis propozicioneve sipas sasisë dhe cilësisë (katrori logjik) • Demonstron operacionet themelore të propozicioneve kategorike (konversioni, obverzioni, kontrapozicioni) • Definin nocionin e argumentimit deduktiv dhe pjesët përbërse të tij • Demonstron format valide të silogjizmit kategorik • Diskuton për elementet bazike të logjikës simbolike propozicionale • Kupton gjuhën formale të logjikës simbolike propozicionale (operatorët logjik, shkronjat për pohime dhe kllapat) • Demonstron përkthimin nga gjuha natyrore në gjuhën artificiale të logjikës simbolike propozicionale • Shpjegon rregullat e tabelave të vërtetësisë (negacioni, konjunksioni, disnjunksioni, implikacioni dhe ekujvalenca) • Aplikon tabelat e vërtetësisë në testimin e propozicioneve logjike (tautologjia, vetë-kotradikta, kontingjenca) • Aplikon tabelat e vërtetësisë për testimin e raportit në mes propozicioneve (ekuivalenca, kontradikta, konsistenca, inkonsistenca) • Aplikon tabelat e vërtetësisë në testimin e validitetit të argumenteve jo-sasiore (silogjizmi hipotetik, disnjunktiv, konjunktiv etj.) • Dallon natyrën e argumentimit induktiv nga ai analogjik • Shpjegon rregullat dhe komponentet e definicionit dhe divizionit
--	--	---

Udhëzime metodologjike

Qasja problemore

Duke u mbështetur në një nga qëllimet kryesore të mësimdhënies së filozofisë dhe logjikës, të zhvilluarit e mënyrës kritike dhe analitike të të menduarit te nxënësit, lënda e filozofisë dhe

logjikës nuk ofron përcaktimin e gatshëm, formal të nocioneve, kategorive dhe teorive. Mësimdhënia e filozofisë është gjithmonë shpjegimi, analizimi dhe ndriçimi i një nocioni, problemi apo çështjeje filozofike. Mënyra më frytdhënëse në përvehtësimin e nocioneve filozofike dhe logjike bazohet në përshkrimin e gjenezës së nocionit, ballafaqimin, krahasimin dhe lidhjen me nocione të tjera, duke analizuar format dhe mundësitë e përdorimit të tyre.

Ndërveprimi

Në përvetësimin e temave nga filozofia dhe logjika është me rëndësi paraqitja e mendimeve dhe diskutimi në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme. Përshkrimi, referimi ndaj teorive të ndryshme, përdorimi i shembujve konkretë dhe krahasimi me shembuj të tjerë janë bazamente dhe tullat kryesore për ndërtimin e mendimit të pavarur të nxënësit dhe lidhjen e pjesës teorike me aplikimin praktik të saj. Në këtë mënyrë do të arrihet edhe qëllimi i dytë i lëndës së filozofisë dhe logjikës: ofrimi i një filozofie e cila do të ndihmonte nxënësit që ta kuptojnë dhe ta jetojnë jetën, dhe ofrimin e një logjike e cila do t'i aftësonte nxënësit që të mendojnë në mënyrë kritike dhe racionale.

Për t'i ikur mundësisë që lënda e Filozofisë dhe logjikës të shndërrohet në një skollistikë monotone dhe monolog, diskutimet mbi problemet dhe çështjet filozofike-logjike do të jenë pjesë e pandarë e çdo ore mësimore. Po ashtu, interpretimi dhe shpjegimi i teksteve të shkurtëra filozofike, është metodë efikase në krijimin e kontaktit të nxënësit me mendimet e filozofëve përkatës. Çdo mësim do të shoqërohet edhe me një fjalor shpjegues të nocioneve filozofike dhe logjike.

Duke u bazuar në këto metoda, nxënësi do të orientohet drejt një mendimi kritik, përmes udhëzimeve se teza e mbrojtur duhet tu përgjigjet standardeve filozofike dhe logjike, të mbështetet në argumente dhe fakte, dhe duke nxitur hulumtime të mëtutjeshme. Nxënësit duhet ofruar mundësi për paraqitjen e qëndrimeve dhe mendimeve të pavarura në formë të punimeve të hartuara dhe artikulimit gojor të atyre, duke integruar në to informacionin teorik (nga tekste filozofike) dhe ushtrimin praktik.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare janë të ndërlidhura me rezultatet e fushës andaj duhet t'i kushtohet kujdes trajtimit adekuat edhe në programet lëndore. Nga mësimdhënësi kërkohet që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e fushës, temat dhe njësitë mësimore se me cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhen. Në këtë mënyrë sigurohet trajtimi sa më i mirë i këtyre çështjeve por njëkohësisht dhe mësimdhënia e integruar:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqë
- Globalizimi dhe ndërvarësia

- Edukimi për media,
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Vetë fakti se filozofia dhe logjika janë pjesë të rëndësishme të zhvillimit të përgjithshëm të mendimit njerëzor, domosdo vendosë filozofinë dhe logjikën në një rrjetë të ndikimeve të ndërsjellta me pjesë të tjera të këtij zhvillimi. Gërshetimi i problemeve shoqërore dhe natyrore drejton filozofinë dhe logjikën në arritjet e deritanishme brenda lëndëve të tjera të veçanta. Në anën tjetër, në çdo shkallë të zhvillimit të shkencave, një sektor i veçantë dhe i gjërë në sistemin e dijeve mbi botën i takon funksionimit të pavarur të reflektimeve filozofike.

Në bazë të materialit tematik i cili do të prezantohet para nxënësëve është e nevojshme ndërlidhja e lëndës së filozofisë dhe logjisë me këto lëndë sipas temave në vijim:

- Filozofia, kultura dhe shoqëria: Sociologjia, Historia, Gjuha, Edukata qytetare
- Njeriu dhe bota e tij: Sociologjia, Psikologjia, Gjuha, Biologjia
- Qenia dhe ekzistenca: Fizika, Astronomia, Sociologjia, Edukata qytetare
- E bukura dhe arti: Arti figurativ, Edukatë muzikore
- Shteti, e drejta dhe liria: Edukata qytetare, Sociologjia, Historia
- Morali dhe vlerat: Sociologjia, Edukata qytetare
- Etika ambientaliste: Sociologjia, Edukata qytetare, Biologjia
- Mendimi filozofik si mendim kritik: Sociologjia, Psikologjia
- Koncepti i së vërtetës: Matematika
- Burimet, mundësitë dhe kufijtë e njohjes: Psikologjia, Matematika
- Format e mendimit logjik: Matematika, Psikologjia

Udhëzime për vlerësim

Mësimdhënësi i lëndës Filozofi dhe logjikë duhet të ketë parasyshë disa çështje të rëndësishme gjatë vlerësimit të nxënësit:

- Mënyrën se si nxënësi strukturon mendimin për të argumentuar qëndrimet e veta mbi çështjet e ndryshme filozofike-logjike dhe praktike
- Sa nxënësi është në gjendje të integrojë informacionin teorik dhe shkencor
- Mënyrën se si nxënësi është në gjendje t'i prezantojë materialet e përvetësuara në mënyrë individuale dhe grupe
- Sa është nxënësi në gjendje që përmes teksteve filozofike, të hartojë punime të pavarura.

Vlerësohen:

- Përgjigjet me gojë
- Prezentimet individuale dhe ne grup
- Esetë dhe punimet e pavarura
- Testet me shkrim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në kuadër të lëndës Filozofi dhe logjikë, për realizimin e temave mësimore si dhe për mbërritjen e rezultateve të lëndës, përveç teksteve dhe burimeve shkollore përdoren edhe disa nga këto mjete:

- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, tabela interaktive, ilustrime, fotografi, dokumentarë, modele, diagrame, mjete grafike etj.
- Mjete audiovizuale - pamore-dëgjimore: televizori, video-projektori, kompjuteri, telefoni, tableti, CD-ja, etj.

Kurrikula lëndore/programi mësimor

Sociologji (Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Lënda e Sociologjisë për nxënësit e klasës XII (Gjimnazi i shkencave shoqërore-gjuhësore) është vazhdimësi tematike e Sociologjisë për nxënësit e klasës XI. Temat e trajtuara në programin lëndor të klasës XII, janë të ndryshme prej vitit pararendës, por që së bashku përbëjnë tërësinë tematike, si fushë e interesimit shkencor të Sociologjisë. Në këtë kuptim, edhe ky program lëndor kontribuon në formimin intelektual dhe kulturor të nxënësve.

Përmes kësaj lënde nxënësit e klasës XII (Gjimnazi i shkencave shoqërore-gjuhësore), do të fitojnë njohuri përkitazi me grupet shoqërore dhe llojet e tyre. Do të familjarizohen me aspekte të ndryshme të identifikimit shoqëror, si raca, etnia, religjion dhe mënyrën se si manifestohen ato në botën bashkëkohore. Më pastaj procesi i globalizimit dhe efektet politike, ekonomike e kulturore të tij. Mediat janë po ashtu temë e veçantë e këtij programi lëndor, si një ndër çështjet më të ndjeshme për nga efektet e shumëfishta shoqërore që ajo i prodhon. Kjo temë kontribuon edukimin digjital të nxënësve. Preokupimi me trupin kohëve të fundit është trend i njohur shoqëror, me të cilën lidhen shumë sektorë tjerë të shoqërisë, përfshirë marketingun, industrinë e dukjes (kozmetika, veshja, fitnesi etj.), mjekësinë etj. të cilat kanë krijuar një ekonomi krejtësisht të re politike të trupit. Programi lëndor i sociologjisë prekë edhe një mori çështjesh tjera, të cilat janë skajshmërisht të rëndësishme për një formim intelektualisht kritik dhe qytetar të nxënësve, si raporti me mjedisin dhe rreziku, që i kërcënohet atij nga zhvillimet e fundit teknologjike dhe ideologjia e konsumit. Hapësirat urbane, qytetet me të gjitha efektet demografike dhe politike që sjellin më vete, po ashtu janë pjesë e programit. Edukimi, varfëria, puna, jeta ekonomike, përjashtimi social, mirëqenia sociale, lëvizjet shoqërore dhe terrorizmi janë po ashtu tematika të përfshira në këtë program lëndor, për shkak se zënë vend qendror në preokupimet globale, qoftë në planin akademik, qoftë atë të politikbërjes.

Përmes trajtimit të këtyre temave nxënësi përfiton një kuptim më të hapur për shoqërinë, që për një botë gjithnjë e më të globalizuar, është tepër i nevojshëm. E kuptuar si ‘art marcial’, përkufizim ky i përdorur nga sociologu i mirënjohur Pierre Bourdieu, Sociologjia iu shërben nxënësve që të kuptojnë mënyrën e funksionimit të shoqërisë, ashtu që t’i shmangen viktimizimit social dhe të marrin fatin në duart e tyre.

Qëllimi

Me këtë program lëndor, ashtu sikurse edhe me pararendësin, mendohet të arrihen tri qëllime. *Së pari*, mëtohet që nxënësit të fitojnë njohuri të përgjithshme përkitazi me çështjet, fenomenet dhe problemet kyçe të botës bashkëkohore. Kështu ata fillojnë të kuptojnë kompleksitetin e jetës bashkëkohore, në të gjitha planet: atë institucional, ekonomik, politik, teknologjik, medial etj. Rrjedhimisht, *së dyti*, me imagjinatën sociologjike që do ta zhvillojnë përmes këtij programi, nxënësit do ta kenë më të lehtë të ballafaqohen dhe të jetojnë me këtë kompleksitet. Dhe *së treti*

“përmes ‘imagjinatës sociologjike’ nxënësit do të jenë të aftë të kuptojnë dhe kontekstualizojnë veten e tyre dhe përvojat personale në kontekste më të gjera shoqërore, përfshirë këtu edhe komunitetet ku jetojnë. Në këtë kuptim, nxënësit do të vetëdijesohen për ndikimin që forcat sociale, si: familja, grupmoshat, institucionet shtetërore, mediat, ekonomia, etj. kanë në jetën e tyre. Në këtë mënyrë, ata do të kenë një kontroll më të madh mbi jetën e tyre”. Pra, qëllimi i tretë mbetet i njëjtë, pasi që, siç thamë edhe në hyrje, ky program lëndor është vazhdimësi tematike e nivelit pararendës. Fusha e tërësishme tematike e sociologjisë është e ndarë në dy pjesë për të dy nivelet. Rrjedhimisht edhe shtrirja tematike e klasës XII është përplotësim tematik i klasës XI dhe jo thellim i mëtutjeshëm i njohurive nga niveli pararendës. Prandaj qëllimi i tretë mbetet i njëjtë, pasi që është fundamental për lëndën e Sociologjisë.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e dymbëdhjetë i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, të shkallës së gjashtë (Shk 6) në Kurrikulën Bërthamë III:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
1. Individit, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore	RNF: 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to 1. Analizon strukturën dhe funksionimin e grupeve shoqërore, dikur dhe tani, dhe nxjerr përfundime për mënyrat e angazhimit në mënyrë konkrete në dobi të interesave të bashkësisë dhe shoqërisë. 2. Merr iniciativë në organizime rinore në shkollë dhe jashtë saj për të zhvilluar proceset demokratike dhe i adreson çështjet me interes përmes veprimeve konkrete.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Grupet, organizatat dhe rrjetet	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon llojet e grupeve shoqërore dhe rëndësinë e tyre në shoqëri. • Dallon grupet joformale, nga ato më të voglat me intimitet të lartë, prej atyre formale nga ato më të mëdhatë si p.sh. burokracitë. • Diskuton mënyrat e ndërtimit të rrjeteve shoqërore në botën bashkëkohore. • Shpjegon karakteristikat e grupeve të ndryshme shoqërore.
	Raca dhe etnia	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon racën, etninë dhe grupet minoritare si konstrukte sociale si dhe bën dallimet ndërmjet tyre.

		<ul style="list-style-type: none"> • Dallon paragjykimin, diskriminimin, racizmin ashtu sikurse dhe asimilimin, segragacionin, dhe gjenocidin. • Diskuton pluralizmin kulturor, shumësinë e përkatësive dhe identitare në shoqëritë bashkëkohore. • Interpretin format kryesore të marrëdhënieve ndërmjet shumicës dhe grupeve minoritare.
	Religjioni në botën moderne	<ul style="list-style-type: none"> • Krahason trajtat që religjioni merr në shoqëritë moderne, në dallim prej atyre tradicionale. • Diskuton format e ndryshme të lëvizjeve religjioze në botën bashkëkohore. • Analizon raportin e gruas me traditat religjioze përgjatë historisë. • Debaton trendet aktuale të diskutimeve sociologjike përkitazi me fundamentalizmin, sekularizmin dhe dhunës religjioze.
2.Proceset shoqërore	RNF: 2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre 1. Vlerëson dhe ndërlidh efektet e proceseve shoqërore, historike e mjedisore në jetën e individëve dhe të shoqërisë. 2. Merr pjesë aktivisht (planifikim, organizim, udhëheqje, menaxhim etj.) në aktivitete hulumtuese duke përdorur lloje të ndryshme të informacioneve për ngjarjet dhe dukuritë shoqërore, historike dhe sjell të dhëna të mbështetura në fakte, duke iu shmangur paragjytimeve dhe opinionëve subjektive.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Globalizimi dhe një botë në ndryshim	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon faktorët që ndikojnë në ndryshimin shoqëror në nivel global, si: mjedisi fizik, organizatat politike, kultura dhe faktorët ekonomikë. • Interpretin debatet ndërmjet skeptikëve, hiperglobalistëve dhe transformacionalistëve përkitazi me globalizmin. • Përshkruan ndikimin e globalizimit në ngritjen e individualizimit, ndryshimin e formave të punës, kulturës popullore, rrezikut dhe pabarazisë në shoqëritë bashkëkohore. • Interpretin ndikimin e organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe atyre joqeveritare, korporatave transnacionale.
	Pabarazia globale	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton dallimet sistemike në pasuri dhe pushtet ndërmjet shteteve. • Analizon ndikimin e standardeve, ekonomikisht të

		<p>dallueshme, të jetesës në botë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krahason teoritë e ndryshme, si ajo e tregut, e modernizimit, neoliberalizmit, e varësisë, e kolonializmit, etj.
	Mediat	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon rolin e fuqishëm që kanë mediat masive në shoqëri, prej atyre tradicionale si gazetatat, revistat, radioja, televizioni e deri te format digjitale të komunikimit publik, përfshirë rrjetet sociale. • Shpjegon nivelin e lartë të ndërlidhjes dhe ndërveprimit që e ka mundësuar interneti, rrjedhojat shoqërore të tij, qoftë pozitive në shumëfishimin e mundësive qoftë negative në rritjen e izolimit social dhe anonimitetit. • Diskuton teoritë e ndryshme përkitazi me strukturën, organizimin dhe rolin e mediave, si ato të McLuhan-it, Habermas-it, Baudrillard-it etj.
3. Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë	RNF: 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet	
	<p>1. Vlerëson përpjekjet për liritë dhe të drejtat e njeriut, në kontekste dhe periudha të ndryshme kohore dhe angazhohet për respektimin e larushisë shoqërore.</p> <p>2. Prezanton fakte dhe opinione, sqaron prejardhjen e tyre dhe përmes tyre nxjerr përfundime dhe shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e veta për çështje dhe dukuri të ndryshme shoqërore, historike, kulturore.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Trupi, shëndeti, sëmundjet dhe paaftësia	<ul style="list-style-type: none"> • Interpretin ndikimin e konteksteve shoqërore dhe kulturore në formimin e qëndrimeve përkitazi me trupin, shëndetin dhe sëmundjen. • Dallon modelin perëndimor biomjekësor të shëndetit prej modeleve tjera. • Kupton lidhjen ndërmjet sëmundjes dhe pabarazisë. • Identifikon dimensionet racore, etnike dhe gjinore të shëndetit dhe sëmundjes. • Tematizon paaftësinë si fenomen bashkëkohor.
Edukimi	<ul style="list-style-type: none"> • Interpretin funksionet shoqërore të shkollimit. • Arsyeton rreth ndikimeve shoqërore dhe kulturore në arritjet mësimore. • Kupton raportin e shkollimit formal me formimin joformal, si kapitali kulturor, dhe mënyrën se si manifestohet në relacionet shoqërore. 	

4.Vendimarrja dhe institucionet	<p>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</p> <p>1. Veçon mënyrat e vendimmarrjes në periudha dhe në kontekste të ndryshme shoqërore e historike dhe nxjerr përfundime për rëndësinë e vendimmarrjes së drejt.</p> <p>2. Vlerëson ndikimin e zhvillimit ekonomik, shkencor dhe teknologjik në shoqëri në përgjithësi si dhe në vendimmarrje.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Politika, qeveria, lëvizjet shoqërore dhe terrorizmi	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon veprimtarinë politike si dhe thelbin, rolin dhe rëndësinë e institucioneve politike. ▪ Krahason format e ndryshme të organizimit të pushtetit dhe legjitimitetin. ▪ Krahason trajtat e ndryshme të demokracisë si dhe gjendjen e saj aktuale. ▪ Diskuton raportin e demokracisë, lëvizjeve shoqërore dhe formave të ndryshme të terrorizmit me zhvillimet teknologjike, sidomos atyre në fushën e informacionit.
5.Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	<p>RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.</p> <p>1. Analizon karakteristikat shoqërore-ekonomike të mjedisit, proceset ekonomike, sociale, politike, kulturore dhe paraqet ndryshimet në shoqëri si rezultat i ndërveprimit në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Mjedisi dhe rreziku	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton ndikimin që industria dhe teknologjia moderne e po ashtu edhe kultura e konsumit masiv ka në mjedis. • Identifikon burimet e ndryshme të rrezikut mjedisor, që nga ndotja dhe hedhja e mbeturinave, si ndotja e ajrit, shiu acidik, ndotja e ujërave dhe mbeturinat e pariciklueshme e deri te shterimi i resurseve të ripërtëritshme natyrore, si uji, pyjet etj. duke pakësuar biodiversitetin. • Argumenton se shumë çështje mjedisore ndërlidhen me rrezik, për shkak se janë rezultat i zgjerimit të shkencës dhe teknologjisë, si ushqimet gjenetiksht të modifikuara, ngrohja globale, e cila ka një mori pasojash tjera, si përmbytjet, përhapjen e sëmundjeve, motet ekstreme etj.
Qytetet dhe hapësirat urbane	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon ndikimin e fuqishëm të globalizimit si të tillë dhe të ekonomisë globale në qytete. • Interpretin qytetet jo vetëm si agjensë politike, por edhe ekonomike. • Krahason teoritë e ndryshme përkitazi me proceset urbane, 	

		<p>prej Shkollës së Çikagos të njohur me modelin ekologjik, Louis Āirth me pikëpamjen e tij për qytetet si stil jetese e deri te David Harvey dhe Manuel Castells më pikëpamjet e tyre për jetën e qytetit si shprehje e zhvillimit të kapitalizmit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon zhvendosjet demografike, mbipopullimin dhe problemet tjera që lidhen me hapësirat urbane.
	Puna dhe jeta ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson rëndësinë shoqërore të punës. • Analizon varësinë e ekonomisë moderne nga ndarja e punës dhe ndërvarësia ekonomike. • Krahason format e ndryshme të kapitalizmit, si: menaxherial, familjar, i mirëqenies, institucional, fordizmi, taylorizmi etj. • Diskuton rëndësinë e korporatave transnacionale dhe efektet e tyre në nivel global. • Reflekton për të ardhmen e mundshme të punës, bazuar mbi trendet aktuale të automatizimit dhe globalizimit.
	Varfëria, përjashtimi social dhe mirëqenia	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon llojet e varfërisë, atë relative dhe absolute. • Interpretin varfërinë duke përdorë qasjet e ndryshme, si atë të “kulturës së varfërisë” dhe “kulturës së varësisë”, qasje këto të cilat e vënë theksin tek individit dhe qasjet, të cilat theksin e vënë tek makroproceset shoqërore. • Diskuton përjashtimin social me të gjitha format e manifestimit, si mungesa e resurseve dhe e të ardhurave, përjashtimi nga tregu i punës, shërbimet dhe marrëdhëniet shoqërore e deri te format më ekstreme si mungesa e strehimit. • Rezonon rreth shtetit të mirëqenies sociale, si reduktuese e pabarazive përmes furnizimit ose subvencionimit të të mirave materiale dhe shërbimeve.

Udhëzime metodologjike

Programi lëndor i Sociologjisë për klasën e XII, ndonëse me një shtrirje tjetër tematike, për nga natyra dhe karakteri mbetet relativisht i njëjtë me atë të klasës së XI. Andaj, edhe për zbatimin e këtij programi kërkohen metoda, teknika dhe strategji relativisht të njëjta. Në këtë kontekst rekomandohet që mësuesit të lexojnë me kujdes rezultatet e të nxënësve për shkallë (kompetencat) RNK, rezultatet e të nxënësve për fushë (RNF-të) – Shoqëria dhe Mjedisi si dhe rezultatet lëndore (RNL) të lëndës së Sociologjisë. Rezultatet janë jo vetëm pika referente për

përzgjedhjen e përmbajtjeve (njësive mësimore) por edhe për përzgjedhjen e strategjive, metodave dhe teknikave mësimore që do të aplikohen gjatë orëve mësimore.

Suksesi i nxënësve në lëndën e Sociologjisë është i ndërlidhur dhe varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Mësimdhënësi duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet interesave dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve pavarësisht nga kombësia, raca, gjinia, gjendja sociale, fetare. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, forma të shumëllojta të punës duke respektuar personalitetin dhe stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për qasjen e mësimin të diferencuar. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacioni i ri, ushtrime, punë individuale e grupore, hulumtime, detyra, demonstrime, punë me projekte, e të tjera.

Duke pasur në konsideratë specifikat e lëndës, preferohet që aty ku është e mundur të përdoren: loja në përgjithësi dhe loja me role në veçanti, e cila krijon shprehje të komunikimit efektiv, shkathtësi të menduarit kreativ, aftësi bashkëpunuese dhe socializim; Intervista dhe rrëfimet (historia orale) për mbledhjen e të dhënave për ngjarjet, vendet, personalitetet dhe mënyrën e jetesës gjë që zhvillon shkathtësinë e përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit; bashkëpunimi me institucionet, grupet e interesit dhe me shoqërinë civile, si forma që mund të realizohen edhe jashtë hapësirës shkollore, gjithmonë në bashkëpunim me nxënësit, ku mësimdhënësi duhet të ketë rol këshillues, orientues.

Mësimdhënësi ka rol të rëndësishëm edhe në orientimin e nxënësve për shfrytëzimin racional të TIK-ut dhe medias, gjë që i ndihmon atyre në kompletimin e thithjes së informacioneve dhe përgatitjes për angazhim të suksesshëm. Gjithashtu organizimi i vizitave mësimore dhe ekskursioneve ka rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve. Ato mundësojnë që nxënësit të zhvillojnë aftësitë e vrojtimit, hulumtimit, interpretimit dhe diskutimit të dukurive të ndryshme të shoqërisë dhe mjedisit.

Mësimdhënësi duhet të ketë parasysh edhe mësimdhënien dhe të nxënësve të integruar. Duke ju përmbajtur parimeve të kurrikulës është e domosdoshme që të synohet qasja integrale, ku temat brenda lëndëve të fushës apo dhe fushave tjera të trajtohen në mënyrë të integruar. Ngjarjet, fenomene që ndodhin në shoqëri dhe mjedis nuk mund të mësohen si të ndara apo të pjeshme, prandaj nevojitet bashkëpunim mes mësimdhënësve të lëndëve së sociologjisë me mësimdhënësit e lëndëve brenda fushës por dhe me mësimdhënësit e lëndëve të fushave tjera. Kjo garanton që të nxënësit temat të paraqiten të plota dhe në koherencë me njëra tjetrën.

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për trajtimin e çështjeve/ temave ndërkurrikulare. Integrimi i këtyre temave me temat/përmbajtjet e lëndës së Sociologjisë i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë më mirë ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe mjedis, ndërvarësinë e tyre dhe në këtë mënyrë të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Me programin e lëndës së Sociologjisë për këtë moshë të nxënësve mund të integrohen të gjitha çështjet/temat ndërkurrikulare:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media, dhe
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Ndërsa, prej gjithsej 13 tematikave në këtë program lëndor , dhjetë prej tyre ndërlidhen me lëndë tjera. Në vijim po paraqesim ndërlidhjen tematike të programit me këto lëndë:

1. Raca dhe etnia: Historia dhe Edukata qytetare.
2. Religjioni në botën moderne: Historia dhe Filozofia.
3. Globalizimi dhe një botë në ndryshim: Edukata qytetare.
4. Pabarazia globale: Edukata qytetare.
5. Mediat: Psikologjia, Gjuha, Filozofia dhe Edukata qytetare.
6. Trupi, shëndeti, sëmundjet dhe paaftësia: Psikologjia, Biologjia dhe Kimia.
7. Edukimi: Edukata qytetare.
8. Politika, qeveria, lëvizjet shoqërore dhe terrorizmi: Historia dhe Edukata qytetare.
9. Mjedisi dhe rreziku: Biologjia dhe Edukata qytetare.
10. Qytetet dhe hapësirat urbane: Historia.

Udhëzimet për vlerësim

Vlerësimi, para se gjithash, duhet të jetë i vazhdueshëm dhe procesual dhe si përfundim duhet të shprehë synimet e planifikuara për nxënësin. Pra duhet vlerësuar atë që e kemi vënë në objektiv të vlerësimit, njohuritë, shkathtësitë, sjelljet, qëndrimet e nxënësve. Përveç llojeve të ndryshme të testimit, mund të përdoren edhe forma dhe instrumente të ndryshme, si ato verbale, joverbale, vlerësimi në punë grupore, i punës me projekte, vëzhgime të përvetësimit të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve si dhe shkallët e rritjes së shkathtësive dhe aftësive për të zbatuar rezultatet e parapara në Kurrikulën Bërthamë për këtë nivel. Nuk duhet harruar edhe rolin që ka mësimdhënësi me kreativitetin e tij pedagogjik ku, varësisht nga specifikat tematike, hulumton gjetjen e formave më të përshtatshme për vlerësimin e arritjeve të tyre.

Qasja kurrikulës së re me kompetenca, synon vlerësimin e asaj se çka është në gjendje të bëjë nxënësi, pra vlerësimi i zbatimit praktik të njohurive të marra gjatë shkollimit. Kështu, aplikimi i vlerësimit përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve dhe mbajtja e evidencës për qëllime dokumentimi dhe planifikimi të punës së mëtuajtshme me nxënësit është e domosdoshme. Vëzhgimi i punës në grupe dhe nismave individuale mund të vlerësohet edhe përmes teknikës që njihet si buletini i pjesëmarrjes ose edhe asaj që quhet lista e kontrollit etj.

Është e rëndësishme të kultivohet shprehja e vetëvlerësimit e cila mund të realizohet me mbajtjen e dosjeve të nxënësve, ku ata ruajnë punimet e tyre reprezentative, si: intervistat me familjarët, punë individuale ose në grupe për mbrojtjen e mjedisit dhe angazhime të tjera që lidhen me rezultatet e parapara për këtë moshë të nxënësve.

Është shumë e rëndësishme që vlerësimi të orientohet jo vetëm në aspektet memorizuese të informatave, por edhe në funksionet analitike, sintetike, reflektuese dhe kreative të nxënësit.

Vlerësimi gjithmonë duhet të ketë karakter motivues në mënyrë që nxënësi të edukohet të pranojë vlerësimin real dhe të synojë arritje sa më të larta.

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Krahas teksteve mësimore bazë sugjerohet që gjatë procesit mësimor, nxënësit dhe mësimdhënësit të shfrytëzojnë edhe burime të tjera të njohurive siç janë: fletoret e punës, broshurat, gazetatat, revistat, faqet kredibile të internetit, raporte të ndryshme hulumtuese nga institute kredibile (kombëtare dhe ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare) enciklopeditë, vizitat mësimore / në terren (në teatër, në kinema, në koncert, festival filmi etj.) vizitat e ekspertëve në klasë, etj.

Mund të shfrytëzohen *mjete vizuale*, si tabelë shkrimi, tabela interaktive, ilustrime, fotografi, modele, diagrame, mjete grafike etj. e po ashtu edhe *mjete audiovizuale*, si televizori, video-projektori, kompjuteri, telefoni, tableti, etj.

Mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë dhe të krijojnë dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë e rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e produkteve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

FUSHA KURRIKULARE: JETA DHE PUNA

Kurrikula lëndore/programi mësimor

TIK (Gjimnazi i shkencave shoqërore– gjuhësore)

Kurrikula lëndore/programi mësimor

TIK (Gjimnazi i shkencave shoqërore– gjuhësore)

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Hyrje

Në fushën Jeta dhe Puna lënda Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) paraqet një rëndësi të lartë kryesore në jetën bashkëkohore të njeriut, është pjesë e pandarë e veprimtarisë së përditshme të tij dhe sinonim i gatishmërisë për t'u marrë me problemet e të tashmes dhe të ardhmes.

Në kuadër të lëndës TIK për klasën 12 do të zhvillohen module të cilat synojnë të përmbushin konceptet kryesore të fushës Jeta dhe Puna për shkallën 6 si: TIK, Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë, Puna dhe Edukimi për ndërmarrësi si dhe Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm. Të gjitha këto koncepte zhvillohen në ndërlidhje të rezultateve të fushës dhe të lëndës për të arritur qëllimin kryesor të fushës Jeta dhe Puna.

Lënda TIK për klasën 12 është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake nga kjo fushë dhe ka të bëjë me përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme për përdorimin e suksesshëm dhe të pavarur të pajisjeve të TIK, me tema të avansuara rreth Softuerit dhe Harduerit ku në fokus është vendosur zgjidhja e problemeve thelbësore dhe riparimi i tyre, si dhe një kombinim i leksioneve në Sisteme Operative, rrjeta kompjuterike, siguri.

Nëpërmjet TIK-ut, nxënësit krijojnë shprehje dhe shkathtësi gjatë punës teorike dhe praktike për kërkim të pavarur të informacioneve nga të gjitha fushat kurrikulare.

Lënda e TIK-ut ka një lidhje të veçantë dhe kontribuon në të gjitha fushat e Kornizës Kurrikulare të Kosovës.

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i lëndës së TIK-ut për klasën 12 është që nxënësit t'i përdorin, t'i hulumtojnë pajisjet e teknologjisë së informimit dhe të komunikimit si dhe të nxisin iniciativa për pajisjet e mençura si dhe bëjnë ndërlidhjen e shkathtësive personale dhe profesionale me karrierën e tyre dhe nxitjen e ideve ndërmarrëse.

Nëpërmjet lëndës së TIK-ut rritet niveli për nxënësin dhe cilësinë e jetës së përditshme duke përfshirë konceptet bazë të fushës Jeta dhe Puna.

Temat dhe rezultatet e të nxënësit

Nxënësit në klasën e dymbëdhjetë arrijnë rezultatet e të nxënësit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dalta nga rezultatet e të nxënësit të fushës (RNF) “Jeta dhe Puna”, të shkallës së gjashtë (Shk 6) në kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të lartë:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK	<p>RNF: 1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Hulumton, organizon në mënyrë efektive dhe prezanton informacione për aktivitete praktike individuale dhe në grup.</i> <i>Krijon aktivitete të ndërlidhura me punën individuale dhe në grup gjatë realizimit të produkteve dhe projekteve të caktuara.</i> <p>RNF:2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Vlerëson aftësitë personale dhe profesionale si dhe arritjet e identifikuara në bazë të fushave të ndryshme të interesit sipas objektivave të caktuara për vetëpërmirësim, duke marrë në konsideratë ndikimet në zgjedhjen e karrierës në të ardhmen.</i> <p>RNF:4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Zhvillon aktivitete me projekte, punë hulumtuese përmes gjuhëve programuese dhe programeve aplikative.</i> <p>RNF:6 Promovimi i kushteve të sigurta për jetë</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Zbaton dhe menaxhon rregullat për mbrojtje dhe siguri gjatë aktiviteteve të ndryshme në shkollë dhe komunitet.</i> <p>RNF:7 Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Përdor aplikacione softuerike për përpunimin e të dhënave për aktivitete të ndryshme profesionale.</i> <p>RNF:8 Komunikimi në / për jetë dhe punë</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Aplikon burime të ndryshme të informimit për zhvillim personal dhe profesional.</i> <p>RNF:9 Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Vlerëson faktorët që ndikojnë në ngrohjen globale dhe arsyeton ndikimin e TIK në këto ndryshime.</i> <i>Prezanton projekte kreative për ruajtjen e mjedisit duke përdorur aplikacione të ndryshme.</i> 	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Lidhja e komponentëve të kompjuterit hap pas hapi	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Zhvillon aftësitë për të montuar pajisjet kompjuterike, testimin dhe konfigurimin e tyre përmes softuerëve ose mediave. Sistemojnë pajisjet harduerike duke përdorur skema dhe manuale të ndryshme.

	<p>Sistemi Operativ</p> <p>Llaptopët dhe pajisjet portative</p> <p>Printerët dhe Skanerët</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Krahason sistemet operative duke dhënë informacione rreth përkrahjes së pajisjeve harduerike dhe softuerike. • Instalon Sistemet Operative. • Zgjidh problemet e identifikuar në Sistemin Operativ. • Konfigurimi dhe menaxhimi i Sistemit Operativ. • Shpjegon mënyrën e konfigurimit dhe riparimit të llaptopëve. • Mirëmban dhe zgjidh problemet e llaptopëve dhe pajisjeve mobile. • Instalon dhe konfiguron llojet e ndryshme të printerëve dhe skanerëve.
	<p>Rrjetat Kompjuterike</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Planifikon lidhjen e pajisjeve në rrjet duke përdorur aplikacione për rrjeta kompjuterike. • Konfiguron pajisje për t'u lidhur në rrjetin LAN. • Jep informacione rreth funksionimit të WAN-it duke përdorur aplikacionet për rrjeta dhe media.
	<p>Siguria</p>	<p>Praktikon sigurinë e të dhënave dhe realizon sigurinë e rrjetit për t'u mbrojtur nga dëmtuesit.</p>
<p>Këshillimi dhe orientimi në karrierë</p>	<p>RNF 2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë</p> <p><i>2.1. Vlerëson aftësitë personale dhe profesionale si dhe arritjet e identifikuar në bazë të fushave të ndryshme të interesit sipas objektivave të caktuara për vetëpërmirësim, duke marrë në konsideratë ndikimet në zgjedhjen e karrierës në të ardhmen.</i></p> <p>RNF 3. Këshillimi dhe orientimi në karrierë</p> <p><i>3.1. Prezanton plane afatshurtëra dhe afatgjata, përmes vendimmarrjes për karrierë të mëtutjeshme.</i></p> <p><i>3.2. Harton planin e zhvillimit personal për realizimin e qëllimeve të veta profesionale.</i></p> <p>RNF 7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme</p> <p><i>7.1. Përdor aplikacione softuerike për përpunimin e të dhënave për aktivitete të ndryshme profesionale.</i></p>	

	<p>RNF 8. Komunikimi në / për jetë dhe punë <i>8.1. Aplikon burime të ndryshme të informimit për zhvillim personal dhe profesional.</i></p>				
